Flori Bruqi

POLEMIKA SHQIP

RA

Biblioteka
FENIKSI

Redaktor
NEHAT S.HOXHA

Recensent
NAIM KELMENDI

Ballina dhe thyrja teknike
ÇAJUP KAJTAZI

RUGOVA ART

Prishtinë
2009

Flori Bruqi

POLEMIKA SHQIP

Fjala e recensentit

Reagime dhe polemika që sfidojnë të pavërtetat serbe të kohës?!...

Naim Kelmendi,shkrimtar-Prishtinë

Në librin "Polemika shqip", shkrimtari Flori Bruqi, spikat me sensin për të polemizuar,në të shumtën për të reaguar në shumë çështje, që për temë kishin atë,çështjen e të vërtetës historike shqiptare,por të shkruara dhe të thëna në kohë dhe hapësirë të caktuar nga emra akademikësh serbë dhe shkruesish serbë.

Polemisti Flori Bruqi, në blogun e tij virtual:"Foart Press", "Politika" etj. Polemizon dhe reagon shpejtë kundrejtë të pavërtetave të thëna nga akëcilët akademikë serbë, që me "të vërtetën" e tyre publike, ushqenin opinionin vendor e ndërkombëtar për akëcilën çështje a problematikë kundër çështjes shqiptare, qoftë politike,historike, etnike etj.Flori Bruqi polemizon intelektualisht dhe me kundërargumente kundrejtë shpifjes publike serbe,më mirë të thuhet, kundër rrenës serbe,që sipas thënies së njohur të Dobrica Qosiçit etj, është moral serb,për ta mendësuar opinionin me pseudoinformim, me pseudoshkencë,me pseoudoplitikë etj,por që këtyre, polemisti Flori ua heq maskën me kundërargumente.Pra, në këtë libër, që përmbledhë,në të shumtën polemikat e kohës së pasluftës për shumë çështje,sa të ndieshme, siç është e vërteta mbi masakrën e Reçakut, aty ku më 1999 ishte kryer krim kundër njerëzimit, apo shumë çështje të tjera, që nga pseudoshkruesit,pse udoakademikët,pseudointelektualët serbë të Beogradit,interpretoheshin ndryshe nga ajo që ishte e vërtetë e përmnjëmendët, Flori Bruqi i problematizon çështjet, kuptohet reagon pas shkrimit të atyre, për t'i ndriquar dhe për t'i vënë në vend të vet të vërtetat,apo për t'ua thënë secilës emrin e vet ashtu siç e kanë në të vërtetë.Sepse,krimi e ka emrin krim,shpifja e ka emrin

shpifje,masakra e ka emrin masakër,e kështu me radhë.Ky libër ofron mjaft material të polemikës,një zhanër ky,jo fort i lëruar në letrat tona të kohës moderne,por ja që, Flori Bruqi,reagon dhe polemizon në nivelin më të mirë me pseudoshkencën serbe…Në të vërtet,ky libër ofron për lexuesin edhe mjaft reagime të tjera nga shkrues të ndryshëm në Blogun virtual"Floart Press".Në këtë libër,jipet gjithashtu një listë e gjatë emrash të të vrarëve shqiptarë,me datëlindje dhe vende ku janë masakruar apo vrarë, në luftën e fundit më 1998-1999 në Kosovë, nga ish ushtria,policia apo paramilitarët serbë.Kështu që edhe ky kapitull plotëson një anë tjetër të vërtetash, mbi krimet serbe në Kosovë, e që plotësojnë atë kriterin e polemikës argumentuese në raport me polemizuesin/shkruesin shpifës e falsifikator të vërtetash historike,politike etj.Flori Bruqi,reagon dhe polemizon duke mos dashur që t'i lë të heshtura çështjet,në të shumtën,atëherë kur ata, nga tabori i "intelektualizimit"serb, pa argumente, shkruajnë e gënjejnë, për çështjet, tashmë të njohura edhe nga opinioni botëror.

NUK HARROHET REÇAKU

Vujadin Otasheviç

Nish – Mashtrimi më i madh medial në botë ndodhi me rastin e konfliktit në krahinën serbe të jugut, denjoi një vend me rëndësi në librin: "Kosova - zëri i viktimave". E vërteta është vetëm një. Me këto fjalë nis rrëfimin Prof. Dr. Vujadin Otasheviq, i pensionuar tash tre vjet. Ndryshe, një patolog me reputacion botëror, profesor i fakultetit të mjekësisë në Nish, drejtor i Institutit të Mjekësisë ligjore, dhe anëtar i shumë organizatave europiane e botërore,si dhe i asociacioneve dhe ekipeve të patologëve.

Profesori Otasheviq, prej dy vitesh e gjysmë, këto ditë, si ko-autor me Slavisha Dobriçanin, botoi librin me titull: "Kosova - zëri i viktimave'". Një kapitull i veçantë është dokumentacioni që prezanton Prof. Dr. Otasheviq me argumentime dhe gjetje, tok me kolegët dhe ekspertët më të njohur nga Finlanda, Danimarka, Norvegjia, Belorusia dhe, natyrisht - nga Serbia, por edhe nga vende të ndryshme, lidhur me mashtrimin më të madh mediatik në botë që ndodhi në Kosovë, në dimrin e vitit 1999 - për masakrën e pandehur në fshatin Reçak.

Në janar të atij dimri, të gjitha mediat e botës ndërpresin emetimet e programeve të tyre, për të lajmëruar se në fshatin „Reçak, në Kosovu e Metohiu, forcat e sigurimit serb kanë bërë një masakër, që nuk mbahet mend, mbi popullatën e pafajshme dhe mbi qytetarët shqiptarë, se janë vrarë të gjithë banorët e Reçakut: fëmijët, gratë dhe pleqët e paarmatosur, dhe se është bërë një masakër e paparë në botën e qytetëruar".

Të nesërmen, të gjitha gazetat botuan "fotografitë më monstruoze mbi masakrën e paparë më parë". Dhe sot, tetë vjet më pas, ajo u ndriçua në librin „Kosova – zëri i viktimave" - e vetmja e vërtetë mbi paraqitjen e "ndodhjes së trishtë".

Të vërtetën e punës shumëmuajshe të profesorit Otasheviq në Prishtinë, dhe të patologëve të botës, të cilët i kishte kontakuar Bashkësia Europiane dhe OSBE, askush dhe asnjëherë nuk mundi t'i mohonte dhe as t'i ndryshonte.

– Fshati i largët Reçak në Komunën e Shtimes, në Metohi, me lojën e fatit dhe kombinatorikës njerëzore, brenda natës bëhet pika e ndarjes ndërmjet jetës dhe vdekjes, ndërmjet dretësisë dhe padrejtësisë, ndërmjet të vërtetës dhe gënjeshtrës, moralit dhe amoralitetit.
Askund dhe kurrë nuk ka ndodhur që një fshat i tillë si Reçaku, me një shpejtësi marramendëse, të bëhet një vend i njohur botërisht, dhe e gjithë kjo, „për masakrën" e një populli dhe satanizimin e popullit tjetër – shkruan në gazetën „Politika" prof. Otasheviç.
Për masakrën e pandehur, kanë gjëmuar mediat më të mëdha dhe më të fuqishme të botës. Filloi fushata e madhe kundër Jugosllavisë dhe Serbisë.
Reçaku doli në plan të parë.
Atëbotë, me ditë të tëra - ndonëse, asnjë ngjarje në botë nuk ka shkaktuar aq kërshëri dhe vëmendje dhe nuk ka qenë edhe aq interesant, ndonëse tërësisht i pavërtetë dhe i shpifur, thotë Prof. Otasheviq.
– Shprehja „masakër", pa asnjë argument të vërtetë dhe të sigurt, dhe pa kurrfarë vërtetimi, hap dyert e opinionit botëror nëpërmjet askujt tjetër, veçse përmes Shefit të Misionit Vëzhgues të OSBE-së në Serbi, amasadorit të pensionuar, gjeneralit Uiliem Uoker. Apriori, ai shpall forcat e polic serbe si kriminelë në Kosovu e Metohiji, ndërsa fushata mediatike e politike, edhepse që nga fillimi me shumë kontroversa dhe pa pardon, nëpërmjet Reçakut gjeti shkakun për bombardimet e NATO-s mbi Serbinë dhe Malin e Zi, thotë Prof. Dr. Vujadin Otasheviq.
Fill pas kësa, Presidenti i SHBAO, Bill Klinton, paralajmëron sulmin shkatërrimtar të NATO-s mbi Jugosllavinë. Klintonit i bashkangjitet Riçard Hollbruk, Uezli Klark dhe shumë të tjerë. Ndonëse "versionet" e tyre mbi ngjarjet pranohen lehtësisht nga Uoker i demanton krejtësisht Kristof Shatelo në revistën „Le Mond" dhe pas tij edhe xhiruesit e AP (Asoshiejted Pres"; "Figaro" e Francës, italiani Xhixhi Riva, të cilët, ose kanë qenë në vendin e ndodhjes gjatë konfliktit, ose menjëherë pas, ose gjatë ditës kur është kumtuar informata sensacionale për masakrën e pandehur në Reçak, porse rrjedha e ndodhjes nuk ndryshon.
Edhe pranë asaj se gazetarë të shumtë, por edhe zyrtarë, pohonin se banorët e Reçakut, një muaj më parë ishin zhvendosur në fshatrat përreth, ndërsa fshati ishte një bastion i UÇK-së terroriste dhe se forcat e sigurimit serb kishin të bënin me terroristët, masakrën e pandehur dhe "krimin" e shpifur. Ky ishte shkaku për sulmin mbi vendin tonë.
Libri „Kosova – zëri i viktimave", është botuar në gjuhën serbishte dhe ka shkaktuar interesim të madh të botuesve të huaj për përkthim në anglisht,

frengjisht, rusisht dhe në gjuhë të tjera.

Toma Todorović
[Botuar në gazetë "Politika",Beograd,më: 03.05.2007)
Burimi: http://www.novinar.de/2007/05/04/racak-nije-zaboravljen.html

Nuk është harruar
një koment për "Reçakun"

Letër e hapur: Pse gënjejnë shkencëtarët serbë - patologët?
LETËR E HAPUR PËR WEB: NOVINAR.DE
E NDERUAR REDAKSI,
Lexova artikullin me titull "Reçaku nuk harrohet" në web faqen tuaj:

http://www..novinar.de/2007/05/04/racak-nije-zaboravljen.html#more-3272.

Turp për dy ekspertë "të shquar" të mjekësisë ligjore – dmth. dy patologëve: Otasheviq dhe Dorbiçanin për gënjeshtra para opinionit botëror. Tani keni rastin të shihni të vërtetën për viktimat shqiptare, shkaktuar nga armata e juaj jugosllave, të formacioneve paramilitare, etj.
Klikoni linket dhe do të bindeni se në cilën anë është e vërteta.
Mr.sci. Flori Bruqi, nga Prishtina.
Prishtinë, 7.5.2007.
Komenti i Redaksisë
I nderuar z. Bruqi, linket e cituar janë fshirë përkohësisht, derisa redaksia të vërtetojë autentitetin e fotografive.
Jemi ngopur së shikuari "krimet e shpifura" dhe marifetllëqet e mediave të ndryshme botërore dhe magnatëve të tyre.

Ju lutemi, z. Bruqi, por edhe lexuesve tanë të nderuar për mirëkuptim.
Ju faleminderit.

S.M.
7. maj 2007
Burimi: http://www..novinar.de/2007/05/04/racak-nije-zaboravljen.html

Reagimi i mr.sci. Flori Bruqi, shkencëtar nga Prishtina

7. maj 2007.
Flori Bruqi

E nderuar Redaksi,

E lexova artikullin me titull "Nuk harrohet Reçaku" në ëeb faqen tuaj.
Turp për të dy "ekspertët" e shquar ligjorë; për patologët gjyqësorë, Otasheviq dhe Dobriçanin, të cilët gënjyen opinionin botëror për viktimat e shqiptarëve, të bëra nga Ushtria Jugosllave(VJ),Njësitë Speciale Serbe(SJP) dhe formacionet paramilitare serbe . Klikoni : http://www.novinar.de/index.php?s=Flori+Bruqi

F. Bruqi: "Po zgjidhet lëmshi i së vërtetës për Reçakun

Ju transmetojmë letrën-reagimin për artikullin "Reçaku nuk harrohet" nga z. Bruqi, të cilin e kemi pranuar nëpërmjet postës elektronike.
Z. Bruqi është, shkrimtar dhe shkencëtar nga Prishtina.
E nderuar Redaksi,
Së pari, gazetari juaj Vujadin Otasheviq botoi të pavërtetën, sepse Kosova është nën protektoratin e UNMIK-ut që nga viti 1999 dhe nuk është më "krahinë jugore e Serbisë". E vërteta është se është një dhe e vetme - ajo e masakrës së Reçakut (Kosovë), të cilën e bënë Njësitet Speciale të Ushtrisë Jugosllave dhe MPB të Serbisë.
Rrëfimi i prof. Dr. Vujadin Otasheviq dhe prof. Dr. Slavisha Dobriçanin në librin "Kosova - zëri i viktimave" është një kallëzim për fëmijë. Të dy shkencëtarët, para së gjithash, patologë të shquar me reputacion ndërkombëtar, ka qenë dashur të tregonin vetëm të vërtetën. E vërteta e fotografive të masakrës mbi fëmijë të pafajshëm dhe shqiptarëve të moshuar, më 15 janar 1999 në fshatin

Reçak afër Shtimes (Kosovë). Librin nuk e kam lexuar, por e di tejet bukur seç kanë punuar patologët e njohur gjyqësorë lidhur me viktimat e pafajshme. Kurrfarë mashtrimi nuk ka ekzistuar nga ana e UÇK-së dhe gazetarëve të medias vendore dhe atyre ndërkombëtare.
Mashtrimi ka ndodhur në "Qendrën e Medias" në Prishtinë, nga na e mjeteve serbe të informacionit, shërbimeve të inteligjenës së KOS-it të AJ dhe njësiteve speciale të SPB të Serbisë. Masakra ka ndodhur, dhe në atë masakër janë vrarë egërsisht shqiptarët e pafajshëm: - në vijim shihni 45 emra shqiptarësh.
Në konfliktin me AJ, NjPS, NjSS të MPB të Serbisë, forcave të paramilitarëve radikalë të Vojisllav Sheshelit, ato të paramilitarëve të Zhelko Razhnatoviç - Arkan, me ç'rast janë vrarë në fushëbetejë ushtarët e UÇK-së - në vijim shihni emrat e 15 shqiptarëve dhe mbiemrat me vitet e lindjes.

Patronët kryesorë të masakrës mbi qytetarët e pafajshëm - shih 19 emra dhe mbiemra serbësh.
Shefi i Misionit Vëzhgues i OSBE-së në Prishtinë, gjenerali amerikan, Uiliem Uoker ka shpallur forcat serbe për kriminelë në Kosovë, dhe më pas ky ishte preteksti për bombardimet e NATO-s mbi Serbinë dhe Malin e Zi.
Menjëherë pas kësaj, presidenti i SHBA-ve, Bill Klinton paralajmëroi sulmin shkatërrues të NATO-s mbi Jugosllavinë. Presidentit iu bashkangjitën: Riçard Hollbruk, Uezli Klark dhe shumë prijës të shquar nga bota.
Klikoni linket dhe do të bindeni se në ilën anë ishte e vërteta mbi masakrën e shqiptarëve në Kosovë, Z. S.Kostiq. Do të kishte qenë më mirë nëse do të shpenzonit më shumë kohë dhe energji për ngjarjet e vërteta, të ilat do t'i keni ankth sa të jeni gjallë, sepse ka Zot në këtë botë. Nga ana tjetër, ne i besojmë Zotit dhe të vërtetës!!!
Urdhëroni të hapim polemikën, porse vetëm me argumente dhe jo me histori të rreme dhe propagandë, me të cilën z. Kostiq synon shpërlarjen e trurit (tanimë të shpërlarë fare) të POPULLIT TUAJ SERB!!!
Flori Bruqi
i mbyllur citati

Koment i Redaksisë
I nderuar vendës dhe zotëri Bruqi, për fat të keq nuk kemi pasur mundësinë që të kontaktonim për një kohë të shkurtër me z. Otasheviq, andaj do të përpiqemi të ju shpjegojmë pikëpamjet tona për rastin e "Reçakut". Ne

çmojmë lart lajmërimin tuaj dhe dëshirën për të na e thënë të VËRTETËN. Të gjithë ne e dimë se e VËRTETA është një, dhe e vetme. Na vjen mirë që disa mendje në Kosmet (?) nuk qenkan të shpëlara dhe se "objektivvisht" shtjellojnë situatën e Kosmetit. Në një det artikujsh, analizash dhe komentesh rreth rastit të Reçakut, shkruar nga autorë serbë dhe të huaj, kemi zgjedhur vetëm një, të cilin e ka shkruar kanadezi Peter Ëorthington, kolumnist i revistës së Torontos "Toronto Sun".

http://www..canoe.ca/Columnists/ëorthington.html
Toronto,1. prill 2001.

PETER UWRTHINGTON — Toronto Sun

Mashtrimi që nisi luftën.
Si u mashtruan SHBA-të, NATO dhe mediat e Perëndimit për Kosovën.

Ajo që ka pasur peshën vendimtare në muajin mars të vitit1999, që presidenti Bill Klinton të lancojë fushatën ajrore kundër Serbisë, ishin raportet për masakrën e 45 shqiptarëve civilë, që e kishin bërë forcat serbe të sigurimit në Reçak, rreth 30 km larg në jug të Prishtinës në Kosovë.
Klintoni i tha botës më 19 mars 1999: "Duhet mbajtur mend se ajo që ka ndodhur në Reçak… njerëz të pafajshëm, gra e fëmijë janë marrë nga shtëpitë e tyre dhe janë dërguar në një hendek, janë detyruar të përgjunjen në pluhur dhe janë kositur me rrebeshe armësh".
Fotografitë ishin përhapur anembanë botës. Bombardimi i NATO-s filloi më 24 mars dhe zgjati për 78 ditë.
Sekretari i Shtëpisë së Bardhë, Xho Llokhart, tha për rastin e Reçakut: "Një mesazh i fuqishëm do t'i dërgohet kryetarit (Slobodan) Milosheviq për sjelljen para gjyqit dhe drejtësisë të të gjithë atyre që duhet dënuar për këtë… "
Ministresha e jashtme e SHBA, Medlinë Ollbrajte, e gatshme për të luftuar kundër Jugosllavisë së atëhershme, duke folur në emisionin "Përballu me Kombin", në kanalin e CBS, fliste për Reçakun, ku thoshte: "dhjetëra njerëzve u është prerë qafa". Ajo e quajti këtë "incident i galvanizuar", gjë që donte të thoshte se bisedimet paqesore në Rambuje nuk kishin kurrfarë kuptimi, porse e vetmja rrugë ishte "bombardimi humanitar".

Ministri i jashtëm i Gjermanisë, Joshka Fisher, për gazetën "Berliner Zeitung", tha se, masakra e Reçakut "ka qenë një kthesë" dhe se e vetmja përgjigjje është lufta.
Ministri i atëhershëm i jashtëm i Kanadasë, Llojd Oksuërth, këtë masakër e quajti "Viktimizim i neveritshëm i civilëve".
Organizata Human Rights Ëatch (HRË) raportoi se të vrarëve ua kanë shkulur thonjtë nga gishtërinjtë - gjë që është dëshmi e torturimit.
Më 16 janar, një ditë pas masakrës, Uiliem Uokerin, diplomatin amerikan që ishte në krye të misionit vëzhgues të OSBE-së, UÇK-ja e shpuri në Reçak për t'i parë kurmet në hendek. Ai deklaroi se "është e qartë se janë vrarë në vendin ku u gjetën".
Raporti i tij i OSBE-së fliste për "burgosjet arbitrare, vrasjet dhe gjymtimet e civilëve të paarmatosur" në Reçak.

TRUPAT TOKËSORE

Kanadezen Luizë Arbur, atëotë prokurore speiale e Tribunalit për krime lufte (të cilën e caktoi personalisht Medlinë Ollbrajt) pushteti serb e kishte ndaluar të vizitonte Reçakun, ndërsa ajo premtoi hakmarrjen për këtë masakër, duke insistuar se "trupat ndërkombëtare në vendin e ngjarjes", ishte e vetmja mënyrë që të bëheshin burgosjet.
Kur Millosheviq u akuzua për kriminel lufte, masakra e Reçakut u referua si provë. Revista "London Times", shkruante se, viktimave u ishin nxjerrë sytë, u ishin zgërlaqur kokat, ballëpërballë, nga afërsia, kishin derdhur breshër të shtënash, dhe u kishte ndodhur të gjithë "fshatarëve, punëtorëve, prej moshave, 12-74 vjeç, burrave, grave e fëmijëve".
Hetimet i kishin bërë patologët serbe e bellarusë, porse ishin të dyshuar, prandaj Bashkimi Europian autorizoi ekipin e patologëve nga Finlanda, me në krye Helena Ranta, patologe e dhëmbëve për të drejtuar hetimet.

Raporti i ekipit finlandez nuk qe bërë publik.
Ranta mbajti një konferenë për media, dhe në atë konferenë ishte e papërak-tuar duke pranuar se nuk kishte prova mbi gjymtimet dhe torturimet, si edhe faktin se zyrtarët jugosllavë kishin bashkëpunuar. Mirëpo, ajo i quajti këto vrasje me emrin "krime kundër njerëzimit", gjë që me të madhe u komentua se kishte domethënien se në Reçak njëmend ka ndodhur një masakër e ne-

veritshme.
Më pastaj u konstatua, nëpërmjet hetimeve të radhës nga korrespondentët amerikanë dhe grupeve paqeruajtëse të gjermanëve e franezëve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë aty edhe Qendrën Ndërkombëtare të Veprimit dhe Fondacionin Libery (Liria), se duket sikur masakra e Reçakut, ishte një mashtrim i madh dhe i efektshëm, të cilin e kishin bërë UÇK-ja, për të bindur SHBA-të dhe NATO-n që të sulmonin Serbinë. Qëllimi ishte Pavarësia e Kosovës, e cila ndoshta do të shpiente deri tek realizimi i ëndrrës për Shqipërinë e Madhe.
Ne tani dimë më mirë se çfarë kishte ndodhur vërtet në Reçak - një vend, ku para krizës, jetonin rreth 2.000 banorë dhe ky vend ishte bastion i agjitacionit të UÇK-së. Deri në janar të vitit 1999, shumica e popullatës kishte ikur në qytezën e Shtimjes, dhe në Reçak nuk kishin mbetur ndoshta 400 banorë. Por, kur dy policë serbë kishin rënë në pritë dhe ishin vrarë në incidente të ndarë brenda një jave, forat serbe të sigurimit rrethuan Reçakun dhe e sulmuan. Serbët kishin lajmëruar gazetarët e huaj për këtë gjë, dhe ata kishin ardhur në vendin e ndodhjes. Luftimet ishin të ashpra dhe të shkurtra, jo vetëm në vend, por edhe në rrethinë.
Ç'është e drejta, gazetarët kishin parë se në Reçak kishte shumë pak njerëz.
Janë numëruar rreth 20 kufoma. Serbët dhe gazetarët kishin ikur në mbrëmje.
Të nesërmen, më 16 janar, UÇK-ja përsëri e kishte kontrollin në vend.
Duket sikur gjatë natës, pothuajse ishin vrarë të gjithë luftëtarët e UÇK-së në luftimet e kësaj zone - 45 sosh - dhe janë hedhur në hendek tek Reçaku, ku ishin ftuar gazetarët dhe hetuesit e OSBE-së, për të parë atë që quhej "masakër" mbi qyetatrët e paarmatosur. civila.
Gradat apo epoletat ushtarake ishin hequr nga uniformat dhe pajisjet ushtarake kishin zëvendësuar me veshje civile. Askund nuk shihej kurrfarë arme në horizont. Mashtrimi kishte dalë në shesh. Uiliam Uoker ishte i pari që arriti tek vendi i ngjarjes, dhe besoi se ajo që kishte parë dhe ato që i ishin rrëfyer, ishin të vërteta.
Shtypi ndërkombëtar transmetoi neverinë e tij përpara syve të botës.
Provat e patologëve treguan se - siç e kishte vërtetuar ekipi finlandez - shumësia e 45 të vrarëve në Reçak kishin rënë nga një largësi e madhe, dhe jo në stilin e ekzekutimit. Testimet ishin kryer dhe ato kishin dalë me rezultate pozitive për pluhurin e barutit në duar, gjë që na shpie tek fakti se ata kishin përdorur armë zjarri.

Pranë trupave të tyre nuk ishte gjetur as municion dhe as gëzhoja, aty ku ata kinse ishin masakruar. Nuk kishte as pellgje gjaku.

TRUPAT ISHIN ZHVENDOSUR

Patologët kishin konstatuar se, po ashtu, të gjith 45 njerëz të vdekur, ishin qëlluar në pjesë të ndryshme të trupit, nga drejtime të ndryshme, gjë që tregon se lufta kishte ndodhur në një vend tjetër, dhe se të vdekurit i kishin hedhur tok, për të arritur efektin.

Deri vonë, askush nuk ishte i interesuar për të vërtetën. "Vallë, ishte kjo një masakër, apo nuk ishte? Askush nuk donte ta dinte", shkruante gazeta austriake "Die Ëelt". Publikimi i konstatimit të autopsisë ishte shtyrë, kurse etja për luftë, kumbonte korridoreve të forcave aleate.

Gazeta gjermane "Berliner Zeitung" kishte marrë konstatimin e ekipit finlandez të patologëve, dhe kishte dërguar një skuadër reporterësh për të hulumtuar dhe konstatuar, se: "Ka të ngjarë se në Reçak nuk ka ndodhur masakra fare… "

Gazetari francez, Reno Zirar, i gazetës "Le Figaro", ka qenë në Reçak dhe është hutuar pse reporterët nuk përmendnin faktin se "ai vend ishte një fshat i fortifikuar rreth-e-rreth me istikame" - baza e UÇK-së. Ndonëse ai ka shkruar fillimin e rrëfimit mbi masakrën, më pas ka dyshuar "E kam ndier se aty nuk ishte diçka në rregull".

Kristof Satle, i revistës "Le Monde", ka qenë në Reçak ditën që kanë sulmuar serbët, dhe ka parë një të vrarë dhe katër ushtarë të tjerë të plagosur pasi që ka rënë muzgu. Të nesërmen, UÇK-ja ka nxjerrë në shesh trupat e masakruar, të cilët më parë nuk kishin qenë aty. "Nuk mund t'i gjej zgjidhjen këtij misteri", ka thënë ai. (Atëbotë, komandanti i UÇK-së, Hashim Thaçi ka thënë për BBC-në: "Një njësit kryesor, në këtë rajon ka ndërmarrë një luftë të ashpër. Për fatin e keq, pësuam me shumë viktima, por edhe serbët, po ashtu".)

Hetimet shtesë provojnë se dy gazetarë televizivë, të agjencisë Associated Press, dhe dy ekipe të vëzhguesve të OSBE-së, po ashtu kanë vëzhguar nga bregu luftën në Reçak dhe kanë hyrë po atëherë kur kanë hyrë edhe forcat serbe. Ekipi i AP ka xhiruar me kamera fshatin e boshatisur. Gjatë natës është

kthyer UÇK-ja dhe ka mbledhur të trupat e pa jetë. Të nesërmen, Uoker i ka shpalosur botës kumtin se si janë "vrarë" burrat dhe fëmijët, kurse disa janë përpjekur që të iknin. Redaktorja e CNN, Kristiane Amanpur, gruaja e zëdhënësit të atëhershëm të Ministrisë së jashtme, Xhejms Rubin, nuk ka shfaqur asfarë skepticizmi për raportimin e "masakrës së civilëve".

Dhe kjo nuk ndryshon gjë. Porse, Reçaku do të duhej t'i detyronte njerëzit që të kishin konsideratë, kur kemi të bëjmë me çështje të propagandës së Qeverisë, mbi gjërat që kaq pak i dinë, e sidomos kur kanë ndjenja të forta për to.

Kujtoni se sa emocione janë gjeneruar lidhur me "pastrimin etnik" në Kosovë?

Nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, popullata e Kosovës ishte 50% : 50% serbe dhe shqiptare. Deri në vitin 1999 ishte 90% shqiptare. Në ditët tona, ajo është 96% shqiptare. Gjatë 50 vjetëve të fundit - kush na qenka "spastruar etnikisht?"

Edhe sot, shqiptarët në Maqedoni shfrytëzojnë argumente të ngjashme me ato që janë përdorur kundër serbëve në Kosovë - paragjykimet, vendet e ngrira të punës, diskriminimi. Rrallë përmenden hartat nga Shqipëria, të cilat shfaqin, jo vetëm Kosovën, porse edhe pjesë të Maqedonisë, edhe pjesë të Malit të Zi - si pjesë të "Shqipërisë së Madhe".

Nuk ka nevojë të jesh Ajnshtajn, për të kuptuar se SHBA, NATO dhe media e perëndimit janë mashtruar dhe manipuluar për të ofruar mbështetje aktive të veprimit agresiv, ashtu për të krijuar një shtet, i cili nuk do të jetë lehtë vendoset dhe të kalojë i qetë. Ushtarët e korracuar të NATO-s dhe njerëz të pafajshëm, janë ngujuar në moçalet e Ballkanit, falë shkurt-pamësisë, lavdërimeve të liderit politik, i cili ka bërë shumë gabime.

Ja se si ka raportuar "Tanjug" në ditën e 18 marsit, 1999

MINISTRI JANKOVIÇ: RAPORTI I HELENA RANTA ËSHTË KONTRADIKTOR

B E O G R A D (TANJUG) - RAPORTI I PATOLOGUT FINLANDEZ, HELENA RANTA, ËSHTË PËRPLOT ME KONTRADIKTA, PAQARTËSI DHE HIPOTEZA, ANDAJ VIHET NË DYSHIM ÇËSHTJA E QËNDRUESHMËRISË SË TIJ, I KA DEKLARUAR TANJUGUT MINISTRI SERB I DREJTËSISË, DRAGOLJUB JANKOVIÇ.

KJO ËSHTË VETËM NJË PIKËPAMJE E SAJ PERSONALE, KA THËNË JANKOVIÇ, DUKE VËNË NË PAH, SE AI RAPORT ASSESI NUK ËSHTË DEKLARATA E REPARTIT TË MJEKËSISË LIGJORE TË UNIVERSITETIT TË HELSINKIT.

DUKE QENË SE RAPORTI ËSHTË PIKËPAMJE E SAJ PERSONALE, DOKTOR RANTA, QË ËSHTË PATOLOGE DENTARE, QË DO TË THOTË: NUK ËSHTË EKPERTE KOMPETENTE PËR KONSTATIMIN E IDENTITETIT TË KUFOMAVE, DHE JO KONKLUDIMEVE PËR ÇËSHTJET E KONKLUZIONEVE PËR PYETJET QË U JANË PARASHTRUAR SI DETYRË EKIPIT TË PATOLOGËVE EKSPERTË GJYQËSORË NGA FINLANDA, THEKSON JANKOVIÇ.

NË RAPORTIN E SAJ, RANTA THOTË SE NUK MUND TA SHPJEGOJË NËSE NË REÇAK KA NDODHUR MASAKRA, SEPSE, SIPAS MENDIMIT TË SAJ, KJO NUK ËSHTË KOMPETENCË E EKIPIT MJEKO-LIGJOR, SEPSE PËR TË, NDAJ PËR KËTË LYPSET NJOHURI DHE ANAGAZHIM SHTESË NGA HETIMI KRIMINALISTIK, THOTË JANKOVIÇ.

NË RAPORTIN E SAJ, RANTA REFEROHET TEK SUGJERIMI I INTERPOLIT, I PARA 31 VJETËVE, SE GJURMËT E BARUTIT NË DUAR NUK ZBULOHEN NËPËRMJET "DORASHKËS SË PARAFINËS", ME TË CILËN SYNOHET MINIMIZIMI I RËNDËSISË SË ARGUMENTIT QË NXJERRIN PATOLOGËT BJELLORUSË, KA THËNË JANKOVIÇ.

SI NË BOTË, ASHTU EDHE TEK NE, THEKSON MINISTRI I DREJTËSISË, VAZHDON TË SHFRYTËZOHET "DORASHKA E PARAFINËS" SI NJË NGA PROVAT.

RANTA, NË RAPORTIN E SAJ ME SHKRIM DHE NË KONFERENCË PËR SHTYPIN, NË PRISHTINË KA VEÇUAR PROFESIONALIZMIN E LARTË DHE AFTËSINË E PATOLOGËVE JUGOSLLAVË DHE BJELLORUSË. NËSE QENKA ASHTU, DHE NËSE KEMI DY GJETJE KONKLUDIME TË PAJTUARA NGA EKSPERTËT JUGOSLLAVË DHE BJELLORUSË PËR MJEKËSI GJYQËSORE TË SPECIALIZIMEVE TË NDRYSHME, ATËHERË SI MUND TË VIHEN NË DYSHIM KONKLUDIMET E ATYRE EKIPEVE PËRMES NJË DEKLARATE TË NJË EKSPERTI PATOLOG, DENTIST, PA MARRË

PARASYSH RANGUN E LARTË QË KA RANTA NË FUSHËN E NGUSHTË SI SPECIALISTE NË BOTË, VLERËSON JANKOVIÇ.
MINISTRI I DREJTËSISË KA THEKSUAR SE MUND TË BËHET PYETJA - VALLË, A ËSHTË KY PËRFUNDIMI I DEKLARIMIT TË PATOLOGËVE FINLANDEZË, APO NDOSHTA NJË DITË TJETËR DO TË NA JEPET I GATSHËM, NEVE APO FAKTORIT NDËRKOMBËTAR, KONKLUDIMI I EKSPERTËVE NGA FINLANDA, TË CILIN ENDE NUK E KEMI MARRË.

TË GJITHË RAPORTET DEMANTOJNË MANIPULIMET POLITIKE

P R I S H T I N Ë (TANJUG) - ANËTARËT EKSPERTË TË EKIPIT TË PATOLOGËVE JUGOSLLAVË, PROF. DR. SLLAVISHA DOBRIÇANIN, VUJADIN OTASHEVIÇ DHE DUSHAN DUNJIÇ, SË BASHKU ME ZV. MINISTRIN E DREJTËSISË SË SERBISË, ZORAN BALINOVAC, KONFIRMUAN EDHE NJËHERË NË PRISHTINË SE, NË REÇAK NUK KA NDODHUR KURRFARË MASAKRE.
ATA KISHIN THEKSUAR SE RAPORTI I PATOLOGËVE FINLANDEZË PAJTOHET PLOTËSISHT ME ANALIZËN E EKSPERTËVE JUGOSLLAVË E BJELLORUSË, DHE PRANDAJ ATO RAPORTE PA DYSHIM DEMANTOJNË ÇDO SPEKULIM POLITIK MBI, KINSE, MASAKRËN E REÇAKUT.
ANËTARËT E EKIPIT TË EKSPERTËVE JUGOLLAVË, KANË THEKSUAR SE MENDIMI PERSONAL I HELENA RANTA, NUK ËSHTË THELBËSOR PËR GJYQET, PËR PROFESIONIN MJEKËSOR DHE PËR OPINIONIN PUBLIK, PORSE ËSHTË VETËM SE NJË RAPORT I OBDUKSIONIT TË EKSPERTËVE.
PROF. DR. DUSHAN DUNJIÇ KA THEKSUAR SE ME OBDUKSIONIN ËSHTË VËRTETUAR SE TË GJITHË TË VRARËT KANË VDEKUR NGA ARMË ZJARRI, NË BETEJËN E ARMATOSUR, TË QËLLUAR NGA NJË LARGËSI E KONSIDERUESHME.
LËNDIMET NË TRUP VININ NGA DREJTIME TË NDRYSHME, QË DO TË THOTË SE ATA NUK ISHIN PUSHKATUAR, POR AS EDHE SE ISHIN ZËNË NË POZITË TË PËRGJUNJUR, VEÇSE NË POZITA VENDOSURA SIPAS KONFIGURACIONIT TË TERRENIT. NË PLAGËT HYRËSE NUK KISHTE BARUT EKSPLOZIV, KURSE NË KURMET E TYRE NUK KISHTE TJETËR, PËRVEÇ PLAGËVE NGA ARMË ZJARRI.
TEK GJASHTË KUFOMA JANË KONSTATUAR LËNDIMET VDEKJEPRURËSE TË SHKAKTUARA NGA KAFSHËT, QË DMTH SE ATO KURMË NUK ISHIN SHKAKTUAR NË NJË NDODHJE TË NJËJTË, PORSE ME TO KANË MANIPULUAR DHE SE NË XHAMI JANË SJELLUR NGA ANË TË NDRYSHME.
KJO ISHTE AJO QË DUHEJ TË THUHEJ, GJË QË ME ANALIZËN PROFESIONALE ËSHTË KONFIRMUAR, KA KONSTATUAR DR. DUNJIÇ.

EKSPERTI STANKOVIÇ PËR RASTIN REÇAK

B E O G R A D, (TANJUG) 18 MARS 1999 –
SPECIALISTI I MJEKËSISË LIGJORE, DR. ZORAN STANKOVIÇ KA DEKLARUAR SE, PËR MGJARJEN NË REÇAK, DUHET BËRË NJË EKSPERTIZË TË VEÇANTË - E CILA DO TË BËHEJ BRENDA 7. (SHTATË) DITËSH, DHE SE AJO NGJARJE DO TË PËRMBYLLEJ SIPAS LIGJIT MBI PROCEDURËN GJYQËSORE.
NË DEKLARATËN E TIJ DHËNË RTS-SË, STANKOVIÇ, PASI QË SHEFI I EKIPIT TË PATOLOGËVE, HELENA RANTA KISHTE SHPALLUR 'QËNDRIMIN PERSONAL" MBI NGJARJEN NË REÇAK, KA THËNË SE EKSPERTËT TANË KANË PRITUR GJATË PËR REZULTATIN E PËRPUNIMIT TË TRUPAVE NGA MJEKËSIA GJYQËSORE NË FSHATIN REÇAK, DHE SE MË PASTAJ KANË BASHKËPUNUAR.
STANKOVIÇ KA THEKSUARSE NUK E KA TË QARTË PSE SHEFI I PATOLOGËVE NGA FINLANDA, HELENA RANTA, KA VLERËSUAR SE NË ATË RAST, KEMI TË BËJMË ME QYTETARËT, SEPSE, SIÇ ËSHTË INTERPRETUAR, ËSHTË TEJET PROBLEMATIKE TË PËRCAKTOSH SE Ç'ËSHTË PËRKUFIZIMI CIVIL.
A ËSHTË QYTETARI CIVIL PERSONI I VESHUR NË RROBA CIVILE E ME PUSHKË NË KRAH, DHE - A ËSHTË CIVIL DIKUSH QË KA VESHJE QYTETARE, KA PYETUR STANKOVIÇ. "KJO NUK ËSHTË NË KOMPETENCË TË GJYQËSISË MJEKËSORE, KURSE HELENA RANTA, DUKE FOLUR PËR KËTË, AJO KA SKUALIFIKUAR VETVETEN", KA VLERËSUAR STANKOVIÇ.
AI KA THEKSUAR SE DUHET KONSTATUAR SE SA PLAGË JANË MARRË NGA ARMË ZJARRI, A JANË MARRË ATO NGA AFËRSIA, APO NGA LARGËSIA, OSE NGA PROJEKTILET.
DUKE KOMENTUAR POHIMIN E Ë. ËALKER PËR RASTI I MASAKRËS SË REÇAKUT, STANKOVIÇ KA THEKSUAR SE NË NJË PERIUDHË, NË NJË REVISTË GJERMANE, SHKRUANTE SE SERBËT NUK JANË FAJTORË PËR INCIDENTIN NË MARKALAMA (NË bOSNJË E HERCEGOVINË), PORSE ATË E KANË BËRË MUSLIMANËT. PËRFAQËSUESI I KB, AKASHI, NDËRKAQ, PËR NJË GJË TË TILLË, NUK ËSHTË VËNË NË SHTYLLËN E TURPIT DHE NUK ËSHTË VËNË NË LIDHJE ME VIKTIMAT DHE BOMBARDIMET NË B-H, KA THËNË STANKOVIÇ MBI KONOTACIONIN E ATIJ RASTI.
DUKE RIKUJTUAR SE JANË ANGAZHUAR EKSPERTËT MË TË MIRË PËR NDRIÇIMIN E NDODHJES NË REÇAK, STANKOVIÇ KA THEKSUAR SE, PËR DALLIM NGA OBDUKSIONET E DERITASHME, PAK VËMENDJE I ËSHTË KUSHTUAR NJË PROCEDURE TË NJËJTË, KUR KEMI TË BËJMË ME TRUPAT E VIKTIMAVE TË

TERRORISTËVE.
PËR DALLIM NGA VIKTIMA E KOMBËSIVE TË TJERA, MBI TRUPAT E VIKTIMAVE-POLICËVE, TË USHTARËVE DHE FËMIJËVE - NUK ËSHTË USHTRUAR EKSPERTIZA, KA THËNË STANKOVIÇ, DUKE SHPREHUR QËNDRIMIN SE KA QENË DASHUR TË ZBARDHESHIN EDHE ATO TË DHËNA.
STANKOVIÇ KA SHPREHUR DROJËN SE KJO DEKLARATË, SI EDHE AJO E ËALKER-IT PËR VIKTIMAT E REÇAKUT, DO TË KALONTE E PA-NDËSHKUAR, KUR KEMI TË BËJMË ME ME MEKANIZMAT NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË. PËR KËTË, SIPAS FJALËVE TË TIJ, NJË ROL TË MADH LUAJNË GAZETARËT - PËR MANIPULIME MEDIATIKE - TË CILAT EDHE SOT PLASOHEN ME SUKSES PËR PUNËN E REÇAKUT. STANKOVIÇ KA THËNË SE GAZETARËT JANË BËRË "FUQIA E PARË NGA TË QENË E SHTATA".

KOSOVA - NGA MEDIAT E HUAJA

B O N (TANJUG) 18 MARS 1999 - NË RASTIN E REÇAKUT, PA DYSHIM SE KA PASUR MANIPULIME, PORSE PËR KËTË GJË, MË SHUMË ËSHTË PËRGJEGJËS PERËNDIMI SE SA SHQIPTARËT E KOSOVËS, SHKRUAN "FRANKFURTER RUNDSHAU" NË KOMENTIN ME RASTIN E SHEFIT TË EKSPERTËVE FINLANDEZË PËR MJEKËSI GJYQËSORE, ZNJ. HELENA RANTA.
"KAQ GJATË ËSHTË ZVARRITUR PUBLIKIMI I RAPORTIT DHE ME SA MUNDIME HELENA RANTA KA SHPREHUR GJYKIMIN E SAJ, TEKSA HELENA RANTA KA SHQIPTUAR GJYKIMIN E SAJ, NDAJ, DYSHIMI PËR PUNË TË PISTA PATJETËR SE MBETET PEZULL", VLERËSON "FRANKFURTER RUNDSHAU".
REVISTA E FRANKFURTIT, NJËKOHËSISHT SHPREH DYSHIMIN NDAJ MOTIVEVE QË OSBE DHE QEVERITË E PERËNDIMIT I KANË VËNË PIKËN QË, PËR PUBLIKIMIN E RAPORTIT PËR REÇAKUN KANË ZGJEDHUR PIKËRISHT NË ÇASTIN KUR THYHESHIN NEGOCIATAT PËR PËR KOSOVËN .
"KJO DRAMATURGJI I BËN DËM TË MADH TË VËRTETËS… NËSE DIKUSH VËRTET DËSHIRON TË MËSOJË TË VËRTETËN E REALITETIT NË KOSOVË ATËHERË NUK KA KURRFARË NEVOJE PËR ASFARË MASAKRE - SIDOMOS JO PËR NJË MASAKËR TË MANIPULUAR, KONKLUDON "FRANKFURTER RUNDSHAU".
RAPORTI I HELENA RANTA NUK KA GËZUAR NDONJË PUBLICITET TË MADH NË GJERMANI. GAZETAT NUK KANË TITUJ KRYESORË, SIDOMOS JO NË FAQET E PARA; KURSE NË TELEVIZION, SHKARAZI PËRMENDET BRENDA RAPORTIT TË PËRGJITHSHËM MBI RRJEDHËN E BISEDIMEVE NË PARIS.
ËSHTË FITUAR PËRSHTYPJA SE KËTU KEMI TË BËJMË ME DIÇKA TË PAPËLQYE-

SHME DHE TË PADËSHIRUESHME - PËR INFORMATËN TË CILËN TË GJITHË DUHET TA PUBLIKOJNË, PORSE NUK JANË TË BIDNUR SE ËSHTË KREJTËSISHT E VËRTETË.

Për webin www. novinar.de: Srđan Marjanović
Burimi: http://www..novinar.de/2007/05/08/fbruqi-klupko-se-odmotava-o-istini-racak.html

Reagimi i Mr.sci. Flori Bruqit, nga Prishtina

Flori Bruqi
E nderuar Redaksi,
E lexova artikullin me titull "Nuk harrohet Reçaku" në web-faqen tuaj.
Është turp që dy shkencëtarë "të shquar" mjeko-ligjor, dmth: dy patologë ligjorë (Otasheviç dhe Dobriçanin) përhapin gënjeshtra në opinionin botëror. Tani do të keni rastin të mësoni të vërtetën mbi viktimat shqiptare, që ka korrë armata e juaj serbosllave, Njësitet Speciale dhe formacionet paramilitare, etj.
Klikoni në link dhe do të shihni se në cilën anë është e vërteta.

Mr.sci.Flori Bruqi, nga Prishtina
Prishtinë, 7.5.2007.

Komenti i Redaksisë
I nderuar, zoti Bruqi, ne vlerësojmë lajmërimin tuaj mbi artikullin "Reçaku nuk harrohet", i kolegut Toma Todoroviç, botuar më 03.05.2007. në gazetën Politika.
Ju lutemi të na tregoni se cilat janë ato të pavërteta në artikullin tonë, ashtu që të mund mund të kontaktojmë kolegun Todoroviç dhe ta lusim atë që edhe neve edhe juve të na përgjigjet me komentet e veta. Linkat tuaj janë shlyer përkohësisht.
Ju falënderojmë paraprakisht

Gazetari i webit www..novinar de: Sërxhan Marjanoviç
Burimi:http://www..novinar.de/2007/05/07/reagovanje-mrsci-flori-bruqi-naucnik-iz-pristine.html

7 komentime për "reagimin: Mr. sci. Flori Bruqi, nga Prishtina"

01

"Shkencëtari" nga Prishtina ka marrë komentet e redaksisë, ashtu siç i ka merituar. Unë nuk jam "ngatërruar" me artikullin "Reçaku nuk harrohet", duke u nisur nga shkaku se, për hilet shqiptare rreth Reçakut, tashmë di çdo fëmijë. Mbase jo edhe fëmijët shqiptarë në Kosovë e Metohi, të cilët qysh në djep janë ngopur me to. Mirëpo, të rriturit, që as u shkon ndërmend të lajmërohen sa për të na nxjerrin gjuhën. Me shlyerjen e "shkencëtarit nga Prishtina", redaksia më ka kursyer shumë punë, që të shpalos arkivin tim personal, ku përmbahen të gjithë artikujt kritikë dhe shtojcat e kthjellta mbi gënjeshtrat shqiptare dhe ato të NATO-s lidhur me Reçakun, që u sheshuan brenda një ap dy ditësh në shtypin e perëndimit, të cilëve manipulimet me Reçakun, gjithsesi janë shpënë tepër larg. Kohën dhe energjinë time e harxhoj temat aktuale, para së gjithash. Kurse, "Reçaku", tashmë edhe "zyrtarisht", madje edhe nga Tribunali anti-serb (me qëllim përdora shkronjën e vogël), është hedhur ad acta. Një gjë e tillë, natyrisht, nuk do t'i ketë shpëtuar "shkrimtarit". Porse, djalli nuk e lë rehat.

Svetisllav Kostiç: 8 maj 2007. ora 01:47

02

PO ZGJIDHET LËMSHI MBI TË VËRTETËN E REÇAKUT

(Reagimi ndaj letrës së S. Kostiçit)

Prishtinë, 8 maj

Redaksi e nderuar,

Pikë së pari, gazetari Vujadin Otasheviç ka përhapur të pavërtetën, sepse Kosova është nën protektoratin e UNMIK-ut, ndërsa nga viti 1999, nuk është më "krahinë jugore e Serbisë". Është e saktë se e vërteta është një e vetme, dhe ajo është e vërteta e viktimave të Reçakut (Kosovë) të vrara nga Njësitet Speciale të Armatës së Jugollavisë dhe MPB të Serbisë.

Fabula e prof. dr. Vujadin Otasheviç dhe prof. dr. Slavisha Dobriçanin, në librin: "Kosova - zëri i viktimave", është një kallëzim për fëmijë. Të dy shkencëtarët, para së gjithash, patologë të njohur dhe me reputacion ndërkombëtar, do

duhej të kishin thënë vetëm të vërtetën. E vërteta gjendet tek fotografitë e masakrës mbi fëmijët e mitur dhe shqiptarëve të rritur, më 15 janar 1999, në fshatin Reçak afër Shtimjes, në Kosovë. Librin e tyre nuk e kam lexuar, porse di mirëfilli se ç'kanë bërë patologët mjeko-ligjorë lidhur me viktimat e pafajshme. Nuk ka ekzistuar asnjë lloj mashtrimi nga ana e UÇK-së, gazetarëve kosovarë dhe medias ndërkombëtare. Mashtrimi ka ndodhur në "Qendrën e Medias" në Prishtinë, pikërisht nga ana e medias serbe, shërbimeve të inteligjencës, KOS-it të AJ, Njësiteve Speciale të MPB të Serbisë. Masakra aka ndodhur, dhe aty janë vrarë barbarisht shqiptarët e pafajshëm, dhe atë...….. Padronët kryesorë të masakrës mbi qytetarët e pafaj, janë....
Shefi i misionit verifikues të OSBE-së në Prishtinë, gjenerali amerikan, Uiliam Uoker ka shpallur forcat policore të Serbisë të ishin kriminelë në Kosovë, dhe më pas, ndodhë edhe shkaku që NATO të bombardojë Serbinë dhe Malin e Zi.
Menjëherë më pas, Bill Klintoni, president i SHBA-ve, paralajmëron sulmin shkatërrimtar të Jugoslavisë. Klintoni kishte pas vetes Riçard Holbrukun, Uezli Klarkun liderët e shumtë dhe të shquar të botës.

Klikoni në linkat dhe do të bindeni se në cilën anë qëndron e vërteta për masakrën e shqiptarëve të pafaj në Kosovë, zotëri Kostiç. Do të kishte qenë më mirë të shpenzonit më shumë përpjekje dhe kohë, dmth. energjinë tuaj në shërbim të zbardhjes së të vërtetës që ju rri si ankth, dhe do të ju rrijë gjithë jetën tuaj. Sepse ka një Zot, dhe ne i besojmë edhe Zotit edhe të vërtetës!!!
Urdhëroni të polemizojmë, veçse ekskluzivisht me argumenta, e jo me historinë e shpifur dhe propagandën që përhapni ju, z. Kostiç, për shpëlarjen e trurit, edhe ashtu tashmë të njohur botërisht në popullin tuaj Serb!!!
Flori Bruqi
8. maj 2007. u 12:41

03
Shkencëtarit nga Prishtina, i cili, sipas çdo gjase, dhe falë, besojmë - pushtetit të Jozef Sloser, ka ngjarë edhe të bëhet shkencëtar; në atë periudhë flitej, nëse nuk më tradhton, po deshët që eventualisht të vinit deri tek diploma, atëherë, thjesht shkoni në "Universitetin" e Prishtinës, sepse atje diplomat shpërndahen thjesht.
Ka shumë argumenta që mbështesin qëndrimin se Reçaku nuk ka qenë një masakër sitematike, "Mashtrimi i Reçakut" nga Diana Xhonston, Paris, 20 ja-

nar 1999. Nuk ishte hiçgjë tjetër, veçse një grup i armatosur i rebelëve, krye-sisht kriminelë, ishin strehuar në atë fshat si civilë. Në Konventën e Hagës, të vitit 1905, gjë që më pas vërtetohet edhe nga Konventa e Gjenevës, ku thuhet se vendbanimet, spitalet dhe objektet me rëndësi civile, nuk guxojnë të bombardohen, përveç nëse nuk keqpërdoren si të tillë. Ata kriminelë që kanë shpërdoruar vendbanimin civil, ende nuk janë sjellë para gjyqit. Zotëriu "shkencëtar" ketë gjë, së paku do duhej ta dinte. Pastaj, "masakrën" në Reçak e ka mohuar dhe vetë Millosheviçi në Tribunalin e Hagës, për ç'gjë më vonë u desh të vdiste në burg, për të mos mbaruar gjyqi.
Në luftëra, e sidomos të këtij lloji, ndodhin edhe gjëra më të pështira. Po të ishte "shkencëtari" i krishterë, do t'i thosha kshtu: 'Ti sheh ferrën në syrin e tjetrit, porse nuk sheh trungun në syrin tënd'. Po, zotëri shkencëtar. Pikërisht kështu.
Ç'të bëjmë me viktimat që zhbënë të pafajshmit nga bombat e NATO-s? Ajo masakra e bombardimit të trenit të udhëtarëve, me masakrën e bombardimit të Studios së Televizionit të Serbisë në Beograd, masakrën e Aleksincit, dhe pastaj bombardimi i kolonave të refugjatëve në Kosovë? Kaq shumë vikti-ma të pafajshme dhe qytetarë, sot në Irak, Afganistan, dhe gjetkë... mos t'i numërojmë???
E, ç'të bëjmë me më të madhin krim lufte pas Luftës së Dytë Botërore dhe vrasjes së paku të 900 civilëve serbë, qyshse anarkia mori pushtet në Kosovë??? Dëbimi i mbi 200 mijë qytetarëve të pafajshëm serbë nga Kosova??? Dhe kështu me radhë. Lindja e re naziste, me në krye të politikanëve të Amerikës dhe duke përfshirë aty edhe skizofrenikun më të madh, pas Hitlerit, Bill Klintonin, vështirë se mund të qëndrojë pas këtij konstelacioni aktual. Në Amerikë sa vete dhe shtohet rezistenca e politikës skizofrenike. Duket se priten kohë më të mira, kur shkencëtarët, siç është Flori Bruqi, kur një ditë do të gjenden në vendin që kanë merituar, për përhapje gënjeshtrash dhe urrejtjes.
Janko Bojiç,
8 maj 2007. ora 13:24

04
Përgjigjjet në letrën e z. Svetisllav Kostiçit dhe z. Janka Bojiç
LËMSHI PO ZGJIDHET (Letër e hapur)
E nderuar Redaksi, gazetari.de
Bashkangjitur letrës, keni përgjigjjet me titull: "Lëmshi po zgjidhet", botuar sot në Ëeb-faqen http://floart-press.blogspot.com .

Ju falënderoj paraprakisht.
Flori Bruqi
(Flori Bruqi, është magjistër i shkencave kineziologjike. Deri tash ka botuar shumë punime shkencore anembanë Jugosllavisë, dhe 20 libra (romane) e 6 libra shkencorë nga fusha fiziologjike e psikologjike të kineziologjisë).
Jeton dhe vepron në Prishtinë.
Pason artikulli:Përgjigjja për "Masakrën e Reçakut"
Politika, Shoqëria, Aktualiteti, 7 maj 2007.
Reagimi: Mr.sci. Flori Bruqi, nga Prishtina

Redaksi e nderuar,
E lexova artikullin me titull "Reçaku nuk harrohet" në ëeb-faqen tuaj.
Turp, nga dy "ekspertë të shquar mjeko-ligjorë; dmth. patologë ligjorë (Otasheviç dhe Dobriçanin) që lajthitën opinionin botëror. Tani keni rastin të mësoni të vërtetën mbi viktimat shqiptare që shkaktoi AJ, Njësitet Speciale, formacionet paramilitare, etj.
Klikoni në linkat dhe do të bindeni se kush është e vërteta.
Prishtinë, 7 maj 2007.
Mr.sci.Flori Bruqi, shkencëtar dhe shkrimtar nga Prishtina
Komenti i redaksisë
I nderuar zoti Bruqi, vlerësojmë pikëpamjet tuaja mbi artikullin "Reçaku nuk harrohet" nga kolegu ynë Toma Todoroviç, botuar më 3 maj 2007, në gazetën Politika. Ju lutemi të na tregoni se cilat janë të pavërtetat në artikullin e cituar, ashtu që të mund të kontaktojmë me kolegun Todoroviç dhe ta lusim të na përgjigjet edhe neve edhe juve.
Linkat e juaj janë fshirë përkohësisht. Ju faleminderit.
Flori Bruqi-Prishtinë,
8 maj 2007. ora 16:27

05
Moderatori i "Floart-Pres-it", zotëri Flori Bruqi nga Prishtina, ka marrë shumë komente të lexuesve në temën "Hapur për Kosovën". - Kosova nuk është krahinë e Serbisë, porse Shtet i Pavarur dhe Sovran".

HAPUR PËR KOSOVËN

Kastrioti:

Ju qenkeni një ari. Flini shumë. Ku keni qenë gjatë gjithë këtyre viteve dhe nuk i keni mësuar të vërtetën bashkëkombëtarëve tuaj? Është një turp i pafalshëm për ju, ndonëse jeni në moshë, porse nuk më vjen keq pse them kështu, sepse ju dhe bashkëmendimtarët tuaj që ju mbështesin. Vallë, pas kaq shumë vitesh nuk keni mësuar gjë për të qenë, së paku spirituoz. Mos e keni patur larg ASHS, apo, qysh nga vitet '80-ta keni llogaritur se do të përfitoni gjë nga heshtja? Ku keni qenë në kohën e Millosheviçit? Pse nga fundi i viteve nuk i keni folur "të mençurit", por pas kaq vitesh u treguat të marrë, pikërisht nga ideologjia e juaj. Turp.

Zotëriu – 011

Ç'të thuhet rreth këtij komenti të vërtetë. Do të ishte vërtet i tepërt çdo koment.
Unë, këtij analisti do t'i rekomandoja, që të mos japë këso intervistash, sepse SRS-ja do të reagonte me ndonjë atentat mbi ju, zotëri, dhe, natyrisht që Koshtunica do ta përgatiste me Palmën dhe Veljo Iliçin. He-he-he-he-he

---

Ismail

E lexova artikullin tuaj dhe më pëlqeu shumë. (pa emocione). Por pyes veten, ku ishit ju dhe bashkëmendimtarët tuaj, dhe e di se jeni shumë sosh, kur në vitin 1989, fashisti Millosheviç ndryshoi kushtetutat e Kosovës dhe të Vojvodinës me dhunë shtetërore. Ndonëse atëbotë vota juaj ka qenë "minore". Këto ditë pres shumë njerëz tuaj intelektualë, që të shkruajnë siç duhet, bashkë me bashkëmentarët tuaj. Sidoqoftë, ju falënderoj për artikullin tuaj.

Muki – London

Është hera e parë që lexova nga intelektualë serbë një koment kaq të sinqertë (ndonëse jo të plotë) mbi Kosovën. Do të kishte qenë më mirë të shkruanit për

gjenocidin që ushtroi regjimi serb mbi shqiptarët e Kosovës. Po të vepronit ashtu, do t'i jipnit edhe popullit tuaj. Megjithatë, ju falënderoj për komentin dhe shpresoj se edhe në të ardhmen do të paraqiten intelektualë që do të flasin dhe të shkruajnë të vërtetën dhe do të kontribuojnë për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet shqiptarë e serbëve. Vetëm e vërteta (sado e dhimbshme) do të rregullonte marrëdhëniet midis dy popujve. Përshëndetje të shumta, Muki-Londër.

Ahmet Delija

Është një punë e lehtë kur njeriu flet të vërtetën, siç bëri zotëriu Desimir Toshiç. Porse, ndryshe del puna kur ke të bësh me qeverinë serbe. Sepse ai që flet të vërtetën, shpallet tradhtar i popullit, ndaj njeriu i tillë vë në rrezik veten dhe duhet të ruhet se mos e vret kush. Serbia çmon vetëm politikën e gënjeshtrave dhe propagandës, sepse në qeveri ka komunistët, dhe i duhet të presë që gjeneratat e reja të vijnë në pushtet.
Ahme Delija

Vlado 038

Zotëriut të nderuar do t'i kisha bërë disa pyetje: A kanë qeverisur shqiptarët para serbëve në Kosovë, apo flisni për tezën se janë ilirë, të cilëve sllavët ua kanë pushtuar territoret? Kur është ngritur Tempulli i Zonjës së Bekuar, (pasi që ju ngulmoni të thoni se serbët kanë ardhur në shek. 13). Çfarë origjine ka Gjergj Kastrioti? Unë personalisht jam për korrigjimin e "padrejtësisë historike" dhe Kosovën t'ia kthejmë Turqisë, si edhe territoret që u kanë takuar gjatë sundimit të Sulejmanit të Madhërishëm, dhe: njëherë e mirë të vendosim për çështjet e kuazi-intelektualëve të Beogradit.

DRAGICA

KASTRIOT, SI S'KENI TURP TË FLISNI ASHTU? MË MIRË VRISNI VETEN SESA TË JU VRASË TJETRI, DHE TË PËRGJIGJET SI PËR NJË NJERI, NDËRSA AI KA VRARË BISHËN.

29.01.2007. 22:52:51 Zhegra99

Z. Toshiç, do të doja të ju them diçka që vërtet mendoj, porse nuk ma merr mendja se moderatori do ta botojë komentin tim. Por, do të përpiqem në mënyrë diplomatike, ndonëse nuk jam diplomat. Ku keni jetuar ju deri tash? Ka të drejtë Kastrioti, kur ju thotë se jeni një ari dhe se flini shumë. E dini ju, vallë, sesa mijëra shqiptarë ka vrarë ushtria juaj, policia e paramilitarët? Sa mijëra shtëpi ka djegur? Keni rrëmbyer çdo gjë që keni mundur, dhe tash thoni se Kosova është krahinë e Serbisë!!!!. Kush do ta paguajë gjithë atë dëm, z. Toshiç? Të jeni të sigurt, zotëri, se ne këto nuk do t'i harrojmë kurrë. Në këtë botën tonë kthehet gjithçka dhe paguhet. Turp. Porse, paksa diplomatik.

Prishtina Rules

Epo, pikërisht kjo është ajo që ne po përsëritim tash dy dekada, zoti Toshiç: Se çdo pushtet që nuk del nga populli, ai pushtet është kolonizues! Në vend se të punohej në marrëveshje me shumicën e popullatës në Kosovë, regjimi i juaj ka punuar për rrënimin e autonomisë sonë; ka bërë shtypje dhe ka shkaktuar luftën, që më pas të na shpërngulte, si rasti në Bllacë. E pra, kjo nuk polli gjë të mirë dhe ju tash nuk keni tjetër përveçse DUHET ta kuptoni realitetin: se shumësia më e madhe e popullatës është për formimin e shtetit të vet. Kur them shumësia, mendoj tek popullata e madha e moshav nën 30 vjeç. Dhe ata jnë plotë energji dhe mezi presin shtetin dhe identitetin e vet. Përndryshe, una kam një sipmati ndaj jush. Unë nuk e kuptoj pse askush në Serbi nuk ju ka përfillur deri sot. Por, ta dini se, nëse nuk e pranoni shtetin tonë të ri, ne sigurisht se nuk do të ikim askund, por do të jemi fqinjët tuaj të parë.Ju duhet të bashkëpunoni me ne, dhe jo të na injoroni. Mendoj se nga ju pritet shumë punë për të bërë dhe për të filluar të mendoni mbi 100-vjetëshin e paqes ndërmjet Republikës së Pavarur të Kosovës dhe Republikës së Serbisë, si dy popuj që jemi.

Nazif

Z. Desimir Toshiç e ka parë të vërtetën ballë-për-ballë: serbët duan që me mite të mbajnë Kosovën; me mite të shpifura. Po të kishin gjykuar racionalisht e realisht, dhe të linin Shqiptarët të gëzojnë të drejtat e veta si nikoqir

në shtëpitë e tyre me kohë, do të kishte qenë më mirë për Serbinë: Kjo do të rregullonte raportet e vërteta!

Krasniqi

Keni të drejtë, zotëri Toshiç. Njerëzit qeverisin vendin dhe jo manastiret e kishat. Mbretëritë dhe qeveritë tuaja kan provura me shekuj ta popullëzojnë Kosovën me Serbë, porse një gjë e tillë nuk dha fruta. Duket sheshazi se ju tani e keni kuptuar atë fabulën e dhelprës dhe rrushit.

Agron GL

Po, interesante!!!! Mirëpo, interesante është edhe të lexosh komentimet e të gjithë atyre që ju mbështesin dhe ju sulmojnë. Sidomos kur sulmoni. Edhe unë jam shqiptar, siç jeni ju serb, porse sigurisht që nuk do të flas me dy fytyra, siç bëni ju. Zotëriut Toshiç i ka ardhur koha për të parë të vërtetën e vërtetë. Unë atë, kësaj here e kuptoj plotësisht. Mirëpo, e kam shumë të vështirë kur mendoj njerëzit e mi dhe farefisin, që më ka bërë represion e dhunë policore, pas lirimit nga burgu... Eh, miqtë e mi, por edhe qeveria shqiptare e Kosovës, e cila na shihte si armiq. Të gjithë që përmenda, kanë qenë patriotë të përbetuar për realizimin e Pavarësisë së Kosovës. Kurse ju, sulmoni z. Toshiçin pse nuk ka folur me kohë për këto gjëra. Ka rëndësi, herëdokur që të flisni, dhe jo të heshtni përgjithmonë. Unë mendoj se ai foli kur u desht, sepse edhe shqiptarët edhe serbët ndodhen në një situatë shumë të rëndë dhe delikate. Serbët të pranojnë Kosovën e Pavarur, kurse shqiptarët, të shtrijnë dorën e pajtimit me serbët, pas kaq shumë gjakderdhjesh. Deshëm ne apo jo, do ta bëjmë patjetër. Patjetër. Edhe ne jemi ata që në të ardhmen do të bashkëpunojmë me Serbinë, dhe jo anasjelltas (prishtinarules). Zoti Toshiç është historian dhe unë shpresoj shumë se në një të ardhme të afërt do të botojë librin për të vërtetën dhe do ta promovojë. Jam i sigurt se ai do t'ua kthjellojë mendjet. Dhe jam i sigurt, mos u brengosni se ju vret kush, sepse të parët në listë janë ata që përkrahin Pavarësinë, si Çedomir Jovanoviç dhe shumë të tjerë. Z. Toshiç nuk është i vetmi dhe i fundit që flet kështu. Këso fjalimesh do të dëgjohen shumë shpesh në të ardhmen.

Radosav

Nëse zoti Toshiç qenka një ari, kurse ti, zoti Kastrioti sigurisht je një majmun. Ju shqiptarëve nuk ju pëlqen asnjë kapele. Edhe kur njeriu ju thotë se Kosova është e juaja, ju e pysni - pse nuk keni thënë kështu më herët. Nëse do të kishe lexuar sado pak, Kastriot, atëherë do ta kishe ditur se zoti Toshiç ka shkruar për këto gjëra qysh nga vitet e 50 të shekullit të kaluar, dhe këtë tezë e ka mbrojtur gjithherë. Për gjëra të tilla ka qenë i detyruar të kalojë jetën nëpër botë, pikërisht shkaku i represionit të regjimit komunist, në të cilin keni marrë pjesë dhe ju shqiptarët. Mirëpo, nuk ke lexuar, Kastriot, sepse ti atëherë ke qenë i zënë duke ngarkuar thëngjill.

Mister_011
Kastrioti, mos shkruaj në emër të shqiptarëve, sepse të gjithë dimë se ti je një serb që shkruan në emër të shqiptarëve. Mirëpo, më vjen mirë që ke filluar ta pranosh kombin që i takon dhe gjuhën që flet, sepse nuk do të ketë vend në Kosovë për ata që nuk do të dinë shqip.

Svetislav Kostic
Edhe një pasqyrë e shkurtër e komenteve të arritura, ilustron se nga parimi i redaksisë "le të dëgjohet dhe pala tjetër", u shndërrua në një forum, ku edhe separatistëve shqiptar u mundësohet që të zbrazin urrejtjen ndaj serbeve dhe serbëve, sa të duan. Unë ende nuk e kam të qartë politikën tuaj redaktuese. Qëndrimet e zotit Toshiç, historianit? mbase ato, në e parë, cilësojnë faktet historike të vëna kryengulthi. Mirëpo, edhe qëndrimet e ndryshme nuk i vlerëson si marrëzira. Me gjithë vërejtjet e themeluesve, se: "përmbajtjet fyese dhe ato të papëlqyeshme(…)". Apo, kjo do të thotë se kjo vërejtje e themeluesve na qenka selektive? Përshëndetje të përzemërta nga Hamburgu nga, Svetislav Kostic

---

Besim Bytyqi
Vllado, të lutem, nëse e di Zotin, çlirohu nga ajo barrë që i ke vënë vetes mbi supe kot së koti, sepse do të të gjejë ndonjë e ligë. Ti quaji si të duash, porse unë e di se kush i quan shqiptarët "zhugana", sepse ti dikur e quaje Albaninë-Shqipëri. Ti je përkatës i atij populli. Në Beograd kemi pallatin Albania, dhe ti

do ta quajsh Pallati Shqiptar. Auuuuuuuuuuu. Kur flas me ty unë flas serbisht, unë të them se je serb, kurse kur më pyet ndonjë shqiptar për ty, unë i them se ai është shkja. Dhe do të të vijë mirë, sepse vetes sate do t'i thuash se dikush të ka quajtur serb, ani që nuk je.

Mustafa

Kam lexuar edhe seç ka thënë Qosiçi, aferim - ai është një serb i vërtetë - ai që njeh popullin e vet dhe prejardhjen, sepse pak serbë i njohin rrënjët e veta. Unë për vete jam shqiptar dhe ju siguroj se ne serbët i kemi pranuar për fqinj. Unë personalisht kam ruajtur bagëtinë me fqinjin tim serb, i kam ruajtur bagëtinë dhe i kam ruajtur shtëpinë, sepse e kisha fqi. Kurse, ai i krisuri, Milloshevіç, arriti t'i mashtrojë, dhe rrjedhojën e dinë mirë e gjithë bota. Ja se ç'po ndodhë tashti me serbët, dr. Koshtiunica flen dhe ëndrron...

Hajrizi

Më vjen keq për nivelin e komentit (qofshin ata nga shqiptarët apo nga serbët) që kanë mbështetur qëndrimet dhe argumentat e zotit Toshiç. Përpjekjet e njerëzve të guximshëm, të urtë dhe të ditur, që hedhin dritë për këto hapësira, natyrisht se duhet mbështetur dhe lavdëruar. Fyerjet dhesjelljet e pamatura të autorëve të komenteve, flasin kryesisht mbi shkallën e tyre intelektuale dhe njerëzore, gjë që është për t'u vajtuar dhe gjykuar. Mbështetja e së vërtetës së z. Toshiç, është shprehje e asaj se sa ai, i nderuari, e do popullin e vet dhe ka dhënë kontribut të rëndësishëm për të. Populli serb ka një plejadë njerëzish që tashmë shumë dekada flet për ato që ka bërë z. Toshiç, për çfarë edhe i kam lakmi. Njerëz të tillë bëjnë punë të mira për interesat e popullit të vet (por edhe të të tjerëve) dhe ata shumë bukur e dinë se fati i një populli nuk mund të varet nga gënjeshtrat dhe faktet irrelevante historike apo etnike. Në fund dua të përshëndes guximin e z. Toshiç, por edhe shumë serbëve të tjerë, të cilët i hedhin dritë të vërtetës dhe argumentit, dhe jo pasojave të gënjeshtrave e mashtrimeve që kanë shkaktuar shumë viktima, vuajtje e gjakderdhje.

Goran nga Republika Serbe

- Komenti im për shqiptarët, është që ata do të paguajnë për të gjitha krimet

dhe për grabitjen e tokës sonë serbe, për kalljen e manastireve, për therjen e fëmijëve serbë. Ju do të paguani për secilën pikë të gjakut serb. Kur padronët e botës të kuptojnë se shqiptarët janë vetëm dilerë të vegjël dhe mysafirë të AL-kaidës. Ju pret në bejleg Brigada e 16-të e motorizuar e krajishnikëve.

Besim Bytyqi
O Goran, mirë se erdhe dhe mirëse do mbetesh këtu. E di se po bën humor, por më mirë shpjego për brigadën e traktorëve… Ti je diku i fshehur. Eja, ka këtu shumë burra që duan të të shohin ata trima. Vetëm urdhëroni. Por, e di se nuk vini. E keni lepurin në bark. Kurse ata që do të vinin, nuk do të flisnin siç flet ti, o trim… qofshim gjallë dhe u pafshim...

Vlado 038
Komentin tim të korrigjuar e kam dërguar tek redaktorët e kësaj faqeje, porse nga komentet tuaja dhe ato të mia, zoti Besim Bytyçi, shihet qaertë se paskam pasur të drejtë. Për sa i përket Pallatit "Albania", ai quhet ashtu sepse vendi prej nga është tërhequr armata serbe në Luftën e Parë botërore, dh në shenjë falënderimi Shtetit shqiptar, i cili ka pranuar duarhapur që të ndihmojë ushtrinë Serbe dhe popullatën që kishte pas. Kanë ndodhur edhe plaçkitje edhe vrasje, porse, siç thoni ju shqiptarët: "as gishtërinjtë e dorës nuk janë të njëjtë, pale më njerëziti…" Ne serbët, dorën e zgjatur dhe veprën e mirë nuk i harrojmë kurrë, andaj do të njohim kët Pallat që e quajmë "Albania", dhe unë do t'u tregoj të gjithëve se mbaj korrespondencë me një shqiptar, porse kurrë nuk e quaj "zhugan", sepse një gjë të tillë nuk ma lejon edukata familjare

---

Agroni Pz
Ju faleminderit, zoti Toshiç! Në këtë kohë të vështirë për të dy popujt, e vërteta duhet të dalë në shesh. Ne jemi dy popuj të ndryshëm, dhe më vjen keq pse serbët kanë paragjykime për ne. Shumësia e serbëve na konnsideron si pastrues rrugësh, etj. Shumë pak dinë për shkrimtarët, artistët, muzikën… kurse kanë patur rastin që gjatë 94 vjetëve të kaluar të mësonin shumë gjëra për një popull fisnik dhe jashtë kornizave politike. Serbët erdhën në Kosovë me ushtrinë e tyre dhe me të u tërhoqën gjatë gjithë atyre viteve; u sollën si ardharakë dhe jo si nikoqirë, sepse e dininin se nuk janë në vendin e vet.

Fatmiri
Zoti Toshiç, kurrë nuk është vonë. Është mirë që tashmë dikush po flet hapur dhe po e thotë të vërtetën. Sa për komentet e disa "banalëve", nëse mund të shprehem ashtu, nuk mund të them se mendoj që ashtu nuk mendojnë të gjithë shqiptarët, siç tha Radosavi; porse disa flasin me emocione të ngatërruara dhe fyejnë. Mendoj se në të ardhmen, shumë intelektualë serbë do ta marrin fjalën dhe do të flasin të vërtetën, ashtu siç keni bërë dhe ju. Presim që edhe politikanët do të flasin hapur për Kosovën, ashtu siç tashmë bën Çeda. Faleminderit për mirëkuptimin

---

Kosovari
Goran, mos u kërcëno, se derisa të vijë koha, ju nuk do të ia dini as emrin Brigadës së Motorizuar 16-të! Mbase as do të ketë republikë serbe fare, e ndoshta as "krajishnikët" që ikën dhe u fshehën në vrimën e miut, kur u përballuan me Shtrëngatën... ha ha ha! Të lutem të mos lajthitësh popullin kundër serbëve, sepse do të të kthehet si bumerang. E, sa për qelitë, ti e di mirë se sa bukur gënjen dhe sa i rëndë je.

Dragani
Ha, ha. Shkëlqyeshëm që keni gjetur një matuf për t'i bërë qejfin shqiptarëve të Kosovës. Vetëm njerëzit që i ka prekur seniliteti mund të flasin ashtu si ai tip. Historia e argumentit qëndron fort, po si edhe përmendoret në Kosovë, që ju doni t'i hidhni në erë dhe t'i rrafshoni me tokën. Serbia përjetë.

Liridoni
Përshëndetje, Goran i republikës serbe, pse nuk vjen ti këtej? Eja, eja, mezi presim të të shohim, sipas sistemit: "ndoshta ti i shkruajte ato fjalë për ne. Secili serb që ka bërë vepra kriminale e të pista mbi popullin tonë, kurrën e kurrës nuk do të bëjë gjumë të rehatshëm „Ne do të marrim hak kudo, o në Rusi o në Serbi. Nëse nuk ju zëmë juve, do i zëmë bijtë dhe nipërit tuaj. Ju jap besën dhe fjalën e nderit që, sapo të ju gjejmë, kurdoherë, do ju… përshëndesim!

Shqiponjat e Malësisë
Ti vetëm prit, Goran. Por, ne atje nuk do jemi. Mund të të ndihmoj, çetnik. Eja në Mal të Zi, sepse atje do pëlcasë puna, dhe do pëlcitësh edhe ti.

Muki _London
O Goran i zi, mos u kërcëno, sepse ju mirëpresim ju dhe bashkëmendimtarët tuaj, herëdokurë. E, sa për kërcënimet që bën ti, ato do t'i përjetosh në lëkurën tënde… Vetëm eja njëherë. Të presi me shuuuumë zjarr.

Shqiptari
Ti zotëri flitke për fabula, porse të jeshë i sigurtë se populli shqiptar nuk trembet nga profkat. Kurse për dilerët e drogës dhe Al-Kaidës, ti nuk ke kapacitet t'i tregosh botës për kohët e shkuara! Bota kaherë i ka kuptuar ato gënjeshtra të kulluara në ish-Jugosllavi. Këtë e ka vërtetuar Mali i Zi - ata nuk duan të jenë me ju, pale pastaj shqiptarët! Sa për Brigadën tuaj të 16-të, le të shtrëngojë prapanicën dhe të vijë në Kosovë sa më parë. Kjo kohë na vjen përshtati të pastrojmë llogaritë që na i keni borxh. Tashmë, përveç Amerikës, na njohu dhe gjysma tjetër e botës.

Vizitori anonim
E tmerrshme… nga një intelektuar i tillë… Zoti Desimir Toshiç nxori vetëm konstatimin e argumentit të gjendjes, kurse provat e tij janë të tej-gabuara. Një gjë e tillë edhe i përket një intelektuali të ashtuquajtur… Të gjitha përgjegjësitë i mban Akademia e Arteve dhe Shkencave të Serbisë, ju dhe dijetarët e tillë… Zotërinj, nëse jeni ateistë, atëherë e dini mirëfilli se njeriu ka zbritur nga druri, sipas teorisë së Darvinit, e cila është pranuar botërisht. Nëse jeni besimtarë, atëherë do ta dini se bota është e Zotit dhe e askujt tjetër… Përfundimi - rrëfimi për shekullin 13-të dhe e kujt ështa toka, nuk ka lidhje me këtë punë. Shekulli 20 ka qenë përpjekje që populli gjerman të bënte ato që po përpiqen të bëjnë Serbët në Kosovë. Në kohën tonë të sotme, ato po i bën SHBA-ja, Rusia, Kina, India, Turqia, porse shumë më sofistikuar. Përfundimi - përralla se teoritë sot nuk kanë të njëjtën vlerë, janë poashtu të gabuara, sepse një gjë të tillë e kam argumentuar konsiderueshëm në rreshtat më lart. E drejta për vetëvendosje e një populli, është e drejtë universale e secilit

popull, ndaj edhe të popullit serb. Dmth: nëse shqiptarët paskan të drejtë për vetëvendosje, atëherë ajo e drejtë duhet ta gëzojnë edhe serbët në Bosnjë, edhe rusët, rusët në Osetia, edhe kurdët e palestinezët… Përfundimi - krahasimi në situatën aktuale, i takon edhe gjendjes në Kosovë. Për fund, më duhet të ju them se shqiptarët fituan atë që deshën, mirëpo dua të konstatoj se ata KURRË në histori nuk kanë dashur të jetojnë me serbët në një shtet. Për fat të keq, mungesa e sinqeritetit na ka kushtuar shumë shtrenjtë. Tash unë pyes veten - vallë, të jetë problemi tek ne, apo tek maqedonasit, malazezët, grekët... apo tek shqiptarët dhe ambiciet e tyre shumë të mëdha…

Dani

Goran, a do të kam fatin që të gëdhijë dita që dhe unë të të shoh kokën nga shënjestra e snajperit? Ju, serbët e mëdhenj jeni p… sepse prej Sllovenie deri në Kosovë, tashti keni një Serbi shumë të madhe, dhe mbase do ta bëni edhe më të madhe kur të ju shkëputet Vojvodina, pastaj Sanxhaku dhe Kosova Lindore "Lugina e Preshevës". Atëherë mund të ndiqni NTB-në nga Moska në pashallëkun e Beogradit

---

Kroati

Përshëndetje, Goran i republikës serbe, para se të nisesh në Kosovë, merr parashikimin për motin, se mos po takohesh me ndonjë "shtrëngatë", apo "vetëtimë".

Boshnjaku

Goran, o kafshë!!! Republika e maleve është ngritur mbi eshtrat e popullit boshnjak. Dhe për këtë fakt, ajo duhet shkatërruar. Bota nuk guxon të lejojë një përbindësh të tillë që të qëndrojë në territorin e Bosnjës, sepse një gjë e tillë do të ishte degradim moral i qytetërimit njerëzor.Kosova asnjëherë nuk ka qenë pjesë e ndonjë shteti serb, njësoj sikurse edhe Bosnja nuk ka qenë pjesë e ndonjë shteti serb. Gjatë 80 vjetëve të fundit, shqiptarët kanë qenë të shtypur vazhdimisht nga regjimi serb. Tashmë është pjekur koha që shqiptarët e Kosovës të merren me fatin e tyre, ashtu që Beogradi të mos vendos për ta: çka dhe si mund të bëjnë apo të mos bëjnë.

Smajo
Duke lexuar artikullin e z. Toshiç, gjithnjë e më shumë po më ushqen shpresa se edhe në Serbi ka njerëz që mendojnë me mendje të kthjelltë dhe shohin gjërat ashtu siç janë, dmth: reale. Nuk do të merrem me hollësi, porse me tërësinë që i përgjigjet realitetit. Natyrisht se kjo është në shpërputhje me qëndrimet aktuale politike në Serbi. Porse faktet janë kryeneçe, derisa politikanët filluan të tërhiqeshin dhe t'i linin "pataten e nxehtë" në duar të tjetrit. Zoti Kryeministër tashmë "nuk ka autorizime" për të pranuar zotin Ahtisari, porse kjo është një çështje e rrjedhojave të politikës së tij të deritashme. Kujt do t'ia lërë fajin tani? Po lexoja diku se disa të ashtuquajtur "krajishnikë, me brigade të motirzuara", se njëfarë Gorani nga republika serbe - thërret shqiptarët për dylyftim". Kësaj do t'i përgjigjesha shkurt: Shqiptarët nuk kanë kohë të për të humbur, sepse janë duke ndërtuar shtetin e tyre, kurse ti zotëri, që jeton në mesjetë, gjeni ndonjë të tillë siç jeni ju dhe gostiteni me "brigadat tuaja të motorizuara".

Rony
… kështu qëndrojnë punët, o miq. Nëse e kthejmë kohën e përparme, kur kemi mësuar në shkolla, (kush më parë dhe kush më pas) historitë e popujve tanë në shekuj, gjithnjë i kemi thënë vetes se ata janë marrashë, primitivë, duke menduar se ne jemi të mençr. Por, kur shohim se (nëse historia flet të vërtetën) më nuk ka dinozaurë e mamuthë që kanë jetuar në ketë planet ku jetojmë ne sot, atëherë lehtë mund të konstatojmë se ata nuk jetojnë më në këtë botë, ndaj na e kanë lënë neve. Prandaj, edhe ne do të ikim dhe do t'u lëmë pasardhësve, kurse pasardhësit ndoshta nuk do t'i lënë asgje askujt! Po të ishin njerëzit tanë të mençur, ne sot do të jetonim për merak dhe të qetë: Serbët do të ishin në Karpate e Siberi, kurse ahqiptarët në atdheun e tyre. Porse, serbët erdhën për të bërë dëme dhe për të shkulur shqiptarët nga vendi ityre, e Shqiptarët ç'të bënin - të mbronin atdheun. Kështu ky problem është shtrirë nëpër shekuj, dhe do të zgjasë derisa njerëzit të vetëdijesoheni. Unë them se serbët duhet të jenë të ndershëm dhe të mençur: të kthehen në Serbi dhe të kuptojnë marrëdhëniet e shëndosha me shqiptarët, ndaj ata e dinë mirë se shqiptarët janë më të mirët dhe më të ndershmit fqinj që kanë patur serbët. Nëse do t'i referohemi historisë reale të popujve sllavë, e sidomos Serbisë në territoriet ku ka krijuar shtetin serb, del se shqiptarët kurrënjëherë nuk e kanë pranuar atë shtet, sepse e kanë ngritur në toka të huaja. Ne nuk jemi aq marrashë sa mendojnë serbët për ne. Ne as që kërkojmë nga ser-

bët ta pranojnë të vërtetën, por duam që serbët të pranojnë të vërtetën, siç e kemi pranuar dhe ne: të na njohin dhe të na lenë rehat në trojet tona shekullore; të shtrijnë dorën fqinjve të ndershëm dhe të vazhdojmë të krijojmë një të ardhme me perspektivë për pasardhësit tanë dhe të tjerëve me radhë. Të gjitha që kanë ndodhur deri tash, nuk kanë sjellë asgjë të mirë. Përveç perspektivës që supozon z. Goran i republikës serbe. Serbia ka ngritur shtetin në troje të huaja. Ne e çmojmë historinë e Serbisë, porse edhe Atdheun tonë, sepse një atdhe tjetër nuk e kemi, pranda do ta mbrojmë. Mirëpo, ne jemi kaq të ndershëm (të krisur) për të pranuar bashkëjetesën me Serbët deri sot. Është e çuditshme se si Serbia përherë kundër të vërtetës reale. Askush nuk pyet se kush dhe çfarë ka qenë, porse pyet: si je dhe si i ke punët? Kjo do të thotë se nuk duhet kthyer prapa, nërrugë pa krye. As që e kuptoj se si është e mundshme që Kosova paraqet ndonjë rëndësi kaq të madhe për Serbinë, as për historinë. Gjatë ekzistimit të Jugosllavisë, nuk janë vendosur të gjithë shqiptarët në Kosovë, për ta nuk ka ditur as bota! Çështja është se Kosova nuk ka patur rëndësi as historike as territoriale për Serbinë. Serbët çdoherë i kanë trajtuar shqiptarët për majmunë, andaj është e natyrshme që një banor i qytetëruar, me origjinë serbe, e ka shumë të vështirë të pranojë bashkëjetesën me ata "që sapo kanë dalë nga xhungla"! Porse, kohët ndërrojnë: historia romake, bizantine, otomane dhe serbe, tashmë i takojnë të kaluarës. Andaj, njerëz, mendoni për ardhmen, për fqinjësi të mirë, sepse ne nuk jemi të lumtur të jetojmë me ju së bashku: ky është realiteti, të cilin njerëzit e mençur duhet ta pranojnë dhe kuptojnë. Vetëm ashtu ne do t'i kemi kokat të qeta. Harroni të mendoni se politikanët janë njerëz të mençur, sepse nëse ata thonë se populli ka të drejtë (për atë që thonë ata) atëherë populli nuk do të ishin bagëti, dele!…
Rroftë Shteti i Kosovës.

Mario Mollosi
Hej, Goran, nëse dikush duhet të paguajë, atëherë serbët duhet paguar për të gjitha krimet në Kroaci, në Bosnjë dhe në Kosovë. Sikur gjermanët ndaj hebrenjve, pas 60 vjetësh], kurse për ato fjalët që thua ti pë dilerët shqiptarë dhe qelitë e gjumit te Al-Kaida: botërisht dihet se aty jeni ju serbët. Kush po thotë dhe kush po gënjen se Shqipëria është e vogël?

Dukagjini99
Përshëndetje të gjithëve, sidomos z. Toshiç. Nuk desha të kyçesha me komentimet, porse më detyroi Gorani i republikës serbe. O Goran, komentimet tuaja janë aq primitive dhe jonjerëzore, sepse ashtu mendojnë vetëm egërsirat. Mirëpo, pasi që ti je nga republika e Serbisë, nuk çuditem shumë. Fëmijët e therur ishin shqiptarë. Shtëpitë e djegura ishin shqiptare. Gjaku i derdhur ishte gjak i qytetarëve shqiptarë. Je një person primitiv, Goran. Megjithatë, ju përshëndes të gjithëve, ATLANTIKU.

Besim Bytyqi
Goran, nuk je në nivel të duhur. Kjo rubrikë është hapur për të patur efekte të duhura për të dy popujt që kanë vuajtur shkaku i politikës së mbrapshtë: "Një budalla hodhi një gur në ujë, kurse 100 burra të mençur nuk e gjetën dot". Lus Zotin e Mëshirshëm që nuk jam unë ai që hodhi gurin, por as edhe nga ata që kërkonin ta gjenin atë gur. Unë dua që të jem një urë për të shërbyer ashtu që njerëzit e mirë të jetojnë mirë. Porse, deri sot nuk ishte ashtu. Të këqinjtë (Ti nuk je një nga ata, sepse ata janë vendosur prapa degëve dhe jetojnë në vila). Dhe jetojnë mirë. Njerëzit e mirë përpiqen të shpëtojnë ato që mund të shpëtohen. Qëndro larg fjalëve të këqija, sepse, ndonëse rrallë, fëmijët pyesin: ç'janë ato brigada të motorizuara: më vjen keq, por do t'i quaj brigada traktoriste). Ju flisni në emër të dy milionë njerëzve, goranë. Ç'do të ndodhte në Zoti na jep diçka në dorë? Unë shpresoj dhe besoj e jetoj me të gjithë ata që besojnë tek Zoti. Kurse, për ata që nuk besojnë, Zoti i mëshiroftë... Nëse je ortodoks, duhet të mendohesh pak. Përshëndetje.

Cimi
Dëgjo mirë, Goran. Nëse mendon se historia përsëritet, ajo tashmë është përsëritur në Kosovë. Është kthyer diçka që është grabitur para disa shekujve. Ndërsa, për kërcënimet tuaja, ti vetëm urdhëro. Të të them diçka: Ne nuk kishim armë gjatë 100 vjetëve të fundit, kurse ju keni bërë gjithçka që keni dashur. Kufijtë janë hapur gjithandej dhe për gjithçka, sidomos për... Pyet ti gjyshin tën se si janë Shqiptarët në luftë dhe kush mund të luftojë me ta, nëse ka armatim të barabartë me kundërshtarin. Harro kërcënimet pë këtë dhe atë, sepse secili jemi në vendin e vet, dhe ai që lufton për vendin e vet, ai nuk humbet kurrë asnjë luftë. Përshëndetje të gjithëve.

Tefiku
Unë vetëm dua t'i them Goranit, nga republika serbe se, u pa qartë se sa jeni trima ju, dhe ç'keni fituar. Gjithë bota është dëshmitare për sjelljet tuaja nëpër territoret e ish-Jugosllavisë. Si mund të vrisni gratë dhe fëmijët? Harroni mitet, ju lutem. Harroni dhe brigadat dhe flamujt e luftës.

Mister
O Goran i republikës së maleve. Njerëzit si ti janë ata që e kërkojnë në gojë! Urdhëro dhe eja tek ne, sepse do të të gostisim me mikpritje: me shtrëngatë deri te Banja Lluka, kurse ju nuk ishit askund me brigadë të motorizuar.

Shqipja
Ti Goran je si një qen që leh në zogori qensh dhe s'ka gjë prej teje, o i krisur, sepse ti as që di se ç'flet.

Fatoni
Deri tash komunikuam si njerëz dhe pa fyerje kombëtare, dhe kjo duke u falënderuar redaktorëve, apo moderatorëve. Nuk gjej ndonjë arsye që të mos tutje; madje shumica nga ne kemi plotë arsye për të shkruar ashtu siç na ka hije. Mirëpo, hetohen ngritje tensionesh në këto ditët e fundit. Por, do të thosha unë, të kemi mendjen e kthjelltë dhe të komunikojmë pa ofendime, sepse jemi në shekullin 21. Nuk ka më analfabetë. Të gjithë jemi intelektualë.

PRISHTINA
Goran - PAS PAVARËSISË SË KOSOVËS, NIS SHTHURJA E REPUBLIKËS KRIMANLE SERBE, ASHTU QË TI DHE BASHKËMENDIMTARËT TUAJ, SI NJË POPULL QIELLOR QË JENI, MUND TË ËNDËRRONI NË QIELL DHE TË PRITNI SE DO JU VIJË KOHA QË E DËSHIRONI, PËR TË BËRË ATO PISLLËQE QË KENI BËRË DIKUR! MË MIRË E KENI TË RUANI ATË PASHALLËKUN E BEOGRADIT, DERISA NUK JU PËRMBYTET NË DANUB A NË SAVË???

Vlada
- Unë jam një serb i origjinës serbe. Jam dhe një mut i madh i kombit tim.

Kurse im atë është një mut edhe më i madh, sepse ata janë shkaku i fatkeqësive tona. Fëmijët tanë aq më pak, sepse duke luftuar për të vërtetën, e kemi fëlliçur fare. U heq kapelën përjashtimeve, porse shumësia më e madhe e Boshnjakëve duhet të pyet veten, ose të pranojë faktin se muslimanët si komb nuk ekzistojnë askund; Muslimanizmi është besimi që e kanë përqafuar të parët tanë me dhunë. Gjë që nuk kam asgjë kundër, përkatësisht kam aq kundërshti sa edhe për besimet e tjera. Kurse, në kuptim të asaj që e shoh negative. Në këtë kuptim, edhe serbët, edhe boshnjakët e kroatët (shumësia më e madhe) kanë lidhje gjaku. Ndërsa pakica kombëtare shqiptare në Kosovë e Metohi, ata kanë vepruar me mend (për veten e tyre) - kanë luajtur finalen e lojës së pistë, natyrisht, me ndihmën e "miqve" që i kanë paguar shtrenjtë". Qysh para tridhjetë e sa vite, unë kam kaluar tre vcjet në Mitrovicën e Titos, dhe e di shumë mirë trysninë e atëhershme, madje edhe para kësaj periudhe. Kur të tjerët janë përgatitur për të gjithat që u duheshin, ne (përkatësisht, të parët tanë) i kanë besuar verbërisht Titos dhe Partisë. Kur të tjerët mblidhnin më të diturit dhe më të mirët, ne i kemi përndjekur dhe prangosur. Për fat të keq, ne ashtu po sillemi edhe tash. Rrëfimi është i gjatë dhe nuk ka fund. FATKEQËSISHT, NE SI POPULL DOLËM TË KISHIM QENË MARRASHË, DHE KJO GJË DHEMB.

Kosovski katolik

Ç'do të doja të thoshja për të gjitha këto! Ne, Shqiptarë të fiseve iliriane, të cilët - 1.000 vjet para erës sonë kemi jetuar në viset që nga Bistrica iliriane e deri tek Athina!!! Dhe, si njëri nga popujt parakë, i cili ka përqafuar krishtërimin qysh në shekujt e parë të epokës sonë, me çfarë edhe mund të krenohet!!!! Dhe: krenohet po ashtu që edhe serbët edhe kroatët e kanë pranuar kur u ka ardhur radha: këtë besim e kanë përqafuar nga shqiptarët!!!! Ndërsa ne, nuk kemi faj pse Otomanët na dogjën e na poqën derisa na turqizuan!!!! Nëse nuk e dini se pë çfarë po flas, kujtoni Skënderbeun - Gjergj Kastriotin, kampionin Princ të krishtërimit shqiptar, i cili ka luftuar me besimin e krishterë për çlirimin nga Perandoria Otomane dhe nga turqit islamë në Ballkan!!!!

Malësori

Zoti Toshiç, unë mendoj se ju duhet ta dini mirëfilli se në shekullin VI keni zbritur nga malet tuaja të largëta (për t'u quajtur më pas me emrin Sorbi, aktualisht serbët) të Karpateve dhe jeni takuar me fiset iliriane në Ballkan!!!!

Nëse keni lexuar sado pak, se fiset iliriane kanë jetuar që nga Bistrica e ilirëve e deri tek Athina!!!! Dhe, shumësia e fiseve iliriane ka filluar të shkrihet dhe të sllavizohet shumë-shumë më pas, duke u nisur nga Dalmacia (dalmatët), malazezët, hercegovinasit… dhe se emri Shqipëri ka dalë nga ishulli Rab në trojet e sotme të Kroacisë!!!! Dhe se ilirët (shqiptarë të sotëm) ju kanë dhënë juve (serbëve) besimin e krishterë!!!! Kurse në kohën aktuale, ju atë krishtërim e ruani në manastiret tuaja ortodokse serbe!!!! Unë mendoj se kjo është një çakërdi totale!!!! Kurse ju, sorbët, keni ardhur nga Karpatet në shekullin VI!!!! E, ne shqiptarët (më mirë të themi ilirianët) ju kanë falur qytetërimin dhe krishtërimin, si edhe popujve të tjerë të Ballkanit të sotëm!!!!
——————————————————————-

Tina
Juve, serbëve, ju ka mbetur vetëm se t'i thuani lamtumirë Kosovës përgjithmonë.
————————————————

F.Bruqi, moderator i Agjencisë Informative "Floart-Press" /Prishtinë
Flori Bruqi
10. maj 2007. ora 21:20

06
I nderuar zoti Bruqi,
Gjithë nderimin që ke qenë korrekt ndaj lexuesve www.novinar.de dhe që ke treguar të vërtetën për masakrën në Reçak.
Me nderime,
Gani Gashi
Tetovë, 17 maj 07

07
Zoti Bruqi ishte dhe mbeti një njeri i madh karshi popullit të vet, dhe shkencëtar i madh i niveleve botërore!!!
Ranko Krivokapiç, psikolog klinike
Toronto, 17 maj 2007
Ranko Krivokapiç, 17 maj 2007. ora 21:47

Burimi: http://www.novinar.de/2007/05/07/reagovanje-mrsci-flori-bruqi-naucnik-iz-pristine.html

Shqiptarët nuk kanë qenë jugosllavë, as më parë dhe as janë tash

Para disa ditësh, në shtetin Nju Xhersi të SHBA-ve, pushteti kishte vënë në pranga, siç i quajnë ata: terroristë, sepse kanë marrë aksion për të hedhur në erë një bazë ushtarake. Me shpejtësi u konstatua se katër anëtarët e grupit Arbanas nga Kosmeti. Sidoqoftë, në atë grup ka mundur të ishte dhe Agim Çeku personalisht, por edhe kushdo tjetër.

Çfarë lidhje ka kjo që ata kanë dashur të hedhin në erë një bazë ushtarake? Kjo më nuk ka lidhje me kurrfarë terrorizmi. Terrorizëm është vetëm kur një grup i armatosur sulmon dhe vret qytetarët civilë dhe rrënon objekte.

Sulmi mbi një bazë ushtarake, është - ose mbrojtja nga agresioni, apo shpallja e gjendjes së luftës. Përndryshe, sulmet mbi objekte ushtarake, juridikisht nuk definohen si terrorizëm. Depërtimi i aeroplanëve midis dy kullave në Menhetën definohet si terrorize, dhe ketë duhet kuptuar dhe pranuar. Mirëpo, nëse SHBA luftonm me boten Islame, sulmet mbi bazat e tyre ushtarake, kur rekrutohen terroristët për vrasje të popullit të pafajshëm në Irak dhe në Afganistan, pas mendimit tim nuk mund të emërohet me kurrfarë terrorizmi. Mirëpo, nëse dikujt i përgjigjet kjo, atëherë le ta quajë edhe terrorizëm.

Me siguri se unë nuk do të jam përfaqësues juridik i asnjërit anëtar të atij grupi, por edhe nëse do të isha rastësisht, strategjia ime do të ishte mbrojtja. Sepse sulmet mbi objekte ushtarake nuk mund të përkufizohen si terrorizëm.

Duke qenë se se, siç thashë, për tërë ketë punë, unë nuk kam kurrfarë kontributi, porse më lejoni që të komentoj një diçka krejtësisht tjetër. Pothuajse të gjitha mediat e Beogradit duke shkruar për ndohjen, ka përkufizuar se këta Arbanas që ishin në atë grup - ishin shtetas të Jugosllavisë? Kush janë ata jugosllavë që i ka ndërmend Beogradi? Jugosllavët në rend tëparë duhet të jenë slave, me prejardhje sllave. Jugo - Sllavia. Sllavia është sjteti slloven. Kjo ishte e imagjinuar si e tillë. Mirëpo, nëse shkencëtarët kroatë refuzojnë se janë kroatë që refuzojnë se janë me prejardhje jo-sllave, dhe kur vërtetojnë ashtu, pse do të më duhej t'i kundërshtoja.

Pastaj del se përfundimisht Jugosllavia paska qenë një fiksion. Kjo duket se doli e saktë. Andaj duhet bërë pyetjen: vallë, a ekzistojnë jugosllavët, ose sllavët e jugut. Jugosllavët nuk ekzistojnë. Sllavët e jugut nuk ekzistojnë, kurse në grupin e tyre, sipas disa etnologëve, aty janë vetëm bullgarët dhe serbët. Ka gjasë që në atë grupim mund të jenë edhe një pjesë e muslimanëve. Mirëpo,

tashti kjo është një çështje e vetë prijësve të tyre, që të ua përkufizojnë prejardhjen, ndonëse të gjithë e dinë se dy prijatarë të mëdhenj, në perandorinë otomane, kanë qenë serbë të islamizuar: Omer pasha Sokoloviç dhe Omer Pasha-Latash. Andaj, këtu nuk kemi të bëjmë me rreshtimin e arbanasve. Ata edhe sot e gjithë ditën kërkojnë prejardhjen e tyre. Dhe ne besojmë se ata do ta gjejnë një ditë.

E gjithë media amerikane ka transmetuar se ata katër arbanas janë arbanas nga Kosova. dhe, ç'ka gjë të keqe këtu në përgjithësi? Apo, vallë, askush në botë të mos ngre krye, përveç BE-ogradasve me turrin e medias: Përpara! (…) me shtypin. Të përvuajturit sllavë të jugut: tradhtarë dhe njerëz të paqëndrueshëm do të donin që në shenjë të njëfarë internacionalizmi të ri, pasi që në një "sloserimunizmi" dështuan si (…) brekë të shqyera. Dhe me këtë, pa ndonjë gjë që ata që nuk kanë kurrfarë lidhjeje me sllavët, aq më pak me nostalgjinë e përkatësisë jugosllave, gati sa nuk vendosën që këta katër arbanas nuk ishin askush tjetër veçse jugos. Ç'është tepër, është tepër.

Edhe vetë arbanasit, përveç kryetarit të tyre, të kryetarit të kuvendit të rrejshëm të Kosovës, sigurisht që u shquan si trima krenarë me djemtë e tyre guximtarë, të cilët vijnë ngga bazat amerikane. Për ta kuptuar më mirë këtë kompleks, përgjigjjen duhet kërkuar nga ish-presidenti Ajzenhauer i SHBA-ve. Ai, personalisht fliste për problemin e Amerikës në Amerikë, si një kompleks ushtarako-industrial. Ky kompleks është problem i gjithë njerëzisë aktuale. Dhe, është e besueshme se ata arbanas nga Nju Xhersi, disa njerëz briliantë, gjersa qenkan më të mirë nga vetë amerikanët, kuptuan se ç'i mungon Amerikës. Ndaj iu vunë mbështetjen për arbanasit dhe me një ndërmarrje kirurgjike anashkaluan që të skajojnë bile një rrënjë malinjiteti të shoqërisë amerikane. Nëse nuk është ashtu, atëherë unë nuk di se ç'është motivi i atyre arbanasve nga shteti i luleve në një aksion të jashtëzakonshëm, për çfarë do duhej të viheshin në pranga përjetë.

Janko Bojiç, Ontario - London

Në këtë botë gjërat nuk ndodhin rastësisht. Sidomos jo këto gjëra. Me një analizë të drejtë, nuk është e vështirë të vijsh tek konstatimi se pse po ndodhin këto gjëra pikërisht në sytë tanë. Dhe po ashtu, sot. Cinizmi dhe korrupsioni janë sëmundje nga të cilat lëngon shteti modern amerikan. Establishmenti i saj politik ka humbur çdo lidhje me realitetitn. Nga njëra anë, duke shfrytëzuar politikën e nazistëve gjermanë dhe neonazistëve, sikur mbështet faktorin islamik në Ballkan. Për këtë edicion janë thurë gënjeshtra e të pavërteta.

Nga ana tjetër, në Afganistan dhe në Irak, po ky establishment politik, masakron popullatën islamike. Bota islame sa vete e më shumë sillet rreth vetes dhe kundron se prej nga mund të vijnë ndihma për të shpëtuar nga shpërbërja. Në këtë rast duhet shikuar në thjerrëz.

Pse pas prangosjes së këtyre katër shqiptarëve, iu kushtua publicitet aq i madh përkatësisë së tyre kombëtare? Dhe, pse pra, nga ana tjetër, ai publicitet iu kushtua deklaratave të tyre të paatorizuara të faktorëve të paqenë nga Kosmeti? Përgjigjja është e thjeshtë. Lufta kundër tërë botës islamike që establishmentin neo-nazist të perëndimit, është luftë e pamundur. Regjimi i botës islamike, që nuk është pro-politikës së SHBA-ve, në katastrofën që quhet Irak, ata fituan mbështetjen edhe më të madhe. Me udhëheqjen cinike të Shqiptarëve të Kosovës, synohet që në këtë mënuyrë të frymëzohen për kushtrim kundër regjimit që është kundër establishmentit politik të Amerikës. Pa shihni tash, ata duan t'i thonë botës islamike, se ne nuk kemi kurrgjë kundër jush, porse kundër liderëve tuaj. Po. Mirëpo, kur Amerika të arrijë që të pushtojë botën dhe të dominojë mbi të, të gjithë muslimanët e Ballkanit, përfshirë aty edhe Shqiptarët, të gjithë do të marrin statusin e lodrave. Ky do të ishte njëri nga truqet më të pështira dhe politika më dinake e SHBA-së dhe Britanisë së Madhe.

Shumë mërgimtarë nga viset e ish-Jugosllavisë, e sidomos shumë shqiptarë, janë të vendosur dhe jetojnë në kushte shumë të rënda dhe të varfëra kuarteve të qyeteve të mëdha të SHBA-së. Ato kuarte janë shumë depresive dhe në to mbretëron varfëria dhe kriminalitetit, karshi çdo gjë që kanë lënë në Kosovë, para luftës së vitit 1999. Andaj, ata në numër shumë të madh, si emigrantë të rinj nga Kosova, kanë fituar përshtypjen e rreme të së vërtetës Amerikane. Nuk do të më befasonte që ajo situatë trysnie e depresioni, të kishte shkaktuar revoltën ndaj shumësisë së madhe të gënjeshtrave, me të cilat bota mbulohet me establishmentin politik amerikan.

Nuk përjashtohet as dhe mundësia që policia e vrazhdë dhe e pa edukuar amerikane, i ka maltretuar, ose i ka shpërdoruar mungesat e diturisë së tyre të njohjes së anglishtes. Shumë njerëz ankohen pë veprime të zhdrejta, madje edhe kur bëjnë shkarje, herë-herë edhe drastike; e sidomos ndaj personave që kanë emra islamikë, kur i ndalojnë edhe për kundërvajtje në trafik. Kur një njeri i maltretuar, me mentalitet eksploziv nga Mesdheu, është në gjendje të hakmerret në mënyra të ndryshme. Mjedisi ku jetojnë ata, nuk ka gjetur mirëkuptim tek ajo botë. Kjo gjë, gjithsesi ka mundur të kontribuojë për një sjellje të tillë të grupit shqiptar. Ç'shtë e drejta, këtu mund të flasim pë gjithçka.

Burimi:http://www.novinar.de/2007/05/12/albanci-nisu-jugosloveni-ni-bivsi-ni-sadasnji.html

10 komente për "Shqiptarët nuk janë as ish-jugosllavë dhe as sot"

01
Shqiptarët nuk janë jugosllavë as atëherë dhe as sot
Zotëri Bojiç,
Duke qenë se ke shkruar negativisht për gjeneralin tonë Çeku, të kthej përgjigjje në të gjitha gjuhët e botës se kush është Agim Çeku
……..

F.Bruqi
Koment i Redaksisë

I nderuar zoti Bruqi, Të gjitha komentet që nuk janë shkruar serbisht, nuk do të botohen. Me respektin e duhur që juve dhe të gjithë lexuesve t'u mundësojmë të shprehin mendimet apo përgjigjjet ndaj komentimeve, për fat të keq, nuk kemi resurse të përkthejmë nga anglishtja, sllovenishtja, shqipja dhe gjuhëve të tjera të botës. Ju faleminderit për mirëkuptim.
Srgjan Marjanoviç

02
Flori Bruqi: Lamërim lexuesve të blogut www.novinar.de.
Gjatë ditës së sotme na kanë arritur në redaksinë tonë (agjencinë Floart-Press) dy shkrime në gjuhën shqipe, nga dy autorë shqiptarë: Baki Ymeri nga Bukureshti (Rumani) dhe Ibrahim Kelmendi: Gjermani/Kosovë:
Duke patur parasysh se të dy shkrimet janë në original, lexuesve serbë dhe të tjerëve, me dëshirën e mirëkuptimit, i botoj në www.novinar.de, e në mungesë kohe, nuk do të jam në gjendje të ju ndihmoj për përkthimin.
F.Bruqi

……..

03
I nderuar zotëri Bojiç,
dua të ju falënderoj për analizën e hollësishme mbi përkufizimin e terrorizmit, të jugosllavëve dhe sllavëve të jugut. Njëmend mund të jemi mirënjohës për

që kemi një intelektual, i cili, në mënyrën më të thjeshtë dhe me pak fjalë shpjegon situatën aktuale në vend e në botë.
Nga artikulli i juaj, i nderuar zotëri Bojiç, del se shqiptarët e Kosovës nuk janë terroristë, porse luftëtarë të lirisë, drejtësisë, sovranitetit e demokracisë…
Vërtet bukur nga ju që këta njerëz nuk i rreshtoni në kategorinë e derroristëve, por, për mrekulli ju jipni një përkufizim krejtësisht të ri.
Duke gjykuar sipas artikullit tuaj, mund të thuhet se as edhe kazermat e UJ dhe vrasjet e ushtarëve të rinj në vitet 1991 dhe 1992, nuk kanë qenë terrorizëm por një lloj lufte nacional-çlirimtare e sllovenëve, kroatëve dhe muslimanëve. Nga kjo del se, po ashtu as në Sanxhak dhe as në Kosovë nuk ka terrorizëm, veçse atje, gjithandej… çka?
Sipas fjalëve tuaja, dmth. se slave të jugut qenkan serbët dhe bullgarët. E mjera nëna jonë nëse paskemi rënë në shkallë aq të ulët për t'u vëllazëruar me bullgarë. Vërtet e ulët.
Nëse vazhdoni kshtu të analizoni rrënjët tona, nga sllavët e jugut nuk do të mbetej gjë, përveç Nishit dhe Malla Kërsnës.
Sipas jush, as jugosllavët nuk paskan ekzistuar, porse paskan qenë vetem një fiksion. E po, mirë. Sipas këtij mendimi, edhe gjermanët, edhe amerikanët e francezët, dhe serbët e grekët e rusët... asgjë tjetër, veçse fiksion.
Dmth, e gjithë bota na qenka vetëm se fiksion, kurse i vetmi realitet na qenkan "ata nga Marsi".
Edhe njëherë ju faleminderit për analizën profesionale, sepse më keni hapur sytë me artikullin tuaj, nga i cili kuptova se dua të jem përkatës i një populli të vërtetë: Dua të jam një njeri nga Marsi…
Miodrag,
12 maj 2007 ora 12:10

04
z.Miodrag,
unë nuk i kam hartuar as Konventat as Ligjet. Terrorizmi në shkencën e drejtësisë nuk përkufizohet me sulme ndaj objekteve ushtarake. Qasja ime ndaj kësaj teme nuk është për të lavdëruar snjë njeri; kurse ju, duke qenë se nuk ju pëlqen, si edhe Shqiptarëve që nuk u pëlqen pse unë kritikoj Çekun, sepse unë isha bashkë me dy ushtarë kanadezë, të cilët rastesisht tek miku im Beri Fika, avokat, i cili kërkonte këshillë sesi të ngrente padinë kundër Çekut, dhe i cili ka kryer krime lufte në Medak, dhe ka plagosur ushtarët kanadezë.
Shqiptarët nuk mund të jenë jugosllavë, sepse nuk janë me prejardhje sllave. Kroatët e kundërshtojnë atë prejardhje; edhe vetë Tugjmani ka dërguar disa

shkencëtarë në Iran, për të dëshmuar se kroatët kanë origjinë iraniane. Vërtet, vetem bullgarët dhe serbët nuk mohojnë këtë prejardhje. Fundja, çfarë ju pengon juve kjo gjë? Rrethimi i kazermave nëpër ish-Jugosllavinë ka qenë akt i agresionit dhe shpallje e luftës ndaj një vendi sovran, dhe jo një akt terrori. Akti i agresionit, përkatësisht sfidimi i luftës ku mbretërojnë normat e qytetërimeve, është njësoj i dënueshëm edhe si terrorizëm. Madje edhe më ashpër. Akti i agresionit definohet si krim lufte. Andaj, nuk e kuptoj problemin tuaj. Megjithatë, keni parë dhe keni dëgjuar dhe jeni dëshmitarë të botës aktuale, ku ushtrohen idetë e Adolf Hitlerit, dhe për fatin e keq, disa njerëz në botë, kazamatin e Hagës e quajnë Tribunal ku gjykohen krime fiktive dhe të shpifura, dhe jo agresioni. Pse? Ekspertët seriozë të drejtësisë këtë gjë e dinë mirë. Sepse në atë rast NATO, gjegjësisht Qeveria aktuale e SHBA-ve do duhej të gjendej e para në bankën e të akuzuarve. Vetëm të jua kujtoj se për të parën herë, përkufizimi i krimeve të luftës është definuar në Konventën e Hagës që më 1905. Kurse krimet e luftës, që sipas asaj Konvente, ka qenë dashur të gjykoheshin ato elementet austro-hungareze, të cilat, qysh në luftën e parë botërore, kanë bërë masakra mbi popullatën e pafajshme në Maçvë. Për fat të keq, të tillët nuk janë gjykuar - dhe kjo e tëra shkaku i asaj Jugosllavie, për të cilën ju keni mall.

Dhe tani, kur tre-katër arbanas u bashkuan për të sulmuar një bazë ushtarake amerikane për të marrë hakun ashtu siç janë stërvitur me kazermat e ish-Jugosllavisë, dhe ky nuk qenka terrorizëm. Shih-shih tash. Prapa aktit terrorist kërkojnë të fshehin aktin e agresionit. Mirëpo, a është vërtet ky një akt agresioni, pasiqë ata janë në luftë me botën islamike. Mua nuk më intereson përkufizimi gjithaq, porse motivi i atyre njerëzve që sulen kundër forcave të armatosura të SHBA-ve. Por, motivi i përgjithshëm i kësaj ngjarjeje.

Nuk kam gjë kundër asaj që ju të jeni nga Marsi. Porse, këtu ka një problem. Si do të shkoni në Mars? Dhe e dyta, nuk e kam të ditur nëse atje ka ujë dhe ajër. Ka gjasë që ju të jeni një individ i jashtëzakonshëm dhe se mund të jetoni pa këto dy elemente. Dhe besoj, se po të ishte e mundshme të ngjiteni në Mars, unë do të ju kisha mbështetur i pari, sepse njëmend duhet ikur nga ky kaos ku jemi.

Për zotin Bruqi: emrat e të gjithë ushtarëve të Kanadasë, që ishin forca paqeruajtëse dhe të cilat, "gjenerali" i juaj Çeku, bashkë me disa egërsira, i ka plagosur dhe ka bërë një krim të pështirë në Medaku, mund të informoheni nga libri i Skot Tejlorit, "Turnished Brass". Nëse ju intereson i ISBN, unë mund të jua kaloj dhe ju të porositni librin.

Janko

P.S.
Nëse përmes barcoletave mund të gjendet një rreze që shëmbëllejë një shoqëri, jua kaloj një barcoletë, e cila, po qe se kuptohet drejt, spikat të vërtetën e madhe të një shoqërie.
Një njeri hyn në Bar dhe pyet banakierin: "Mbase nuk është e vërtetë se Bushi dhe Pauelli janë uluar aty?"
Banakieri i përgjigjet: "Po, ata të dy janë aty." Njeriu drejtohet tek ata dhe u thotë: "Auh, ç'nder i veçantë. Ç'bëni ju të dy këtu?"
Bushi ia kthen, "Po planifikojmë Luftën e Tretë Botërore."
Njeriu u tha, "E keni me gjithë mend? Ç'do të ndodh pastaj?"
"Do të ndodh mrekullia. Do vrasim 140 milionë irakianë dhe një biondine me sisa të mëdha, hë-për-hë."
Njeriu u habit, "Bjondinë me siska të mëdha? Pse do ta vrisnit atë?"
Bushi i drejtohet Pauellit duke i rrahur supin: 'E sheh ti? A nuk të thashë se askush nuk do të bezdiset nëse vrasim 140 milionë irakianë?"
Janko Bojiç,
12. maj 2007, ora 13:21

05
E nderuar Redaksi,
Duke qenë se nuk kam shumë kohë, ju përshëndesim juve dhe lexuesit, me shpresën se shqiptarët dhe serbë do të përafrohen kur të mos ketë më protektorat dhe Rezolutë 1244 KS, dmth. UNMIKU, veçse vetem si shtet sovran, Republikë e Kosovës.
Shqiptarët dhe serbët do të kenë të gjitha të drejtat në republikën e Re të Kosovës.
Që më pare ju falënderojmë që na e dhatë hapësirë tuaj.

Mr. Sci. Flori Bruqi
(moderator i www.bruqi.com)
Flori Bruqi
12. maj 2007. ora 15:26

06
I nderuar zoti Bruqi. Si e mendoni se do të afrohen shqiptarët me serbët, kur ju synoni të na e merrni territorin që për 1000 vjet ishte i yni?? Cili njeri normal mund të bëhet mik në këto rrethana. E dyta, ju jeni një popull që financat kryesore i siguroni nëpërmjet drogës në Europë e në botë; nëpërmjet armëve,

prostitucionit etj. Ne nuk duam që ju t'i bëheni fqinj askujt në botë. Rreth Kosovës duhet vendosur fushat me mina dhe tela me gjemba dhe nëpër ata tela duhet vënë rrymën!
Zoran,
12 maj 2007, ora 17:38

07
Flori Bruqi, shkencëtar dhe shkrimtar i njohur u ka treguar mirë serbëve të republikës serbe të Bosnjës. ,,Ne mund të bëhemi fqinj, sepse Kosova do jetë shtet i pavarur qysh nga shkurti i vitit 2008" Kurse shqiptarët janë pasardhës të ilirëve të lashtë!!! Ndërsa ju serbët keni ardhur në trojet e Iliridës, nga Karpatet, në shekullin e shtatë të erës së re!!!
Kjo do të thotë se ju jeni ardharakë, ndërsa ne jemi popull autokton në vendin tonë, kur ju as keni ditur se ekziston Ballkani.
New York, USA
Sabit Rrustemi,
13 maj 2007. ora 22:45

08
Plagjiatura e këngëtarëve në Eurovizion
Lajmi më i ri në botë ishte vjedhja e këngës dhe këngëtares shqiptare, Soni, me të cilën Serbia fitoi vendin e parë në festival.
Klikoni sajtin dhe do të bindeni:
http://www.youtube.com/watch?v=mn0wAvFh9GQ
http://www.genëi.com/play/1279783
http://www.searchmyvideo.com/ëatch/2034773517/serbias-eurovision-song-stolen/
http://www.thesun.co.uk/article/0,,4-2007220083,00.html
Hajdar Fejzullahu/
Prishtinë, 14 maj 2007, ora 11:25

09
Zotëri Rrustemi: E pse shqiptarët kanë bërë çrregullime në Maqedoni? Pse kanë luftuar para 2 vjetëve me armë? Ndoshta edhe atje keni ardhur në shekullin e shtatë? Edhe një gjë, në cilin libër mund të lexojmë këto që flisni ju? Natyrisht, me kushtin që atë libër të mos e ketë shkruar ndonjë shqiptar!!??
Pittsburg, Pennsylvania
Pittsburgh
14 maj 2007, ora 11:43

10

I nderuari z.."Pittsburgh",

Shqiptarët nuk kanë prishur rendin në FYROM, porse FYROM-i ka përdorur forcën e armatosur dhe ka ushtruar dhunë mbi ta!!

Shqiptarët kanë mbrojtur pragjet e shtëpive të veta. Dmth: Iliridën!!! Si mendoni ju, a do të ekzistojë Maqedonia? Unë them se jo!

Sepse bullgarët, serbët, grekët dhe shqiptarët do të marrin trojet e veta që ua kishte marrë komunizmi - J.B.T.

Ka të drejtë zoti Bruqi, kur thotë, "më mirë të jemi fqinj sesa armiq".

Apo jo, zotërinj të Serbisë!!! Kosova do jetë një shtet i pavarur dhe sovran brenda këtij muaji!!!

Askush nuk do të pyet KS të OKB-së, as Rusia as Kina, sepse Kosova është qendra e Ballkanit dhe e SHBA-ve!!!

Shqiptarët i duan Amerikën, dhe amerikanët i duan shqiptarët!!! Këtë gjë ju e dini mirë!!!

Kurrë nuk do të kishte ndodhur bombardimi mbi Serbinë pa Klintonin, Ollbrajt, Blair…

Mr.sci.Hamit Haliti,prof.

Toronto,14.5.2007.

Burimi: http://www.novinar.de/2007/05/12/albanci-nisu-jugosloveni-ni-bivsi-ni-sadasnji.html

Kosova - është Uashington i shqiptarëve

Shkruar nga shkrimtari dhe Mr. Sci. Flori Bruqi, Prishtinë - Kosovë

Ndonëse e paralajmëruar si vizitë private për të kryer rite fetare, gospodin Pavle dhe kryeçetniku serb, prof. dr. Vojisllav Koshtunica, gjatë qëndrimit të tij në Graçanicë, nuk e ka lënë pa e shfrytëzuar këtë rast për të përcjellë mesazhe politike për qytetarët serbë të Kosovës. "Kosova gjithmonë ka qenë dhe gjithmonë do të jetë pjesë e Serbisë" thoshin zyrtarët e Beogradit.

Ndonëse qytetarët serbë e kanë pritur që nga orët e paraditës, kur është mbajtur liturgjia në manistirin e Graçanicës, e më pas edhe në Gazimestan, kryeçetniku serb, profesor doktor Vojisllav Koshtunica, ka ardhur në Graçan-

icë pasi janë kryer të gjitha ritet fetare në ditën e Vidovdanit serb.

I nxitur nga kryepeshkopi, gospodin Pavle, i cili e ftoi kryeçetnikun, pra Koshtunicën që t'u trimëronte jë dhe t'u përforconte shpresën serbëve të Kosovës se edhe në të ardhmen "Kosova dhe Metohija"do të mbetet "Jerusalemi serb.

Kryeçetniku serb nuk u kursye që të mbajë një fjalim të zjarrtë politiko-patriotik. "Nuk ka vend më të mirë dhe më të rëndësishëm për ta ripërsëritur atë që çdo serb duhet ta dijë: "Kosova dhe Metohia "gjithmonë ka qenë dhe gjithmonë do të jetë pjesë e Serbisë".

Më pas, çetniku ka thënë se ky është një rast për t'i treguar botës se "Serbia dëshiron drejtësi dhe paqe".

Ajo, sipas tij, dëshiron të bisedojë dhe të arrijë marrëveshje dhe kompromis, tha çetniku kontradiktor, duke theksuar se megjithatë Serbia dëshiron zgjidhje bazuar në "të drejtën historike për Kosovën dhe Metohinë".

Koshtunica i ka siguruar serbët e mbledhur në Graçanicë se askush deri më tash nuk ka pasur pozitë më të fortë se sa që ka Serbia nga aspekti i së të drejtës në diskutimet për të ardhmen e Kosovës.

Por zotërinjtë e Beogradit harrojnë se Kosova është e shqiptarëve dhe atyre që dëshirojnë të jetojnë në të!

Aktivistët e l ëvizjes së Albin Kurtit "Vetëvendosje" në dy raste të ndara, në Mitrovicë dhe në Merdar janë arrestuar 115 aktivistë dhe qytetarë, të cilët po përpiqeshin që të bllokojnë rrugët, për të pamundësuar ardhjen e çetnikut serb, Vojislav Koshtunica në Kosovë.

Njësitet speciale të Policisë së UNMIK-ut dhe të SHPK, si në kohën e Sllobodan Millosheviqit intervenuan dhunshëm kundër dhjetëra aktivistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE, të cilët ishin mbledhur në qytetin e Mitrovicës dhe Merdare (kufiri shqiptaro-serb) për ta bllokuar ardhjen e delegacionit të së ashtuquajturës Qendra Koordinuese Serbe për Kosovën, të udhëhequr prej "partisë më bateri "Sandra Rashkoviq-Iviq, e cila ia lëpinte mjekrrën gospodarit Pavle si dhe kryeçetnikut Vojisllav Koshtunica.

***

Ndër të arrestuarit, është edhe ish ushtaraku i UÇK-së, tash kryetari i Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, zoti Emrush Xhemajli.
Merre si ta marrësh, "Vidovdani" i çetnikëve serbë do të jetë i fundit në Kosovën 1244.

Ndërsa bisedimet mbi statusin përfundimtar të Kosovës vazhdojnë prej disa muajsh me radhë; kanë filluar të ngrihen pikëpyetje lidhur me qytetin e ndarë të Mitrovicës.
Tensionet rreth çështjes së Mitrovicës do të jetë një nga provat më të vështira në ruajtjen e territorit të Kosovës dhe shoqërisë së saj shumë etnike.
Në Institutin Amerikan të Paqes mbi të ardhmen e Mitrovicës, u fol edhe për atë se a do të ruajë Kosova kufijtë e tanishëm, apo do të ndahet; a është komuniteti ndërkombëtar i gatshëm ta bashkojë qytetin e Mitrovicës dhe si mund të arrihet kjo më së miri.
Administratori i OKB-së në Mitrovicë, Gerard Gallucci, kohë më parë parashikon probleme gjatë korrikut dhe gushtit të këti viti, ndërkohë që Kosova shkon drejt pavarësisë së mundshme.
Zoti Galluci tha se forcat e OKB-së dhe të NATO-s do të mbrojnë popullatën në rast se krijohen probleme. Po që prej emërimit në detyrë para rreth një viti, zotin Galluci e shqetëson gjendja ekonomike, jo vetëm në Mitrovicë, por në mbarë Kosovën.
"Problemet ekonomike ekzistojnë në gjithë Kosovën, dhe jo vetëm në Mitrovicë. Nevoja për investime në infrastrukturë në Kosovë është shumë e madhe, si në sektorin e energjisë elektrike, të furnizimit me ujë e të tjera.
Është e drejtë të thuhet se komuniteti ndërkombëtar ka humbur 7 vjet në këtë drejtim, veçanërisht në veri, ku komuniteti ndërkombëtar dhe vendet e Grupit të Kontaktit nuk i kanë kushtuar asnjë vëmendje."
Administratori i OKB-së në Mitrovicë tha se misioni i tij do të ruajë komandën dhe kontrollin në terren dhe të mbajë të hapura linjat e dialogut për të mos lejuar shpërthimin e situatës.

Hans Binendijk, drejtor i qendrës për teknologjinë dhe politikën e sigurimit kombëtar, parashtroi kohë më parë 3 alternativa: ndarja e Kosovës, eliminimi i strukturave paralele dhe integrimi etnik.
Megjithëse ndarja e Kosovës është një alternativë jo-realiste, për arsye të

qëndrimit të grupit të kontaktit, ajo përbën shpresat e popullatës serbe të Kosovës.
Zoti Binendijk mendon se pa eliminimin e strukturave paralele, serbët e Kosovës do të vazhdojnë të shikojnë nga Beogradi, e jo Prishtina, për ndihmë, duke krijuar kështu një shtet de fakto të ndarë.
"Nga këto 3 alternativa që kemi studiuar, integrimi etnik është e vetmja zgjidhje e pranueshme për SHBA-të dhe aleatët e tyre. Kjo alternativë është edhe më e vështirë për t'u zbatuar sepse do të kërkojë vëmendje dhe burime afatgjata të komunitetit ndërkombëtar."
Gerald Knaus, drejtor i Nismës së Stabilitetit Evropian, thotë se alternativa më e mirë është që Mitrovica të bëhet komunë.
"Kosova është një zonë shumë e paqëndrueshme si në aspektin ekonomik ashtu dhe në atë shoqëror. Nëse flasim për decentralizimin, ajo që ka rëndësi për serbët është Mitrovica veriore. Ajo është e vetmja zonë e tyre urbane në të gjithë Kosovën, aty ata kanë institucione, kanë universitetin dhe spitalin. Shqiptarët e Kosovës duhet të pranojnë se krijimi i një komune me shumicë serbe në Mitrovicë, është rruga më e mirë për të shmangur dhunën dhe për të gjetur një zgjidhje paqësore dhe shumë-etnike në Kosovë."
Tensionet etnike në Kosovë vazhdojnë të jenë të larta. Ndërsa analistët shprehin mendime të ndryshme për sa i përket mënyrës më të mirë drejt zgjidhjes së statusit; bisedimet mbi të ardhmen e Kosovës nuk kanë arritur të ngushtojnë mosmarrëveshjet mes dy palëve.
Se gjendja është tepër e tendosur shihet edhe nga "ruajtja" 24 orëshe e policëve të SHPK-së që po i bëjnë shtëpisë në "Velania" 2 në Prishtinë, ku banon komesari i policisë së UNMIK-ut, Virtupi.
Gjendja do të përkeqësohet edhe më shumë nëse ndahet Mitrovica, atëherë gjithsesi do të ketë trazira, ose një luftë e dytë çlirimtare kundër forcave ekstremiste serbe dhe ndihmaçarëve të tyre.
Besojmë dhe shpresojmë që stafi politikë i tashëm i Kosovës do të jetë një, ashtu siç është mishi me thoin për një Kosovë të lirë të integruar në pro KOMENT I FUNDJAVËS

Kosova – është Uashington i shqiptarëve.
Çetnikët vazhdojnë me mesazhet e vjetra politike

Ndonëse e paralajmëruar si vizitë private për të kryer rite fetare, gospodin Pavle,dhe kryeçetniku serb, prof.dr.Vojisllav Koshtunica, gjatë qëndrimit të tij në Graçanicë, nuk e ka lënë pa e shfrytëzuar këtë rast për të përcjellë mesa-

zhe politike për qytetarët serbë të Kosovës. "Kosova gjithmonë ka qenë dhe gjithmonë do të jetë pjesë e Serbisë" thoshin zyrtarët e Beogradit.

Ndonëse qytetarët serbë e kanë pritur që nga orët e paraditës, kur është mbajtur liturgjia në manistirin e Graçanicës, e më pas edhe në Gazimestan, kryeçetniku serb profesor doktor Vojisllav Koshtunica, ka ardhur në Graçanicë pasi janë kryer të gjitha ritet fetare në ditën e Vidovdanit serb.

I nxitur nga kryepeshkopi, gospodin Pavle, i cili e ftoi kryeçetnikun ,pra Koshtunicën që t'ia trimërojë dhe t'u përforcojë shpresën serbëve të Kosovës se edhe në të ardhmen "Kosova dhe Metohija"do të mbetet "Jerusalemi serb."

Kryeçetniku serb nuk u kursye që të mbajë një fjalim të zjarrtë politiko-patriotik. "Nuk ka vend më të mirë dhe më të rëndësishëm për ta ripërsëritur atë që çdo serb duhet ta dijë:" Kosova dhe Metohija "gjithmonë ka qenë dhe gjithmonë do të jetë pjesë e Serbisë".

Më pas çetniku ka thënë se ky është një rast për t'i treguar botës se "Serbia dëshiron drejtësi dhe paqe".

Ajo, sipas tij dëshiron të bisedojë dhe të arrijë marrëveshje dhe kompromis, tha çetniku kontradiktor, duke theksuar se megjithatë Serbia dëshiron zgjidhje bazuar në "të drejtën historike për Kosovën dhe Metohinë".
Koshtunica i ka siguruar serbët e mbledhur në Graçanicë se askush deri më tash nuk ka pasur pozitë më të fortë se sa ka Serbia nga aspekti i së të drejtës në diskutimet për të ardhmen e Kosovës.

Por zotërinjtë e Beogradit harrojnë se Kosova është e shqiptarëve dhe e atyre që dëshirojnë të jetojnë aty!

Aktivistët e l ëvizjes së Albin Kurtit "Vetëvendosje" në dy raste të ndara, në Mitrovicë dhe në Merdar janë arrestuar 115 aktivistë dhe qytetarë, të cilët po përpiqeshin që të bllokojnë rrugët, për të pamundësuar ardhjen e çetnikut serb, Vojislav Kostunica në Kosovë.

Njësitet speciale të SHPK (sot në 10 :15) si në kohën e Sllobodan Millosheviqit, intervenuan dhunshëm kundër dhjetëra aktivistëve të Lëvizjes VETËVENDOSJE, të cilët ishin mbledhur në qytetin e Mitrovicës për ta bllokuar ardhjen

e delegacionit të të ashtuquajturës Qendra Koordinuese Serbe për Kosovën, të udhëhequr prej njëfarë "patrioteje me bateria "Sandra Rashkoviq-Iviq, e cila ia lëpinte mjekrën gospodarit Pavle.

Ndër të arrestuarit është edhe ish ushtaraku i UÇK-së, tash kryetari i Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, zoti Emrush Xhemajli.
Merre si ta marresh "Vidovdani" i çetnikëve serbë do të jetë i fundit në Kosovën 1244.

Burimi:http://gjuhashqipe.blogspot.com/2006/06/kosova-sht-ëashington-i-shqiptarëve.html

Shtypi serb kërkon burgosjen e liderëve politikë të FBKSH-së që përkrahin pavarësinë e Kosovës

Kryeartikulli, i botuar kohë më parë në gazetën "Kurir", i titulluar thjesht "Burgu", thekson se, sipas kushtetutës serbe, secili person që bën thirrje për shpërbërjen e Serbisë, mund të dënohet me 15 vjet burg. Kjo gazetë i ka bërë thirrje Zyrës së Prokurorisë që të nisë një procedurë të hapur kundër organizatës serbe "Rrjeti i grave në të zeza", që është një nga dy partnerët e këtij koalicioni.

Në një deklaratë të lëshuar këto ditë, Koalicioni e ka akuzuar këtë gazetë për frikësim, duke shtuar se gazetari i "Kuririt", duket sikur të ketë vepruar "sipas instruksioneve nga ato qendra të fuqive, që e dëshirojnë destabilizimin e mëtutjeshëm të Ballkanit dhe tjetërsimin e mëtutjeshëm të Serbisë (nga Evropa)".

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) dhe Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia, e kanë themeluar Koalicionin e Grave për Paqe, në mars të vitit 2006, për të monitoruar negociatat shqiptaro-serbe për statusin e ardhshëm të Kosovës - nga perspektiva e grave - dhe për të refuzuar "ndarjet etnike dhe

religjioze sikur edhe kufijtë shtetëror dhe barrierat".

Ky koalicion është aktiv në të dy anët e konfrontuara, që kur përfaqësuesi i posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari, ka propozuar një pavarësi të kufizuar për Kosovën, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme ndërkombëtare.

Në një deklaratë të këtyre ditëve, Rrjeti i grave në të zeza ka insistuar se e ardhmja politike e Serbisë dhe Kosovës duhet të bazohet në të drejtat njerëzore dhe jo në nacionalizëm, madje edhe nëse kjo shpie drejt pavarësisë së Kosovës.

Këtë deklaratë ky koalicion e ka fuqizuar me një letër të hapur gjatë javës së kaluar, nëpërmjet se cilës, ka kërkuar që gratë kosovare të përfshihen në bisedimet rreth statusit të ardhshëm të Kosovës dhe në hartimin e kushtetutës së re të Kosovës.

Që të dy partnerët e koalicionit e kanë të qartë se pozicioni i tyre nuk mirëpritet nga segmentet politike e të dy anëve të frontit. Opinioni publik në Kosovë mbështet fuqishëm pavarësinë e plotë të Kosovës, ndërsa më 10 shkurt, dy shqiptarë janë vrarë nga plumbat e gomës të shkrepur nga policia e UNMIK-ut, gjatë një proteste kundër planit të Ahtisaarit.

Nga ana tjetër, në Serbi, artikulli i gazetës "Kurir", jep indikacione se nacionalistët serbë do ta shfrytëzojnë shtypin e djathtë për ta persekutuar secilin që flet në favor të modernizimit politik dhe të drejtat në vend të ekstremizmit.

Gazetari ushtarako-politë i Beogradit, i cili ishte pjesëmarrës në të gjitha luftat e Armatës Jugosllave Milovan Drecun (4.10.1957 në gazetat "Glas Javnostu" , "Veçernji novosti" etj., ,të Beogradit ,sulmojë këto ditë djemtë më të mirë -lideret politiko-ushtarak të FBKSH-së (Mr.Gafurr Adilin,Astrit Gashin,Dalip Dalipin,Ilir Berishën,
Agim Sylejmanin ,Florentin Dibrën,Petrit Nimanin,Mehmet Ismajlin,Mark Antonin ,Behar Zajmin ,Tom Markun ,Fehmi Llukën,Abaz Sylejmanin, e disa të tjerë ..."se gjoja këta janë ushtarë të Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH) dhe se ata janë liderët kryesorë që luftojnë më të madhe për Ribashkimin e Tokave Shqiptare (sipas spiunit ushtarak serb Milovan Drecunit për "Shqipërisë së Madhe").

Milovan Drecuni është një ish gazetar i " RTS "(Radio Televizija Serbije),ndërsa tash komentator politiko-ushtarakë i BIA-së serbe) i cili prej viteve të '90-ta e ishte dorë e djathtë e një rexhimit satrap i arqipeshkvisë serbe,politikës gjenocidale të Akademisë Serbe ,akademikëve për "Serbinë e Madhe" .Ai është një informator ekstrem i akademikëve më zë : Dobrica Qosiqit, Luba Tadiçit,Antonije Isakoviçit,Sllobodan Millosheviçit…

Drecuni i Zi -"Crni Drecun", ishte krah i djathtë i shërbimëve informative të disa shteteve të locuara në qeverisjën ndërkombëtare në Kosovë (lexoni Unmik !!!)

Fatkeqësisht Milovan Drecuni,Dragan Damjanoviqi,Marko Llopushina e disa iqa dhe viqa tjerë që i thonë vedit "analistë serb "(lexoni spijuj) më disa shqipfolës(spijujë në UNMIK) ,po i gjurmojnë më të madhe shkrimet e gazetarëve shqiptarë në internet.

Shkrimet dihet së janë publike dhe janë të botuara në forume virtuale Art-Café,Floart-Press,www.dervina.com,www. Al Today .com,www.hasanprishtina.com ,
www.frosina.org,Alb-Shkenca.org etj) të cilët ju servohen për analiza shkencoro-informative havive të UNMIK-ut , shërbimeve sekrete ushtarake serbe të BIA-së,ambasadës ruse në Beograd dhe liderucave në Graçanicë,Mitrovicë Veriore,Beograd e Moskë ....

Drecuni më shokë "ushtarakë" i kërkoj kokat e liderëve të FBKSH-së (bile edhe disa i vranë dhe i burgosur këto ditë)!...

Djemtë tanë (të Shqipërisë Etnike) nuk i kërkojnë tapitë e Serbisë, por po i kërkojnë tapitë e tokave të veta -tapitë e Arbërisë, të marra me dhunë nga Evropa plakë !

Ju preferojmë SOROS-istëve ,shqipfolësve që punojnë në OJQ-të, gazetarëve të BIRN-it për Ballkan dhe spijujve tjerë të vegjël dhe të mëdhenjë (që finansohën nga Soros-i, e BIA e Serbisë ...nga dreqi dhe i biri) të vetëdijësohen një herë e përgjithmonë në të mirën e atdheut ,që të punojnë për të mirën bijve dhe bijave të tyre ,sa nuk është bërë vonë!!!

Flori BRUQI
Burimi: http://vudi.multiply.com/journal/item/23

Të gjithë miqtë e shqiptarëve të Kosovës

Janko Bojiç

Përgjigjje "shkencëtarit" Flori: "qytetërimi i lartë" është patronati i shqiptarëve në Kosovë. Ai "qytetërim i lartë", për të cilin Llojd Xhorxh, kryeministri i Britanisë në Luftën e Parë Botërore, në fjalimin e shquar më 4 shtator 1914, ka thënë: "Zoti ka krijuar njeriun në shëmbëllim të vetes së vet, me synimin që njeriu të begatohet shpirtërisht".

Qytetërimi gjerman do donte ta "ngjallte përsëri" në shëmbëllim të makinës Diesel – precize, e saktë dhe e fortë, porse pa hapësirën për shpirtin, i cili do vepronte brenda vetes". Në fjalën e tij, ky shtetar dhe dijetar dhe skolar, i cili gjithnjë ka përgatitur dhe shkruar fjalimet e veta, dhe si miku i shqiptarëve, Bill Klinon, i cili, besojmë, si edhe për shumësinë e ekstremistëve shqiptarë, nuk di të shkruajë, porse ia shkruajnë të tjerët, se qytetërimi gjerman, është një qytetërim barbar.

Ata të sëmurë malinjë, Hunët, siç i quante Çërçilli Gjermanët në luftën e dutë botërore, ata janë sponsorët e shqiptarëve, në përpjekje që në mënyra barbare të kthejnë historinë mbrapsht. Vallë, a do ia dalin mbanë?

Unë nuk cënoj dhe nënçmoj asnjë popull të botës. Njerëzit i vlerësoj jo sipas përkatësisë kombëtare dhe religjioze, porse sipas karakterit dhe nderit.

Para se të vazhdoj, vetëm dua të jua kujtoj atë pastrimin e trurit: duhet patur parasysh dhe këtë: Secili tru mund të pastrohet në mënyra të ndryshme dhe nga njerëz të ndryshëm. Ç'është e vërteta, shqiptarëve ua kanë pastruar trurin fashistët dhe nazistët, kurse neve, serbëve - Llojd Xhorxh dhe Uionston Çërçill, që sot janë tradhtuar nga neo-nazistët dhe nazistët e SHBA dhe Britanisë së Madhe, dhe që quhen Bil Klinton dhe Toni Bler, Medlinë Ollbrajt, Uezlli Klark dhe të tjerë skizo-politikanë të kësaj kohe dhe hapësire.

Hëpërhë, shqiptarëve po u shkon për dore dominimi i Gjermanisë në unionin europian. Uinston Çërçilli, në fund të Luftës së Dytë Botërore, në një kuvend ka thënë: "Tashti po shkoj në gjumë, dhe më zgjoni nga gjumi kur ata "Hunë malinjë" të bashkohen përsëri. E, sa për gjykimin e Shqiptarëve, nuk duhet t'u shihet për të madhe që janë miq të këqinj në shtëpi të huaj, porse e kaluara tyre është për gjykim të rreptë. Siç duket, pjesëmarrja dhe bashkëpunimi ma maniakun Hitler, duket sikur është shpaguar. Mirëpo, e gjithë kjo nuk është fundi i kësaj historie. Aktualisht janë ngritur "Hunët malinjë" dhe janë egërsuar. Kështu që, në Luftën e Dytë Botërore, gjermanët i ka përshkruar dhe i ka quajturt Uinston Çërçill si më të aftët dhe më të talentuarit liderë të perëndimit, ka thënë Çërçilli , miku i madh i serbëve.

Për kë e pata fjalën, se ne serbët jemi të indoktrinuar me ide maniakale, sepse po ai Çërçill, tha për mikun e madh të shqiptarëve, Adolf Hitlerin: "Të bësh negociata me Hitlerin, është një gjë e pamundshme! Ai është një maniak!" Pikërisht për t'i njohur fare, ato ide dhe shkolla që kanë drejtuar tetarët austriakë, Adolf Hitleri dhe Jozef Shloseri.
Këto ditë kam analizuar fjalimin e Bill Klintonit, të datës 22 mars 1999. Epo ç'gënjeshtar patologjik është ky "Dem" nga Arkanzasi. Ai në fjalën e tij ngulmon se të dyja luftërat botërore kanë zanafillën në Sarajevë. I falem Zotit të dashur dhe të mëshirshëm, që na ka dhuruar dhuntinë që një gënjeshtar i tillë të mos ishte mik i yni.
Amerika sot nuk është vend i lirisë dhe i demokracisë, atë lloj lirie e demokracie, siç e ka përshkruar në memoaret e veta Mihailo Pupini. Ai nuk është vendi i miqve të Serbëve, si Uilsoni, Hardingu, Ruzvelti dhe Ajzenhaueri. Pas mendimit tim dhe pas mendimeve shumë më të përparuara të ekspertëve dhe diejtarëve, Amerika në kohën e sotme është rrëmbyer nga neo-fashistët dhe nga neo-nazistët.
Me një fjalë, asnjëra nga luftërat botërore nuk ka filluar në Sarajevë. Kurse "Demi" Klinton, në fjalën e vet, më 22 mars 1999, e quan revizion i historisë godine se zove. Për një gjë të tillë, nëse më mban shëndeti, Klintonit nuk do t'i mbetem borxh. Ka gjyqësi dhe ka ligje. Kjo është një diçka që ai sekso-maniak dhe gënjeshtar patologjik, edhe më i krisur se Adolf Hitleri, që ka harruar se ne të dy një ditë do takohemi; nëse ka nevojë - edhe në gjyq, dhe nëse u kërkon falje Popullit serb për gënjeshtrat e veta.
Porse, ka dhe njerëz të ndershëm. Ja se ç'thotë Sër Michael Rose përkitazi me intervenimin e NATO-s në librin e tij të fundit:

(Sidoqoftë, pa marrë parasysh llojin, sipas kuptimit të zotit Rouz, ka rëndësi të lexohen. Kjo kritikë vete larg-larg Irakut, për të theksuar bipartizanizmin, ndërgjejjen transatlantike që ka shpënë deri tek krimet madhore të luftës - një ndërgjegjje që është formuar nga shumë njerëz të lojës së mashtrimeve dhe miteve që rrethojnë ngarkesat e rënda "për intervenimin humanitar" në Bosnjë dhe në Kosovë.

Nuk kam kohë që të përkthej tërë tekstin. Mirëpo, ai tha se ka intervenuar koalicioni atlantik, kur flasim për Bosnjën dhe për Kosovën, se ka bërë krimin më të madh të luftës në historinë moderne. Ç'është e vërteta, ashtu ka bërë. Rose nuk është i vetmi patriot dhe i vetmi njeri i qytetëruar, I cili mendon kështu në botë e perëndimit. Nuk janë të gjithë njerëzit të bleshëm, zotëri Flori, me dollarët e pistë që fitohen nga kontrabanda me heroinë. Ka dhe njerëz të ndershëm.
Të tillët janë miq të serbëve, kurse unë shqiptarëve jua dhuroj falas të gjithë klintonët, adolfët dhe hollbrukët për dollarë të pështirë.
Përndryshe, Reçaku ka qenë një proçes i montuar për të mashtruar opinionin publik. Atje nuk janë vrarë shqiptarët e ndershëm dhe të pafajshëm, porse grupi i kriminelëve, për të cilë askush në botë nuk i honeps dot më. Ashtu siç mendoj dhe unë. Gënjeshtra i ka këmbët e shkurtra, zotëri Flori.
Janko Bojic, Ontario - Londër

Kush është në të vërtetë Medlin Olbright?

"Mad" Olbrajt, ose, nëse do të përkthehej drejt: "E krisur", porse nuk ka hije të ofendojmë as edhe të krisurit, kur kemi të bëjmë me ketë "zonjë të moshuar". i ati i saj, përndryshe një njeri i dashur dhe fisnik, Josif Kolberg, ka qenë një mik i madh i serbëve dhe bashkëpunëtor shumëvjeçar i Milorad Drashkoviçit, në kohën e tij, shef i bibliotekës së Kongresit. Pothuajse të gjitha librat që ka shkruar dhe lexuar profesori Kolberg, i ka përgatitur për shtyp, personalisht z. Drashkoviç.
Kolbergu ishte një hebre. Ndërsa e bija e tij - mike e madhe e dollarëve nga heroina, në një intervistë tha se kishte harruar, që me të ëmën e të atin kishte shkuar në sinagogë??? Mikja e sotme e shqiptarëve, e cila ka shpëtuar kokën falë mirësisë së popullit serb dhe e cila e ka njohur personalisht z. Drashkoviç, me të cilin është shoqëruar një periudhë, tash është matufosur dhe "shkalluar", sepse ka harruar çdo gjë. Ajo ka harruar se të atin e kishte pasur hebrenjë se, falë serbëve ajo ka shpëtuar nga dhoma e gazit dhe u është bashkangjitur shqiptarëve, të cilët, në Luftën e Dytë Botërore e kanë "pastruar" Kosovën nga hebrenjtë-Kosovo od jevreja?? Ja se çfarë miqsh janë ithtarët e Kosovës së pavarur.
Po kjo Medlin Olbrajt, me rastin e fillimit të luftës ilegale kundër Irakut, vendit

që neonazistët amerikanë e shndërruan në rrënoja, pati dhënë një deklaratë, se: resurset e SHBA-ve janë të pashterueshme. Sot po shihet se nuk janë. Njësoj si edhe maniaku Adolf që u thoshte Hunëve malinj, në Luftën e Dytë Botërore, se resurset e Gjermanisë së tij - janë të pashterueshme (Sic)!
Përndryshe, sa i përket të ashtuquajturit Tribunali i Hagës, ai nuk është as Gjyq as Tribunal, por as edhe institucion serioz i drejtësisë. Një gjyq pa juri, ku deri tash, të gjithë ata që janë sjellë aty, qysh më pare kanë qenë të gjykuar. Gjykimi në atë Tribunal është thjesht protokollar, dhe jo një gjyq i drejtë. Në atë gjyq nuk ekziston asnjë ekspert serioz i Drejtësisë, i cili di çka është e drejta dhe shkenca e drejtësisë. Ekspertët kompetentë të drejtësisë kanë analizuar dhe kanë përkufizuar "qelinë" e Hagës si një dorë e zgjatur e nazizmit dhe fashizmit. Ekspertët seriozë të së drejtës, dine se në Hagë secila process është i montuar, njësoj sikurse edhe gjykimet në kohën e pastrimeve të Stalinit.
Shëmtia më e madhe e asaj "qelie" në Hagë, në kohën e tij ka qenë gjyqtari nga Afrika e Jugut, Goldstoni. Ai maniak ngulmonte se ajo që është ilegale, mund të shndërrohet në legjitime??? Me një këso lloj të menduari, do të hutoheshin edhe Hitleri, edhe Stalini. Porse harrova atë kryesorin, tregtarin Jozefa Broz, pas rangut i quajturpo Shloser – Mareshal. Është e sigurt se dhe ai do hutohej. Për këto arsye ata "ekspertë" të Hagës, kurrsesi të fillojnë të gjykojnë dr. Sheshelin. Pse? Thjeshtë sepse Shesheli tashmë u ka thënë se ata janë barbarë, kretenë dhe idiotë. Ai ua shan nënat dhe u thotë se duhet ngrënë patjetër atë që keni bërë (…), për që thithni (…) në vend të cigars, ju thithni organin seksual. Në çfarëdo gjyqi të zakonshëm, një fjalor i tillë do të gjykohej dhe ndalohej, ashtu që ai që gjykohet, nëse nuk sillet si i qytetëruar, do të gjykohet edhe nëse është i pafajshëm. Në Hagë, i pafajshmi është i gjykuar që më pare; edhe Shesheli e di këtë, sepse ai maniakët e Hagës ua ka shqiptuar dënimin, pikërisht ashtu siç e kanë merituar.
Është herët, shkencëtar Flori, të flasim për Burgun e Hagës si për një institucion të qytetëruar. Atje kanë zbritur jo-profesionistët, porse, siç thotë Shesheli: ata janë barbarë dhe uzurpatorë të shkencës së drejtësisë. Çdo gjë që ndodh atje, do ta përshkruajë historia më pas. Dhe, kur një ditë historianët do ta përshkruajnë burgun e Hagës, atëherë do ta hetojnë një gjë që historia nuk e ka regjistruar kurrë: Do të hetojnë se "ekspertët" në Hagë kanë ngrënë fekalet e veta!? (Sic!)

Janko Bojiç

Nga Flori Bruqi:

Historia Antike

Rajoni i Kosovës ka qenë i banuar nga fiset ilire qysh nga Epoka e Bronztë. Në kohërat e lashtësisë, zona ishte e njohur si Dardania dhe ishte e banuar nja fisi me emër të njëjtë. Pjesa jugore e Kosovës ka qenë e sunduar nga Maqedonia qysh nga mbretërimi i Aleksandrit të Madh në shekullin e 4-të PK. Dardanët vendorë ishin trung ilir. Ilirët i rezistuan sundimit grekë dhe romakë me shekuj por pas një periudhe të gjatë të konfliktit ndërmjet fiseve Ilire dhe forcave pushtuese perandorake, rajoni eventualisht u pushtua nga perandoria romake nën perandorin Augustus më 28 PK dhe u bë pjesë e provincës romake të Moesia-së. Pas vitit 85 MK ishte pjesë e Moesia-së superior. Perandori Dioklecian c. 284 e bëri Dardaninë provincë të ndarë me kryeqytet në Naissus (Nish). Ilirët ishin ndër njerëzit e parë që e pranuan kristianizmin, pasi që ishin të evangjelizuar nga vet Shën Pali. Iliria është dy herë e përmendur në Bibël. Kur perandoria romake u nda në vitin 395 MK, zona e Kosovës hyri nën perandorinë lindore romake të perandorisë së bizantit. Shumë nga banorët e Dardanisë u bënë prijës në Romë dhe në Konstantinopolis, duke përfshirë edhe Justinianin e Madh. Migrimet e mëdha të mesjetës dhe sllavët, gjatë periudhës së dy mbretërive erdhën në territoret që formojnë Kosovën moderne në shekullin shtatë të migrimeve të serbëve të bardhë, me fluksin më të madh të migrimeve në vitet 630-ta, edhepse rajoni në rritje të madhe ishte i popullzuar nga sllavët qysh nga shekulli i gjashtë, e madje edhe i pestë, kur me valën e fundit zuri vend ndërmjet viteve 867 dhe 874. Pjesa verilindore e Kosovës, Hvosno, u bë pjesë e serbëve bizantinë të shtetit vazal me kryeqytet të Rascia (Ras), me Dostinik si kryeqytet të principatës. Në vitet e vonshme të 800-ta, e tërë Kosova ishte e pushtuar nga Perandoria e Parë bullgare. Edhepse Serbia e restaurojë kontrollin mbi Metohinë gjatë tërë shekullit të dhjetë, pjesa tjetër e Kosovës, i ishte kthyer perandorisë së bizantit në periudhën e rënies së Bullgarisë. Sidoqoftë, Cari Samuil i Bullgarisë e ripushtoi tërë Kosovën kah fundi i shekullit të dhjetë, përderisa bizantinët e restauruan kontrollin e tyre mbi zonën që e nënshtruan të perandorisë bullgare. Në vitet 1040-1041, bullgarët, të udhëhequr nga nipi i Samuilit të Bullgarisë, Petar Delyan, e vuri në skenë një rebelim kundër perandorisë romake-lindore që përkohësisht e gardhojë Kosovën. Pas shkatërrimit rebelues, kontrolli i Bizantit vazhdoi në rajon. Gjatë të gjitha dekadave vijuese, një numër i popujve të huaj duke e pushtuar perandorinë bizantine

sollën furtunë në Kosovë, mes tyre kumanët. Në vitin 1072, bullgarët vendor, nën George Voiteh, e bënë një orvatje përfundimtare që të restaurojnë forcën perandorake bullgare dhe e ftuan trashëgimtarit e fundit të familjes Comitopuli – princin Duklja-në, Konstantin Bodin të familjes Vojislavleviq, i biri i mbretit serb Mihailo Voislav – të marrë forcën. Serbët vendosën që të pushtojnë në tërësi rajonin bizantin të Bullgarisë. Mbreti Mihailo e dërgoi të birin me treqind luftëtarë të elitës serbe të udhëhequr nga Duka Petrilo. Konstantin Bodin-i ishte kurorëzuar në Prizren si Petar III, Car i bullgarëve nga George Voiteh dhe bojarët sllavë. Perandoria u shtri përgjatë territoreve të bizantit me muaj, deri në humbjet e rëndësishme në jug dhe e detyroi Car Petar-in të tërhiqet. Në vitin 1073, forcat bizantine e ndoqën Konstantin Bodin, e mposhtën ushtrinë e tij në Pauni, dhe e burgosën.

Inkorporimi në Serbinë

Pushtimi i plotë serbë u zbatua nën një degëz të familjes së princave të mëdhenj Voislav të Ras-it. Në vitin 1093, prince Vukan përparoi në Lipjan, plotësisht e dogji dhe plaçkiti zonat fqinjë. Vet perandori bizantin erdh në Zveçan për bisedime. Zveçani shërbeu si linjë e mbrojtjes kundrejt pushtimeve konstante nga serbët fqinjë. U vendos një marrëveshje e paqes, por këtë e prishi Vukan dhe e mposhti ushtrinë e John Comnenus, nipi i perandorit. Ushtritë e Vukan-it bënë kërdi në Kosovë. Në vitin 1094, perandori bizantin, Alexius, u orvat që të rivendosë bisedime për paqë në Ulpianë. U konkludua një marrëveshje e re e paqes dhe Vukan ia dorëzoi pengjet perandorit, dukje përfshirë edhe dy nipat e tij Uroshin dhe Stefan Vukan-in. Princi Vukan e ripërtëriu konfliktin në vitin 1106, duke e mposhtur edhe një herë ushtrinë e John Comnenus-it. Sidoqoftë, vdekja e tij e ndali pushtimin gjithsej të Kosovës nga serbët. Në vitin 1166, një bujar serb nga Zeta, Stefan Nemanja, themelues i familjes Nemanja, u vendos në fronin e madh princor të Ras-it dhe e pushtoi pjesën dërmuese të Kosovës, në një revoltë kundrejt perandorit bizantin, Manuel I Comnenus. Ai e mposhti ushtrinë e Princit të Madh të Ras-it, Tihomir-in në Pantino, afër Pauni-t. Tihomir, i cili ishte vëlla i Stefan-it, ishte mbytur në lumin Sitnica. Stefan ishte mposhtur dhe ishte i detyruar që t'i kthente disa nga pushtimet e tij. Ai iu zotua perandorit se për kurrën e kurrës nuk do t'i përtërinte armiqësitë, por në vitin 1183, Stefan Nemanja e zbarkoi një ofansivë të re me hungarezët pas vdekjes së Manuel I

Comnenus në vitin 1180, duke i dhënur fund dominimit bizantin në Kosovë. I biri i Nemanjes, Stefani II, e evidentoi që kufiri i famës serbe e kishte arritur lumin Llab. Princi i Madh, Stephen II, e kompletoi përfshirjen e territoreve të Kosovës nën sundimin serb në vitin 1208, kur edhe e kishte pushtuar Prizrenin dhe Lipjanin, dhe e kishte lëvizur kufirin e territorit nën kontrollin e tij deri në malet e Sharit.

Mbretëria e serbëve

Në vitin 1217, mbretëria serbe e arriti njohjen. Në vitin 1219, një kishë autoqefale ortodokse serbe u krijua, me Hvosno, Prizren dhe Lipjan duke u bërë episkopati krishtere ortodoks në Kosovë. Kah fundi i shekullit 13-të, qendra e kishës serbe u vendosë në Pejë nga Zhiça. Në shekullin 13-të, Kosova u bë zemra e jetës religjioze dhe e politikës serbe, me malin e Sharrit, që u bë qendër politike e sundimtarëve serbë. Kështjella kryesore ishte në Pauni. Në një ishull ishte Svrqini dhe në bregun e detit Shtimli dhe në male ishte kështjella e Nerodimles. Komplekset u përdorën për konsultë, kurorëzimin e sundimtarëve, për bisedime dhe si kuartet jetese për sundimtarët. Pas vitit 1291, tartarët depërtuan rrugës deri në Pejë. Mbreti Stefan Milutin arriti t'i mposhtë dhe pastaj t'u vehet pas. Ai e ngriti tempullin Nëna e Krishtit e Levishkes në Prizren rreth vitit 1307, që u bë selia e peshkopatit të Prizrenit, ndërsa Graçanica madhështore në vitin 1335, u bë selia e peshkopatit të Lipjanit. Në vitin 1331, i riu mbreti Dushan e sulmoi të atin e tij, mbretin serb Stefanin e Deçanit në kështjellën e tij në Nerodimle. Mbreti Stefan u mbyll në fortesën fqinjë të Petriqit, por Dushani e zuri rob dhe e mbylli atë me gruan e tij të dytë, Maria Palailogos dhe fëmijët e tyre në Zveçan, ku mbreti i rrëxuar nga froni vdiq më 11 nëntor 1331. Në vitin 1327 dhe 1328, mbreti serb Stefani i Deçanit filloi krijimin pronës së madhe të Deçanit, edhepse, mbreti serb Dushani do ta kryente në vitin 1335. Stefani i Deçanit e botoi Kartën Dechani në vitin 1330, duke e bërë listën e çdo qytetari në secilën amvisëri sipas çifligut të tokës së kishës.

Perandoria serbe dhe despotizmi

Mbreti Stefan Dushan e themeloi manastirin e gjerë të Shën Arkangjelit afër Prizrenit në vitin 1342-1352. Mbretëria ishte transformuar në perandori në vitin 1345 dhe zyrtarisht në vitin 1346. Stefan Dushan e pranoi John VI Cantacuzenus në vitin 1342 në kështjellën e tij në Pauni që të bisedojnë në lidhje me një luftë të përbashkët kundër perandorit Bizantin. Në vitin 1346, arkepiskopi serb në Pejë u promovua në patriark, por nuk u pranua para vitit 1370. Pas rënies së perandorit në çrregullime para vdekjes së Dushanit në vitin 1355, anarkia feudale e zënë me punët e vendit gjatë mbretërimit të Car Stefan Urosh V. Kosova u bë zotërim i shtëpisë së Mrnjavqeviqëve, por princi Voislav Voinoviq e zgjeroi pronën e tij më tutje në Kosovë. Ushtritë e mbretit Vukashin Mrnjavçeviq nga Prishtina dhe aleatët e tij i mposhtën forcat e Voislav-it në vitin 1369, duke i vërë një ndalim në përparimin e tij. Pas Betejës së Maricës më 26 shtator 1371, në të cilën vëllezërit Mrnjavçeviq, vëllezërit i humbën e jetët e tyre, Gjuragj I Balshiq i Zetës e mori Prizrenin dhe Pejën në vitin 1372. Një pjesë e Kosovës u bë pronë e shtëpisë së Lazareviqëve. Otomanët pushtuan dhe takuan koalicionin krishterë të serbëve, shqiptarëve dhe vllahëve nën princ Lazarin më 28 qershor 1389, afër Prishtinës, në Gazi Mestan. Ushtria serbe ishte e asistuar nga aleatë të ndryshëm. Beteja epike e Kosovës vazhdoi dhe në të cilën princ Lazari e humbi jetën e tij. Princ Lazari kishte mbledhur 70,000 njerëz në fushëbetejë dhe otomanët kishin 140,000. Me anën e dhelpërisë së Milosh Obiliqit, sulltan Murad ishte vrarë dhe sulltanit të ri Beyazid, edhepse e fitoi betejën, iu deshtë të konsolidonte forcën e tij. Sulltani otoman u varros me njërin nga bijtë e tij në Gazi Mestan. Princ Lazari dhe Millosh Obiliqi u kanonizuan së bashku nga kisha ortodokse serbe për përpjekjet e tyre në këtë betejë. Shtëpia vendore e Brankoviqëve erdhi në dominim si lordë vendor të Kosovës, nën Vuk Brankoviqin, me rënien e përkohshme të despotizmit serb në vitin 1439. Një betejë tjetër e madhe ndodhi ndërmjet trupave hungareze e mbështetur nga sundimtari shqiptar Gjergj Kastrioti Skanderbeg, në njërën anë, dhe trupat otomane, të mbështetura nga Brankoviqët në vitin 1448. Trupat e Skanderbeg-ut që shkonin t'i ndihmonin John Hunyad-it, ishin ndalur nga trupat e Brankoviq-it, i cili pak a shumë ishte një vasal turk. Mbreti hungarez, John Hunyadi e humbi betejën pas dy-ditë të luftës, por thelbësisht i ndali otomanët të përparojnë në drejtim të veriut. Pastaj, Kosova u bë vasale e perandorisë otomane, deri në inkorpo-

rimin e saj të drejtpërdrejt pas rënies përfundimtare të Serbisë në vitin 1459. Në vitin 1455, kështjella të reja u ngritën në shenjë dominimi në Prishtinë dhe Vuçitërnë, qendra të vasalitetit otoman të shtëpisë së Brankoviqëve.

Sundimi otoman

Otomanët me vedi e sollën Islamizimin, posaçërisht në qytete, dhe më vonë e krijuan vilajetin e Kosovës, si një nga entitetet territoriale otomane. Kosova ishte marrë nga forcat austriake gjatë Luftës së Madhe të viteve 1683 - 1699 me ndihmën e 5,000 shqiptarëve dhe prijsinë e tyre, një kryepeshkop katolik Pjetër Bogdanin. Kryepeshkopi vdiq nga murtaja gjatë luftës, dhe varreze e tij ishte rihapur më vonë, me trupin e tij të shpartalluar, dhe otomanët ia kishin dhënë qejve për shkak të rolit të tij rebelues. Në vitin 1690, patriarku serb i Pejës,Arsenije III, i cili më herët i kishte ikur njëfarë vdekjeje, u priu 37,000 familjeve nga Kosova, që t'i ikte zemërimit otoman, pikërisht kur Kosova ishte pushtuar nga otomanët. Njerëzit që e ndoqën ishin shumica serbë dhe shqiptarët e braktisën- por si duket iu bashkangjitën grupet tjera etnike. Për shkak të presionit të madh nga otomanët, migrantët tjerë të popullatës ortodokse nga zona e "Kosovbës", vazhduan gjatë tërë shekullit të 18-të. Poashtu është shënuar që disa serbë e morren islamin, por disa të tjerë gradualisht u fuzionuan me grupet tjera, predominante shqiptare, duke e adaptuar kulturën e madje edhe gjuhën e tyre. Në vitin 1766, otomanët e shfuqizuan patriarkun e Pejës/Pec dhe pozita e krishterëve në Kosovë më të madhe u zvogëlua. Të gjitha privilegjet e mëparshëme u humbën dhe popullatës krishtere iu deshtë të vuante tërë peshën e zgjerimit të perandorisë dhe të humbjes së luftrave, madje dhe duke i qortuar se ishin fajtor për humbje.

Koha moderne

Në vitin 1871, u mbajt një takim masiv serb në Prizren, në të cilin u diskutua mundësia e rimarrjes dhe e re-integrimit të Kosovës dhe të pjesës tjetër të " Serbisë së Vjetër", si vetë principatë e Serbisë dhe tashmë kishin bërë plane për zgjerim drejtë territorit otomanë. Refugjatët shqiptarë nga

territoret e okupuara në vitin 1876-1877 të luftës serbo-turke dhe të vitit 1877-1878 të luftës ruso-turke, tani janë si 'muhaxher' (që do të thotë 'refugjat', nga arabishtja muhajir). Pasardhësit e tyre ende e kanë mbiemrin, muhaxheri. Vlerësohet që 200,000 deri në 400,000 serbë janë dëbuar nga vilajeti i Kosovës, ndërmjet viteve 1876 dhe 1912, posaçërisht gjatë luftës greko-otomane në vitin 1897.Në vitin 1878, u bë një akordim paqje që i la qytetet e Prishtinës dhe të Mitrovicës së Kosovës në kontrollin civil serbë, dhe jashtë jurisdikcionit të organeve otomane, ndërsa pjesa tjetër e Kosovës mbeti nën kontrollin otoman. Shqiptarët formuan Lidhjen Nacionaliste dhe Konservative të Prizrenit, në Prizren, më vonë në të njëjtin vit. Më shumë se treqind prijësa shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia perëndimore u mblodhën dhe diskutuan në mënyrë urgjente çështjet në lidhje me mbrojtjen e rajonit me popullsi shqiptare nga ndarja mes vendeve fqinjë. Lidhja ishte e mbështetur nga sulltani otoman për shkak të ideologjisë së tij pan-islamike, si dhe aspiratat politike të një populli të unifikuar shqiptar nën amrellën otomane. Lëvizja gradualisht u bë anti-krishtere dhe zgjeroi ankth të madh mes shqiptarëve krishterë e posaqërisht mes serbëve krishterë. Si rezultat i kësaj, shumë serbë e lanë Kosovën në drejtim kah veriu. Serbia u ankua në forcat botërore se territoret e premtuara nuk janë duke u mbajtur [sqaro] sepse otomanët janë duke ngurruar ta bëjnë këtë. Forcat botërore bënë presion në otomanët dhe në vitin 1881, ushtria otomane filloi t'i luftojë forcat shqiptare. Lidhja e Prizrenit e krijoi një everi të përkohshme me presidentin, kryeministrin (Ymer Prizreni) dhe Ministrinë e Luftës (Sylejman Vokshi), dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme (Abdyl Frashëri). Pas tre vitesh të luftës, shqiptarët u mposhtën. Shumë nga liderët u ekzekutuan dhe u burgosën. Traktati sabsekuent i San Stefano në vitin 1878 restauroi shumë toka të shqiptarëve në kontrollin otomanë, por forcave serbe iu desht të tërhiqen nga Kosova së bashku me disa serbë që gjithashtu ishin dëbuar [citimi nevojitet]. Në vitin 1908, sulltani solli një dekret të ri demokratik që ishte valid vetëm për folësit-turqisht. Me qenë se pjesa dërmuese e mazhorancës së Kosovës fliste shqip ose serbisht, popullsia e Kosovës ishte e brengosur. Lëvizja e turqëve të rinj e mbështeti një rregull centraliste dhe iu kundërvu çfarëdo autonomie të dëshiruar nga kosovarët e, posaçërisht nga shqiptarët. Në vitin 1910, një kryengritje shqiptare u zgjerua nga Prishtina dhe zgjati gjersa sulltani otomanë e vizitoi Kosovën në qershor të vitit 1911. Qëllimi i "Lidhjes së Prizrenit" ishte të bashkonte që të katër vilajetet shqiptare, duke i bashkuar banorët mazhorancë shqiptarë përbrenda Perandorisë Otomane në një shtet shqiptar. Sidoqoftë, në atë kohë serbët përbënin afër 25% të tërë vilajetit të Kosovës, të popullsisë së

gjithkapshme dhe i kundërviheshin qeverisjes shqiptare së bashku me turqit dhe sllavët tjerë në Kosovë, gjë kjo që i pamundësonte lëvizjet shqiptare që të pushtonin Kosovën. Në vitin 1912, gjatë luftrave ballkanike, pjesa dërmuese e Kosovës ishte marrë nga mbretëria e Serbisë, ndërsa rajoni i Metohisë (shqip: Rrafshi i Dukagjinit) ishte marrë nga mbretëria e Malit të Zi. Ndodhi një eksod i popullsisë vendore shqiptare. Këtë më së miri e ka përshkruar Leon Trotsky, i cili ishte një reporter në atë kohë për gazetën "Pravda". Autoritetet serbe planikuan një rekolonizim të Kosovës.[7] Një numër i familjeve koloniste serbe u vendosën në Kosovë, duke e bërë balansimin demografik ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Shumë shqiptarë ikën në male dhe shumë shtëpi të një numri shqiptarësh dhe turqë u bënë rrafsh me tokën. Ripushtimi i Kosovës u shënua si një hakmarrje për Betejën e Kosovës, të viti 1389. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, në vitin 1912, të kryesuar nga Sir Edëard Grey, Sekretari Britanik për Punë të Jashtme, mbretërive të Serbisë dhe Malit të Zi, ua bëri me dije sovraniteti ndaj Kosovës. Në dimër të vitit 1915-1916, gjatë Luftës së I Botërore, Kosova e përjetoi një eksod të madh nga ushtria serbe që u bë i njohur si Tërheqja e Madhe Serbe. Të mposhtur dhe të rraskapitur në betejat kundër austro-hungarezëve, nuk patën zgjidhje tjetër pos të tërhiqen, pasi që Kosova ishte okupuar nga bullgarët dhe austro-hungarezët. Shqiptarët iu bashkuan dhe i mbështetën forcat qendrore. Pasi u ishin të kundërvuara shkollave serbe, një numër i madh i shkollave shqiptare u hapën gjatë 'okupimit' (shumica e popullsisë shqiptare këtë e konsideroi si çlirim). Anijet aleate ishin duke pritur për popullin dhe ushtarët serbë në brigjet e detit Adriatik, dhe në shtegun që i shpinte ata nëpër Kosovë dhe Shqipëri. Dhjetëra mijë ushtarë kanë vdekur nga uria, klima ekstreme dhe represaliet shqiptare gjerësa ishin duke iu afruar aleatëve në Korfuz dhe Selanik, duke e bërë një grumbull prej 100,000 të të tërhequrëve të vdekur.[nevojitet citimi] Të transportuar nga linjet e frontit ushtria serbe ia arriti të shërojë shumë nga ushtarët e sëmurë dhe të plagosur dhe t'iu ofrojë pushim. Të rifreskuar dhe të regrupizuar, u vendos të kthehen në fushëbetejë. Në vitin 1918, ushtria serbe i qiti jashtë Forcat e Qendrore të Kosovës. Gjatë çlirimit të Kosovës, ushtria serbe bëri shumë sjellje të egra në hakmarrje ndajë popullsisë.[nevojitet citimi] Kosova ishte unifikuar me Malin e Zi pasi që mbretëria e Malit të Zib iu kishte bashkuar në mënyrë sabsekuente mbretërisë së Serbisë. Pasi mori fund Lufta e I Botërore, monarkia pastaj u shëndrrua në mbretërinë e serbëve, kroatëve dhe të sllovenëve (shqip: Mbretëria serbe, kroate, sllovene, serbo-kroatisht: Kraljevina Srba, Hrvata i Slovenaca) më 1 dhjetor 1918, duke i përmbledhur territoret e fituara me fitore.

Mbretëria e Jugosllavisë dhe Lufta e Dytë Botërore

Periudha e viteve 1918-1929 e "Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene", ishte dëshmitare e rritjes së popullatës serbe në rajon dhe një rënie e jo-serbëve. Në mbretëri, Kosova ishte e ndarë në katër vende – tre si pjesë e entitetit të Serbisë: Zveçani, Kosova dhe Metohia Jugore, dhe një e Malit të Zi: Metohia veriore. Sidoqoftë, sistemi i ri administrativ që nga 26 prilli 1922, e ndau Kosovën në tri zonat e mbretërisë: Kosova, Rashka dhe Zeta. Në vitin 1921, elita shqiptare e parashtoi një protestë zyrtare të qeverisë në "Ligën e Kombeve", duke pohuar që 12,000 shqiptarë janë vrarë dhe më tepër se 22,000 janë burgosur, që nga viti 1918, dhe kanë kërkuar unifikimin e tokave të populluara shqiptare. Si rezultat, një lëvizje e armatosur e rezistencës kachak-e u krijua me qëllimin kryesor që të bashkojë zonat e populluara të mbretërisë me shqiptare deri në Shqipëri. Në vitin 1929, mbretëria u shëndrua në "Mbretëria e Jugosllavisë". Territoret e Kosovës u ndanë në "Banati i Zetës", "Banati i Moravës" dhe "Banati i Vardarit". Mbretëria zgjati deri në Luftën e II Botërore të invazionit të Boshtit në vitin 1941. Pjesa më e madhe e Kosovës u bë pjesë e kontrollës italiane-fashiste të Shqipërisë, dhe disa pjesëza mbetën nën kontrollin e Tsardom (Carit) të Bullgarisë dhe nazi gjermane-mbretëria e okupuar e Serbisë. Gjatë okupimit fashist të Kosovës, nga shqiptarët, vetëm deri në gusht të vitit 1941, mbi 10,000 serbë u vranë, e ndërmjet 80,000 dhe 100,000 serbë u dëbuan, ku përafërsisht numri i njëjtë i shqiptarëve u sollën nga Shipëria, që të vendosen në këto toka serbe. [8] Mustafa Kruja, kryeministër i Shqipërisë, ishte në Kosovë në qershor të vitit 1942, dhe në një takim me liderët shqiptarë të Kosovës, ai tha: "Ne duhet të përpiqemi që të sigurojmë që popullata serbe e Kosovës, të jetë – zonë e spastrimit të tyre dhe të gjithë serbët që kanë jetuar aty me shekuj të marrin shprehjen e kolonialistëve dhe të dërgohen në kampet e përqëndrimit në Shqipëri. Kolonët serbë duhet të vriten." [9][10]Para kapitullimit të Italisë fashiste 1943, forcat gjermane e morën kontrollin direkt të rajonit. Pas shumë kryegrintjeve të partizanëve të udhëhequr nga Fadil Hoxha, Kosova u çlirua pas vitit 1944 me ndihmën e partizanëve shqiptarë të kominternës dhe u bë provincë e Serbisë në kuadër të "Federatës Demokratike të Jugosllavisë".

Kosova në Jugosllavinë e dytë

Provinca është formuar në vitin 1945, si Krahinë Autonome e Kosovës-Metohisë, të mbrojë [nevojitet citati] mazhorancën e shqiptarëve të vet rajonal brenda Republikës Popullore të Serbisë, si anëtare e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, nën udhëheqjen e ish prijësit partizan, Josip Broz Tito, por pa autonomi faktuale. Pas ndërrimit të emrit të Jugosllavisë në Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë, dhe të Serbisë, në Republikën Socialiste të Serbisë, në vitin 1953, Kosova e fiton një autonomi të brendshme në vitet 1960-ta. Në kushtetutën e vitit 1974, Provinca Autonome Socialiste e Kosovës, mori forca më të mëdha, duke përfshirë edhe titujt qeveritar — president dhe premijer dhe një ulëse në kryesinë federale, që e bëri de facto Republikë Socialiste në kuadër të Federatës, por duke mbetur si Provincë Socialiste Autonome në kuadër të Republikës Socialiste të Serbisë. Tito e ka ndjekur një politikë të dobësimit të Serbisë, pasi që besonte që "Një Serbi e dobët është e barabartë me një Jugosllavi të fortë". Gjer në këtë masë, Vojvodina dhe Kosova u bënë rajone autonome dhe i kishin marrur privilegjet më të larta, të autorizuara si de facto, republika.[nevojitet citati] serbokroatishtja, shqipja dhe turqishtja, ishin definuar si gjuhë zyrtare në nivel të provincës, duke krijuar dy grupet më të mëdhaja linguistike kosovare: shqiptarë dhe serbët. Në vitet 1970-ta, një lëvizje nacionaliste shqiptare ndjeku një njohje të plotë të provincës së Kosovës si republikë tjetër në kuadër të federatës, ndërsa elementët më ekstreme kishin për qëllim për pavarësi të shkallës së plotë. Regjimi arbitrar i Tito-s u mor me çështjen në mënyrë mjaft shpejtë, por vetëm duke i dhunuar si një zgjidhje të përkoshme. Balansi etnik i Kosovës ishte dëshmitar i rritjes joproporcionale pasi që numri i shqiptarëve u trefishua gradualisht duke u rritur gati në 75% në mbi 90%, por numri i serbëve memzi u rrit dhe ra në ndarjen e plotë të popullsisë nga 15% në atë 8%. Edhepse Kosova ishte vendi më së paku i zhvilluar në ish Jugosllavinë, prospektet e jetesës, dhe ato ekonomike, si dhe liritë, ishin më të mëdhaja se sa nën regjimin totalitarist maoist në Shqipëri.Në fillim të marsit 1981, studentët kosovar-shqiptarë organizuan protesta duke kërkuar që Kosova të bëhet republikë në kuadër të Jugosllavisë. Ato protesta eskaluan në trazira të dhunshëme "duke involvuar 20,000 njerëz në gjashtë qytete"[11] që ishin ashpër të përbëra nga qeveria jugosllave. Gjatë viteve 1980-ta, tensionet etnike vazhduan më me shpërthim dhune frekuente kundër serbëve

dhe shtetit jugosllav, duke rezultuar në emigrimin e rritur të serbëve të Kosovës dhe grupeve tjera etnike.[12][13] Lidershipi jugosllav u orvat të shtyp protestat e serbëve të Kosovës, që kërkonin mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna etnike.[14] Në vitin 1986, Akademia Serbe e Shkencave dhe Arteve (ASSA) ishte duke punuar në një dokument që më vonë do të jetë i njohur si ASSA Memorandum, një vërejtje për presidentin serb dhe kuvendin për ekzistimin e krizës dhe ku do të shpie. Një botim i pakryer ishte filtruar për shtypje Në esej, ASSA e kritikonte shtetin e Jugosllavisë dhe bënte vërejtjet e veta që vetëm shteti anëtar bënte kontribut n zhvillimin e Kosovës dhe Maqedonisë (në atë kohë, territoret më të varfra të Federatës) ishte Serbia. Sipas ASSA, Jugosllavia vuante nga konflikti etnik dhe dezintegrimi i ekonomisë jugosllave në sektoret e ndara ekonomike dhe në territore që e transformonin shtetin federal në një federatë humbëse. [15] Në anën tjetër, disa mendojnë që Sllobodan Millosheviq, e ka përdorur moskënaqësinë e reflektuar në ASSA memorandum, për qëllime të veta politike, gjatë ngritjes së tij në fuqi në atë kohë në Serbi.[16], Millosheviq ishte dërguar së pari si anëtar i partisë komuniste. Së pari, Millosheviq nuk kishte biseduar me nacionalistët serbë, të cilët ishin duke demonstruar për të drejtat dhe liritë të cilat u mohoheshin. Gjatë këtyre takimeve ai u pajtua të dëgjonte për vrerosjet e tyre. Gjatë takimit, jashtë ndërtesës ku mbahej ky forum, policia filloi një përleshje me vendorët që ishin mbledhur aty, shumica serbë, të hidhëruar që të ngrisnin zërin e tyre. Pas dëgjimit të brutalitetit të policisë jashtë holleve, Millosheviq doli jashtë, dhe në një moment emotiv u premtoi serbëve lokalë, që "Askush nuk ka për të ju rrahur më." Këto lajme u shikuan në mbrëmbje, të katapultuara, gjerë atëherë, për Millosheviqin e panjohur, që u gjet në ballë të debatit aktual mbi problemet në Kosovë.Qysh nga Kushtetuta e vitit 1974, shqiptarët, zyrtarët komunistë e kontrollonin Kosovën, e institucionalizuan një fushatë në Kosovë të diskriminimit kundrejt jo-shqiptarëve, serbëve dhe të tjerëve jo-shqiptarë si romët,turqit dhe maqedonët, ku u shkarkuan nga puna dhe pozitat në kuadër të aparatit qeveritar rajonal. Këto represione dhe fyerje u fshinë në mënyrë konvencionale nën qilim me pretekstin politik "Vëllezërimi dhe Bashkim", të institucionalizuar atëbotë nga i ndjeri Josip Broz Tito. Çdo arsyetim për të kundërtën shpejtë u heshtë. Në zhgënjimin e liderit, së shpejti u etiketua si reaksionare. Në mënyrë që ta ruanta lëkurën e tij, Millosheviqi nuk ndejti duarkryq dhe e themelojë një grusht shteti politik. Fitoi një lidership efektiv dhe kontrollin në partinë komuniste serbe dhe bëri shtypje para me çështjen që i dha shtytje të jetë në ball të vëmendjes politike që ekzistonte në Kosovë. Kjo bëri që kah fundi i viteve 1980-ta, thirrjet

për kontrollin e rritur federal për krizat e shpërthyara në provincës autonome filluan të bëhen më të zëshme. Sllobodan Millosheviq bëri presion për ndërrime kushtetutare, duke e peshuar suspendimin e autonomisë, bashkarisht, si për Kosovën ashtu edhe për Vojvodinën.[17]

Kosova dhe shpërbërja e Jugosllavisë

24. ^ "Kosovo: The Human Rights Situation and the Fate of Persons Displaced from Their Homes (.pdf)", report by Alvaro Gil-Robles, Council of Europe Commissioner for Human Rights, Strasbourg, October 16, 2002, p. 30.
25. ^ Note: Including Roma, Egyptian, Ashkalli, Turks and Bosniaks. – Sources:
o Coordinating Centre of Serbia for Kosovo-Metohija: Principles of the Program for Return of Internally Displaced Persons from Kosovo and Metohija
o "Kosovo: The Human Rights Situation and the Fate of Persons Displaced from Their Homes (.pdf)", report by Alvaro Gil-Robles, Council of Europe Commissioner for Human Rights, Strasbourg, October 16, 2002, p. 30.
26. ^ UNHCR, Critical Appraisal of Responsee Mechanisms Operating in Kosovo for Minority Returns, Pristina, February 2004, p. 14.
27. ^ U.S. Committee for Refugees (USCR), April 2000, Reversal of Fortune: Yugoslavia's Refugees Crisis Since the Ethnic Albanian Return to Kosovo, p. 2-3.
28. ^ "Kosovo: The human rights situation and the fate of persons displaced from their homes (.pdf)", report by Alvaro Gil-Robles, Council of Europe Commissioner for Human Rights, Strasbourg, October 16, 2002.
29. ^ International Relations and Security Network (ISN): Serbians return to Kosovo not impossible, says report (.pdf) , by Tim Judah, June 7, 2004.
30. ^ European Stability Initiative (ESI): The Lausanne Principle: Multiethnicity, Territory and the Future of Kosovo's Serbs (.pdf) , June 7, 2004.
31. ^ Coordinating Centre of Serbia for Kosovo-Metohija: Principles of the program for return of internally displaced persons from Kosovo and Metohija
.
32. ^ UNHCR: 2002 Annual Statistical Report: Serbia and Montenegro, pg. 9
33. ^ U.S. Committee for Refugees and Immigrants (USCRI): Country report: Serbia and Montenegro 2006.
34. ^ U.S State Department Report, published in 2007
35. ^ "Kosovo: Serb minister resigns over misuse of funds", Adnkronos inter-

national (AKI), November 27, 2006
36. ^ "Sole Kosovo Serb cabinet minister resigns: PM ", Agence France-Presse (AFP), November 24, 2006.
37. ^ "UN envoy seeks multi-ethnic, self-governing Kosovo ", Agence France-Presse (AFP), Vienna, February 2, 2007.
38. ^ "[http://news.yahoo.com/s/nm/20070310/wl_nm/serbia_kosovo1_dc_4;_ylt=AvL5xEUliSVd9RrxZLjpSI8XxHcA UN to decide Kosovo's fate as talks end deadlocked] ", Reuters, Vienna, March 10, 2007.
39. ^ "Kosovo's status — the wheels grind on", The Economist, October 6, 2005
40. ^ "Putin says world should regard Kosovo, separatist Georgian regions on equal footing", International Herald Tribune, September 13, 2006.
41. ^ "Russian ambassador: Compromise or veto", B92, December 4, 2006.
42. ^ UNDP: Early Warning Report page 16, March 2007 http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/EWR15FinalENG.pdf
43. ^ worldbank.org
44. ^ Christian Science Monitor 1982-01-15, "Why Turbulent Kosovo has Marble Sidewalks but Troubled Industries"
45. ^ worldbank.org
46. ^ http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/enlargement_papers/2005/elp26en.pdf
47. ^ http://www.eciks.org/english/lajme.php?action=total_news&main_id=386
48. ^ http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/enlargement_papers/2005/elp26en.pdf
49. ^ http://www.buyusa.gov/kosovo/en/doingbusinessinkosovo.html
50. ^ http://www.seerecon.org/kosovo/documents/wb_econ_report/wb-kosovo-econreport-2-2.pdf
51. ^ Croatia, Kosovo sign Interim Free Trade Agreement, B92, 2 October 2006
52. ^ euinkosovo.org
53. ^ http://www.kosovo-eicc.org/oek/index.php?page_id=64
54. ^ http://www.buyusa.gov/kosovo/en/doingbusinessinkosovo.html
55. ^ Kosovo Economic Briefing (April), worldbank.org
56. ^ http://www.euinkosovo.org/uk/invest/invest.php
57. ^ "Brussels offers first Kosovo loan", BBC News Online, 3 May 2005.
58. ^ Transparency Initiative for Kosovo (TIK), UN Development Programme in Kosovo.

59.http://www.ks-gov.net/esk/esk/pdf/english/general/kosovo_figures_05.pdf
60. ^ http://www.salon.com/news/1999/03/31newsa.html
61. ^ http://www.serbianunity.net/news/world_articles/Dragnich1098.html
62. ^ Religion in Kosovo - International Crisis Group
63. ^ http://www.world-gazetteer.com/wg.php?x=&men=gcis&lng=en&dat=32&srt=npan&col=aohdq&geo

External links

• The office of Prime Minister of Kosovo English version
• Kosovo Assembly (Kuvendi i Kosovws) English version
• The Official Webportal of Tourism in Kosovo
• EU Commission report on economic development in Accession countries, including Kosovo
• http://www.unosek.org/unosek/index.html UN Special Envoy's Office Website
• Kosovo travel guide from Wikitravel
• RTK - Kosovo's public television - news in Albanian, Serbian, Turkish and Roma
• KosovaKosovo A source of information reflecting both sides' claims in the dispute
• UNMIK UN led civilian administration in Kosovo.
• EU EU Pillar in Kosovo.
• Otvoreno A place where Serbian politicians speak openly on the Kosovo issue. In Serbian language only.
• KIM-Info News Service, News from Kosovo in English and Serbian
• (ICG) International Crisis Group, a source of independent analysis on Kosovo issues.
• Kosovo Roma Oral History Project An advocacy website for Kosovo's Roma/Gypsies, with significant details on Kosovo's contested history.
• ECIKS Economic Initiative for Kosovo, information on investment opportunities.
• US State Dept. fact sheet "The Ethnic Cleansing of Kosovo"
• Kosovo Blog Online" Kosovo Search Challenge: Helping people find information for Kosovo, the positive side of Kosovo.

Pro-Albanian

• Albanian.com A Community portal where Albanians share information and ideas.
• Alliance for a New Kosovo A Policy Resource on Kosovo Independence.

• KosovoEvidence.com - movie about what happened in Kosovo during the war
• Economic Initiative for Kosovo - "…latest news, analysis and publications from the Kosovar economy"
• Why Independence for Kosovo? A summary of the case for an independent Kosovo by two Priština intellectuals
• Alliance for New Kosovo A policy resource on Kosovo independence
• Kosovo Crisis Center A collection of articles on Kosovo, in English.
• AACL Albanian American Civic League.
• KosovaLive Kosovo Albanian independent news agency (this section in English).
• American Council for Kosova - U.S. nonprofit organization dedicated to a better understanding of the issue of Kosovo by the American public
Pro-Serbian
• Serbian Government for Kosovo-Metohija Website that focusses on the human rights situation of Serbian and other non-Albanian populations in Kosovo. (in English and Serbian)
• Kosovo Compromise Presentation on Kosovo issue of 4S Institute, Brussels
• Rastko Project dedicated to Serb and Serb-related arts and humanities(in English)
• Terror in Kosovo Terror in Kosovo (in English)
• Coordination Center of SCG and the Republic of Serbia for Kosovo (in English, Serbian and Albanian)
• Kosovo-The Land of the Living past (in English)
• B92 Serbian Independent news agency (in English)
• Save Kosovo - U.S. nonprofit organization dedicated to promoting a better American understanding of the Serbian province of Kosovo and Metohija and of the critical American stake in the province's future. (in English)
• Kosovo 2006 Making of a Compromise (in English)
• Diocese Kosovo of Serbian Orthodox Church (in English, Serbian and Russian)

Flori Bruqi
11. maj 2007. u 09:49

03
Letër e hapur për z. J. Bojiç në rastin e letrës: "Të gjithë miqtë e shqiptarëve të Kosmetit" dhe shkresës së Mr.Sci. Flori Bruqi "Lëmshi po zgjidhet".

1. Flori Bruqi është shkencëtar dhe shkrimtar i njohur i Kosovës, me reputacion botëror.
2. Për ne shqiptarët, z. Bojiç është i panjohur, që shkruan marrëzira kundër disa personaliteteve (politikanëve) me nam botëror.
3. Shqiptarët kurrënjëherë nuk kanë qenë nazistë, siç nuk kanë bërë hegjemonizëm ndaj popujve të tjerë.
4. Mësa i përket krishtërimit, hebrenjtë ishin të parët, pas tyre grekët dhe ilirët, dmth. shqiptarët, që me epokën e re.
5. Për këto kemi dhe prova biblike se ilirët janë të parët e Ballkanit, që kanë përqafuar Zotin e vërtetë, kur "Shën Pali" nis udhëtimin e tij që nga Jerusalemi për të mbërritur në Ballkan –ILIRDË,duke përhapur lajmin e mirë,dhe njëkohësisht duke ungjillizuar Ballkanin. (Nëse z. Bojiç nuk e di, le të marrë mundin dhe të lexojë Dhiatën e Re, letrat që i dërgohehin bashkësisë së Romës, kapitulli 15, vargu 19.
6. Serbët kanë ardhur në Ballkan nga shekulli i shtatë nga Karpatet.Ata kanë marrë(kopjuar) doket dhe kulturën e kamur në Ballkan, dmth. atë të ilirëve të lashtë.
7. Do të kishte qenë mire, që ju, z. Bojiç dhe të gjithë serbët, të kishit lexuar librin e ilirologut dhe akademikut Aleksandër Stipçeviç: "Kultura dhe arkeologjia e Ballkanit",dhe aty do të gjeni fakte të shumta për historinë e krishterimit tek ilirët e më vonë te shqiptarëve,si pasardhës të tyre. Besojmë se këtë libër do ta keni në akademinë tuaj serbe në Beograd, Rruga Francuska nr.7.
8. Kur kemi të bëjmë me masakrat në Kosovë, bërë nga UJ, MPB dhe formacionet paramilitare, duhet thënë se nuk është hera e parë, që serbët bënë këso masakrash mbi popullatën shqiptare.Ju keni bërë masakra të ndotshme mbi njerëzit e pafajshëm në Osijek, Srebrenicë, dhe në tërë Bosnjen e më në fund - në Kosovë.
9. Për ju e gjithë bota është e padrejtë. Këtu s'ka se çfarë të thuhet më, z. Bojiç, kurse ne dyshojmë se ju vërtet meritoni të jetoni në territorin e ILIRIDËS (nëse do të ishit pasardhës të shqiptarëve) dhe në Europë!!!...
Flori Bruqi ka thënë të gjitha për ju. Tani nuk kemi ç'të themi tutje për ju, z. Bojiç, ndaj nuk meritoni, sepse ju predikoni vetëm urrejtje ndaj gjithë popujve të botës.
Fundja, natyra bën të veten. Juve ju kthen prapa, në Pashallëkun e Beogradit, kurse ne na lë në Dardani, këtu ku kemi jetuar prej shekujsh si autoktonë në trojet etnike pellazgo/ilire!!!...
Askush nuk mund të luftojë kundër natyrës dhe kundër kohës…

Mund të ju informojmë se ne kemi patur përkthyesin e parë të Librit të Shenjtë/Biblën, nga gjuha e vjetër greke në gjuhën latine (Shën Jeronimi). Pastaj kemi patur Shën Xhonin/françeskan - Albanin, e Klementin e VI të shekullit 16 , pastaj Shën Florin… dhe të madhin Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, i cili ka mbrojtur Serbinë, Hungarinë dhe Austrinë nga otomoanët.
Në krye kemi dhe Nënën e Shenjtë Terezë,nobelisten e njohur me namë botërore.
Me nderime,
Hajdar Fejzullahu
Prishtinë, 11 maj 2007
Hajdar Fejzullahu
Prishtinë-DRENICË, 11 maj 2007, ora 13:45

04

Tito had pursued a policy of weakning Serbia, as he believed that a "Weak Serbia equals a strong Yugoslavia". To this end Vojvodina and Kosovo became autonomous regions and were given the above entitled privileges as defacto republics.[citation needed] Serbo-Croatian, Albanian and Turkish were defined as official languages on the provincial level marking the two largest linguistic Kosovan groups: Albanians and Serbs. In the 1970s, an Albanian nationalist movement pursued full recognition of the Province of Kosovo as another Republic within the Federation, while the most extreme elements aimed for full-scale independence. Tito's arbitrary regime dealt with the situation swiftly, but only giving it a temporary solution. The ethnic balance of Kosovo witnessed unproportional increase as the number of Albanians tripled gradually rising from almost 75% to over 90%, but the number of Serbs barely increased and dropped in the full share of the total population from some 15% down to 8%. Even though Kosovo was the least developed area of the former Yugoslavia, the living and economic prospects and freedoms were far greater then under the totalitarian Maoist regieme in Albania.

ALBANIAN INITIATIVE FOR RECONCILIATION WITH SERBIAN PEOPLE

Whoever knows or will get to know historical truths - the Albanian people and the Serbian people are enemies and have been in conflict for centuries. The most intense period of hostility (which is remembered by most Albanians today) is that at the end of the 19th Century. This hostility escalated again at the beginning of the 20th Century, during the First and Second Balkan Wars as well as during the First and the Second World Wars.

The most recent hostility between Albanians and Serbs was provoked by the Serbian regime under Slobodan Milosevic's rule during, during the years 1989-1999. With regard to the proportions of Serbian crimes against Albanians in the years 1988-1999, the world opinion is widely informed; hence there is no need to recall them and their consequences again.

The interest of the Albanian people and the Serbian people today is reconciliation and understanding for building the present and the future, for good neighborliness and sustainable peace.

Despite that from the Serbian side there are only some lone voices apologizing for crimes committed by the Serbian regime against the Albanian people (during 1989-1999), we, the Albanian initiators for reconciliation between the Albanian people and the Serbian people, would like to ask our people to stretch out the hand of reconciliation to the Serbian people. We base our call mainly on our mutual interest for a more humane and peaceful today and tomorrow for our people and the Serbian people. We hope that our people will soon come to support our call; likewise, we also hope that Serbian people will respond to our readiness for reconciliation.

Until the Serbian people become conscious of the need for reconciliation, we ask the Albanian people to demonstrate its readiness immediately, without waiting for the readiness of the other party to apologize, and express generosity for reconciliation.

Reconciliation between Albanian and Serbian peoples does not mean an amnesty for crimes of individuals and criminal forces.

We invite all fellow Serbian citizens of Kosovo to return back to their homes and lands in Kosovo, in order to build a neighborly, humane and dignified coexistence. All those who feel afraid, because of a lack of information or because of manipulation from Serbian nationalistic politics, we are ready to

help them in their returning. We commit ourselves that their Albanian neighbors will welcome them and help them to avoid their fears and initial difficulties they may face, even by providing accommodation for them until their homes - destroyed during the war or by any Albanian frustrated by horrors and revenging frustration of war - are rebuilt.
We call on political, governmental and Albanian personalities in Kosovo to give their symbolic example of good will by providing accommodation to Serbian families who wish to return back to Kosovo. Especially to those who are still afraid to come back.
We invite all our good-willed fellow nationals, who wish to support our initiative for reconciliation with the Serbian people, to get involved in transforming this initiative into a broad civic movement for reconciliation between the Serbian people and the Albanian people.
On behalf of the initiators,
Email: ibrahim_kelmendi@yahoo.de
Tel. 044 151959
PS: We kindly ask all good-willed citizens who wish to support our initiative to write to us at the e-mail address above, to phone us or to write to those newspapers that would be kind enough to publish this text.
Sincerely,

Mr.sci.Flori Bruqi

Kosova nga paleoliti deri më sot

Letër e hapur për Akademikët serb!

Republika e Kosoves (shkurt: KS, KOS), është shtet në jugperëndim të Ballkanit dhe kufizohet në veri me Serbinë, në jug me Maqedoninë dhe në perëndim me Republikën e Shqipërisë dhe Malin e Zi.

Paleoliti dhe Neoliti

Trualli i banuar sot nga shqiptarët, ku bën pjesë edhe territori i sotëm i Kosovës, filloi të popullohej shumë herët, që në epokën e paleolitit (koha e vjetër e gurit), mbi 100 000 vjet më parë. Janë të njohura një numër i madh vendbanimesh të tilla në territorin e sotëm të Kosovës, siç janë shpellat e Radacit dhe Karamakazit, si dhe shpella të tjera më të vogla.

Popullimi i territorit të sotëm të Kosovës u rrit shumë në periudhën neolitike. Njerëzit filluan të braktisin shpellat dhe të përqendroheshin në vende të hapura.

Ilirët dhe fisi Dardan

Ilirët, si trashëgimtarë të pellazgëve, janë ndër banorët më të lashtë të Gadishullit Ballkanik. Ata janë autoktonë. Kulturën, gjuhën dhe tiparet antropologjike ilirët i formuan në vendin e tyre, në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, aty ku shkrimtarët antikë i përmendin në veprat e tyre. Trevat e shtrirjes së popullsisë ilire janë mjaftë të gjera.

Dardanët ishin fisi më i madh Ilir që u vu në krye të Mbretërisë Dardane, në Ballkanin qendror, kryesisht në Kosovë. Dy fise të tjera dardane të njohura ishin thunatët dhe galabrët. Qyteti më i rëndësishëm i dardanëve ka qenë Damastioni. Dardanët përmenden si luftëtarë të fortë, xehetarë shumë të mirë, blegtorë dhe tregtarë të njohur.

Mbretëria Dardane

Në shek.IV p.K. u krijua Mbretëria Dardane, e cila shtrihej në territorin e Kosovës së sotme e të krahinave të tjera përreth. Kufijtë e saj shkonin në veri deri t qyteti i Nishit, kurse në jug deri në Kukës dhe në rrjedhën e sipërme të Vardarit.

Mbreti i parë dardan që njohim, është Longari. Pas tij erdhën mbretërit Bato dhe Monun. Rolin kryesor në mbretëri e luajti fisi i dardanëve. Në këtë mbretëri bënin pjesë edhe fise të tjera, ndër të cilat njohin galabrët dhe thunatët. Mbretëria Dardane kishte krijuar një ushtri të fuqishme dhe të organizuar shumë mirë. Veçori e luftëtarëve dardanë ishte se ata hidheshin të gjithë së bashku në sulm dhe po kështu së bashku tërhiqeshin me radhë të shtrënguara, duke mos lënë në sheshin e luftës as të plagosurit e tyre. Forca e kësaj ushtrie u tregua sidomos në shek.III p.K., kur dardanët qenë në gjendje të mbroheshin nga dyndjet e fuqishme të keltëve, të cilët zbritën nga Evropa Qendrore. Madje dardanët treguan gatishmërinë të ndihmonin edhe Maqedoninë, që të përballonte këto sulme.

Në mesin e shek. III p.K., kur sundonte mbreti Longar, ushtritë dardane u përpoqën të shtrinin kufijtë e tyre deri në brigjet e Adriatikut, duke shfrytëzuar faktin që ushtritë ardiane të mbretëreshës Teuta ndodheshin në Epir. Ky operacioni ushtarak fillimisht pati sukses, por me kthimin e ushtrive ardiane nga Epiri, dardanët u detyruan të lëshonin tokat e pushtuara e të ktheheshin në kufijtë e mëparshëm. Pas kësaj Longari i drejtoi ushtritë e tij në jug dhe pushtoi tokat e Mbretërisë Paione, që ndodheshin në veri të kufijve të Maqedonisë.

Rreth vitit 21 p.e.s. luftimet ndërmjet dardanëve dhe maqedonasve morën përmasa të gjera, aq sa mbeti i vrarë në betejë edhe mbreti maqedonas Demetri II. Pas vdekjes së tij, dardanët i shpeshtuan sulmet në Maqedoni, derisa Antigon Dozoni i detyroi të largoheshin nga mbretëria e tij. Kur mbreti maqedonas Filipi V ndodhej në luftë me grekët, në vitin 219 p.e.s., dardanët vërshuan përsëri kundër Maqedonisë. Ushtritë maqedonase u detyruan të ktheheshin në trojet e tyre dhe për të përforcuar kufijtë veriorë pushtuan qytetin më të madh të Paionisë, Bylazorën (Velesi). Në vitin 216 p.K. ushtritë dardane ndërmorën një operacion të fuqishëm ushtarak kundër Maqe-

donisë, duke zënë 20 000 robër. Ata zbritën deri në fushën e Argos, në brigjet e lumit Haliakmon. Kjo fushatë u ndoq nga kundërsulme të reja që bëri Filipi V kundër dardanëve, duke u shkaktuar atyre humbje të rënda në ushtri. Në vitin 200 p.K. mbretërit dardanë Longar e Bato, së bashku me ardianët e mbretër të tjerë, lidhën aleancë me romakët kundër Maqedonisë. Kjo i shtyu dardanët të ndërmerrnin sulme të reja në jug të kufirit të tyre. Dardanët nuk i pushuan luftërat për të çliruar tokat që ndodheshin në jug të mbretërisë së tyre, toka që dikur i përkisnin Mbretërisë Paione dhe që i mbante të pushtuar Maqedoninë.

Luftërat e dardanëve kundër romakëve për shumë vjet me ashpërsi shumë të madhe, në rrethanat kur senati romak synonte të shtrinte pushtimet e tij në të gjitha tokat ilire dhe të arrinte deri në Danub. Edhe pas shqetësimeve që u shkaktoi rifillimi i sulmeve kelte, dardanët i vazhduan inkursionet e tyre kundër Maqedonisë, cila ishte kthyer tashmë në provincë romake.

Dardania u bë pengesë serioze për shumë vjet me radhë për ushtritë pushtuese romake. Megjithëkëtë në vitin 97 p.e.s. romakët arritën të vinin nën varësi të përkohshme dardanët dhe fise të tjera fqinje, të cilat më vonë i ripërtërinë forcat dhe u shkaktuan humbje të rënda romakëve. Pas luftërave të gjata me romakët, nga fundi i shek.I p.e.s. dardanët e humbën pavarësinë e tyre dhe hynë nën varësinë e plotë të Romës.

Kosova pas shkatërrimit të Perandorisë Perëndimore Romake

Shqiptarët e hershëm të mesjetës dolën nga kaosi i shkatërrimit te Perandorisë Perëndimore Romake si pasardhës të fiseve të dardanëve dhe feonëve, që jetuan ne Ilirinë e Sipërme dhe Trakë, deri në kohët e pushtimeve masive të gotëve gjerman, që u zhvilluan në trojet shqiptare gjatë shekullit të katërt të erës sonë. Në fund të shekullit të gjashtë, trako dhe ilirët u ç vendosën nga dyndjet e avarëve, antëve dhe fiseve bullgare turko - ugrike të sllavizuarva. Në mesin e shekullit VII, perandor Herakli i II-të ftoi fiset gjysmë të egra të sorbianëve (serbe) dhe khrobates? (hrvati, kroatët) nga Kiskarpathia, të cilët të udhëhequr nga prijësit e tyre pushtuan territoret e Silezisë së sotme dhe të Polonisë Jugore, vende që ishin braktisur nga vandalët gjermanë dhe ostrogotët. Perandori bizantin i vendosi sllavët edhe në Ballkanin Perëndimor si mbrojtës të Kostandinopojës nga avarët.

Kosova nën sundimin bizantin

Pas ndarjes së Perandorisë Romake në dy pjesë, më 395, trevat iliro-shqiptare hynë në përbërje të Perandorisë Bizantine, siç quhet zakonisht pas kësaj date Perandoria Romake e Lindjes sipas emrit antik të kryeqytetit të saj, Bizant, që për nder të Konstandinit të Madh u quajt Kostandinopojë. Ashtu siç i kishin dhënë Perandorisë Romake një numër perandorësh e gjeneralësh të shquar, po ashtu gjatë periudhës së hershme bizantine (shek. V-IX), trevat iliro-shqiptare i dhanë Perandorisë Bizantine disa perandorë, ndër të cilët shquhen në mënyrë të veçantë Anastasi I nga Durrësi (491-518) dhe Justiniani I nga Taurisium i Shkupit (527-565).

Gjatë sundimit bizantin, filloi edhe përhapja në masë e krishterimit në provincën e Dardanisë. Persekutimet e mëdha kundër të krishterëve regjistruan edhe në provincën dardane martirë të shumtë, kulti i të cilëve u ruajt në shekuj. Nga martirët më të shquar ishin edhe Lauri dhe Flori nga Dardania. Pavarësisht nga përpjekjet për mbytjen e fesë së re, krishterimi u afirmua në Dardani në mënyrë përfundimtare. Pas persekutimeve të mëdha të shek. IV, burimet historike flasin për një strukturë kishtare mjaft të konsoliduar. Në Justiana Prima, qytet dardan, ndodhej kisha metropolitane e Dardanisë, ku ishte i vendosur kryepeshkopi. Peshkopata e Shkupit ishte nën varësinë e Kishës Metropolitane të Shkodrës.

Nën sundimin e Dioklecianit e më tej të Konstandinit, Perandoria Romake iu përshtat një organizimi të ri administrativ. Njësia më e madhe administrative u bë prefektura. Prefektura e Ilirikut (praefectura praetorio per Illyricum), përfshinte dioqezat e Dakisë e të Maqedonisë. Në dioqezën e Maqedonisë, bënin pjesë pronvincat e Prevalit, Dardanisë, Epirit të Vjetër dhe Epirit të Ri, që përfaqësonin hapësirën gjeografike të banuar nga pasardhësit e ilirëve, shqiptarët, përgjatë gjithë mesjetës e deri në kohët e reja. Funksionari më i lartë i prefekturës së Ilirikut, prefekti i pretorit për Ilirikun, e kishte selinë e vet në Selanik.

Afërsisht, në mesin e shek. V Gadishullin Ballkanik e sulmuan hunët të komanduar nga Atila. Brenda pak vjetëve ai pushtoi e grabiti shumë qytete të trevave iliro-shqiptare, në mënyrë të veçantë, Dardanin. Me qëllim që të frenonte zbritjet e "barbarëve" nga kufijtë veriorë, perandori Justinian me origjinë nga Taurisium i Dardanisë, i kushtoi vëmendje ngritjes së një siste-

mi fortifikatash në disa breza, që fillonte nga vija kufitare e Danubit, në veri, dhe zhvillohej valë-valë duke zbritur në drejtim të jugut. Vetëm në atdheun e tij, në Dardani, perandori bizantin meremetoi 61 kështjella dhe ndërtoi nga themelet 8 kështjella të tjera. Një ndër këto kështjella, e quajtur për nder të tij Justiniana Prima (Shkupi), u ngrit në vendlindjen e perandorit, Taurisium.

Ndryshe nga popujt e tjerë, dyndjet e sllavëve në Ballkan u shoqëruan me një dukuri të re, atë të ngulimeve. Në vendet e shkelura prej tyre, sllavët u ngulën duke formuar të ashtuquajturat "Sklavini" (vende të sllavëve). Në fund të shek. VI e fillim të shek. VII, Sklavini të tilla ishin formuar në Maqedoni, Traki, Thesali, Beoti e, në një numër mjaft të madh, në Peloponez. Në fillim të shek.VII, perandor Herakli lejoi vendosjen e dy fiseve të mëdha sllave, të kroatëve dhe të serbëve. Këta të fundit zunë vendet e përshkuara nga lumenjtë Lim e Drina e sipërme bashkë me Pivën e Tarën, luginën e Ibrit dhe rrjedhën e sipërme të Moravës perëndimore. Në jug dhe në perëndim serbet kufizoheshin me diokletë si dhe me trebinjët e zaklumët sllavë. Bërthamën e vendeve ku u vendosën serbet e përbënte krahina e Rashës, në veri të Novi-Pazarit të sotëm. Në jug arrinin deri në burimet e lumit Lim. Gjithsesi, burimet historike të mesjetës së hershme, ndërsa flasin për krijimin e zonave kompakte të sllavizuara (sklavini) në viset fqinje të Dalmacisë, Rashës, Maqedonisë, Peloponezit etj., nuk përmendin ekzistencën e të tillave në katër provincat e Ilirikut Perëndimor.

Që në shek. VII-VIII situata etnike në Ballkan u stabilizua dhe nuk përmenden më dyndje popujsh. Kjo gjendje etnike e shekujve të hershëm të mesjetës, në atë që u konstitua si atdheu mesjetar i shqiptarëve (Albania-Arbëria), mbeti në thelb e pandryshuar edhe në shekujt e mëvonshëm. Karavanet e tregtarëve që në shek. XIII-XV niseshin nga Raguza (Dubrovniku) e nëpërmjet Breskovës e Rudnikut (Sanxhak) mbërrinin në Trepçë e në Novobërdë, kalonin nëpër vende të banuara nga shqiptarë e ku flitej gjuha shqipe (lingua albanesca).

Në vitin 1054, kur u bë ndarja e kishave, trojet shqiptare që përfshinin ish provincën e Dardanisë, në pjesë të madhe kaluan në kuadër të Kishës Katolike. Katolicizmi mbeti feja dominuese për disa shekuj.

Shkëputja nga Bizanti dhe ekspansioni sllav

Derisa ushtria dhe administrata bizantine mbusheshin gjithnjë e më shumë me elementin vendas, u krijuan kushtet per ndarjen nga Bizanti. Por tokat shqiptare të Dardanisë, ishin shumë tërheqëse për shtetin e fuqishëm serb, që u krijua në fillim të shek. XIII. Dardania ra tërësisht nën sundimin serb, në kohën e sundimit të mbretit serb, Stefan Dushanit (1331-1355). Më pas i njëjti fat ishte edhe i të gjitha tokave shqiptare.

Duke filluar nga shek. XIII, mbretërit serbë nga dinastia Nemanja punuan për ta zhvendosur epiqendrën e shtetit të tyre nga Rasha në drejtim të viseve të pasura të Kosovës e të Gentës. Qytetet e këtyre të fundit, Shkodra, Prizreni, Prishtina e Shkupi, u bënë në kohë të ndryshme seli të oborrit serb. Një tjetër qendër e rëndësishme e Kosovës, Peja, prej mesit të shek. XIII u kthye në qendër të kishës autoqefale serbe. Zhvendosja e qendrave të gravitetit të shtetit serb drejt jugut u shoqërua me dukuri të tjera të natyrës shoqërore e etnike, të cilat qenë më të dukshme në Kosovë. Një pjesë e aristokracisë vendase u ç'pronësuar e u zëvendësua nga aristokracia serbe e tokës, laike e sidomos fetare. Duke filluar nga gjysma e dytë e shek. XIII serbizohen kishat e manastiret e Kosovës dhe ndërtohen shumë syresh, të cilat u pajisën me fonde të mëdha tokësore. Në kohën e sundimit të Stefan Dushanit, manastiret, tashmë të serbizuara, të Deçanit, Greçanicës, Banjskës, Kryeëngjëllit, manastiri i Hilandarit në Malin Athos e krahas tyre peshkopatat e Pejës, Prizrenit etj., zotëronin një pjesë të konsiderueshme të fshatrave të Kosovës e të viseve të tjera veriore shqiptare.

Shtrirja e shtetit serb në drejtim të Kosovës u shoqërua edhe me ardhjen këtu të kolonëve të rinj nga territoret e Serbisë së mirëfilltë (Rashës). Të porsaardhurit populluan fshatrat e braktisura (selishtë) ose u vendosën në pronat e përvetësuara rishtazi nga feudalët apo kishat e manastiret serbe. Krahas kolonizimit, mbretërit serbë, e në veçanti car Stefan Dushani, zbatuan një politikë që synonte asimilimin e popullsive shqiptare të viseve të pushtuara. Si më të efektshme në këtë drejtim u zgjodhën represioni dhe persekutimet në lëmin fetar. Kapituj të tërë të kodit të Stefan Dushanit dhe urdhëresa të veçanta të carit serb parashikonin masa të rrepta, si sekuestrim të pasurisë, damkosje, dëbim e deri dënim me vdekje për të krishterët katolikë e ortodoksë, që nuk pranonin të konvertoheshin në ortodoksinë serbe e nuk ripagëzoheshin duke marrë emra sllavë. Masa të tilla goditnin në radhë të parë popullsitë shqiptare

të besimit katolik. Ato përcaktuan përhapjen e fenomenit të sllavizimit fetar-onomastik në shtresa të caktuara të popullsisë shqiptare. Kjo është arsyeja që midis shek. XIII-XIV, krahas shqiptarëve gjithsesi të shumtë, që mbanin emra, si Gjin, Dedë, Gjon, Progon, Llesh, gjenden në këto treva edhe shqiptarë të tjerë, të cilësuar nga vetë dokumentacioni si të tillë, që mbanin emra sllavë ose që i ishin përshtatur onomastikës sllave. Emra, si Pribisllav, Radomir, Vladislav apo mbiemrat Vogliç, Kuqeviç, Flokovci, Gjinovci etj., dëshmojnë se në këtë kohë (gjysma e parë e shek. XIV) një pjesë e popullsisë shqiptare të trevave veriore, nën presionin e dhunshëm të pushtuesve serbë, gjendej në një fazë kalimtare të një asimilimi kulturor e fetar. Në mjaft treva ky proces asimilimi u ndërpre në kushtet e reja që u krijuan me shkatërrimin e shtetit serb e mbërritjen e turqve osmanë (gjysma e dytë e shek. XIV). Pikërisht në këtë kohë vihet re aty një kthim i popullsisë në onomastikën karakteristike shqiptare. Megjithatë, në një pjesë të territoreve në fjalë, sidomos në zona të veçanta të Gentës (Zetës), procesi i sllavizimit vazhdoi edhe paskëtaj duke çuar gradualisht në asimilimin kulturor dhe etnik të bashkësive të tjera shqiptare.

Pushtimi serb i Stefan Dushanit, i ngarkuar me pasoja të rënda ekonomike, shoqërore e etnike, ndeshi në qëndresën e ashpër të popullsisë shqiptare. Që në vitin e parë të sundimit të Stefan Dushanit, në trevat veriperëndimore shpërtheu një kryengritje antiserbe, në krye të së cilës u vu bujari Dhimitër Suma (1332). Zgjerimi i saj e nxiti kryepeshkopin e Tivarit, Guljelmin e Adës, të projektonte organizimin e një kryqëzate të Perëndimit kundër serbëve, e cila do të mbështetej në kontributin vendimtar të kryengritësve shqiptarë të zonave të veriut. Në këtë mënyrë që nga Genta e Kosova deri poshtë në Epir lindën ose u ringjallën formacione politike të dyerve më të shquara shqiptare, Balshët, Gropajt, Topiajt, Matrëngët, Muzakët, Zenebishët, Bua-Shpatat etj.

Kosova në prag të pushtimit Osman

Familja Balshaj ishte me origjinë nga qyteza e Balëz, në afërsi të qytetit të Shkodrës. Edhe kjo familje ka qenë e shpronësuar dhe keqtrajtuar gjatë sundimit sllav. Gjithsesi, pas mesit të shek. XIV, tre vëllezërit Balsha, Strazimiri, Gjergji I dhe Balsha II, e vunë këtë familje në ballë të politikës dhe të proceseve shtetformuese shqiptare, duke shfrytëzuar edhe momentin e përshtatshëm që pasoi vdekjen e car Stefan Dushanit. Me shthurjen e Perandorisë së tij, vëllezërit Balshaj iu vunë punës për ta kthyer Gentën (Zetën), ashtu si Dioklenë e dikurshme, në një shtet të pavarur nga mbretëria serbe. Balshajt

morrën nën kontrollin e tyre territorin e Kosovës së sotme dhe shtrin sundimin e tyre deri në Vlorë. Rreth vitit 1375, vëllezërit Balsha për herë të parë kishin bashkuar në një zotërim të vetëm pjesën më të madhe të trojeve shqiptare. Në vitin 1385, pas një depërtimi të ushtrisë osmane në krye me Hajredin Pashën, territori i Kosovës, në pjesën më të madhe, ra në dorë të princërve sllavë, vasalë të sulltanit.

Ndërsa shteti i Balshajve rrudhej, dinastitë tjera shqiptare shtrin sundimin e tyre në territorin e Kosovës. Më të njohurat nga këto dinasti ishin dinastia e Dukagjinëve, Spanëve dhe Kastriotëve.

Pushtimi i Kosovës nga Perandoria Osmane 1385 - 1479

Fillimi i pushtimit osman në Kosovë

Sulmet e ushtrive osmane për pushtimin e viseve shqiptare nisën në mesin e viteve 80 të shek. XIV. Të udhëhequra nga bejlerbeu i Rumelisë, Timurtash Pasha, në vitin 1385 ushtritë osmane, u futën në Shqipëri dhe pushtuan qytetet e Shtipit, të Prilepit, të Manastirit dhe të Kosturit. Në vitin 1386 osmanët pushtuan Nishin. Knjazi serb i Rashës, Llazari Hrebelanoviçi mori nismën dhe ftoi sundimtarët e tjerë ballkanas që të bashkonin forcat e tyre për të ndalur marshimin osman. Thirrjes së tij iu përgjigjën disa prej sundimtarëve shqiptarë, si Gjergji II Balsha, sundimtar i Shkodrës, Teodor II Muzaka, zot i Beratit dhe i Myzeqesë, Dhimitër Jonima, zot i trevave përgjatë rrugës tregtare Lezhë-Prizren, Andrea Gropa, zot i Ohrit dhe i rajoneve rreth tij, sundimtarë të Shqipërisë së Poshtme etj. Me ta u bashkuan edhe sundimtarë të tjerë ballkanas si dhe sundimtari i Kosovës Vuk Mlladenoviqi, që zakonisht njihet me mbiemrin Brankoviçi (Vuk Brankoviçi). Zotërimet familjare i kishte në pjesën veriore të Drenicës dhe të Fushë-Dardanisë. Trupat shqiptare kishin një peshë të rëndësishme në forcat e koalicionit ballkanik. Kronikat osmane, që përshkruajnë këtë ngjarje, theksojnë numrin e madh të ushtrisë së Gjergjit II Balsha dhe e cilësojnë atë si njërin prej tre sundimtarëve kryesorë të koalicionit antiosman, krahas knjazit Lazar dhe vojvodës Vllatko Vukoviqit, komandant i ushtrisë së mbretit Tvërtko I të Bosnjës.

Në qershor të vitit 1389 ushtritë e koalicionit ballkanik u bashkuan në Fushë-Dardani (Fushë-Kosovë). Në çastin e fillimit të betejës, V. Brankoviçi i largoi trupat e veta nga koalicioni. Më 15 qershor ballkanasit zhvilluan një betejë të

përgjakshme me forcat osmane të komanduara nga sulltan Murati I. Pas disa sukseseve të para të ushtrive të koalicionit, fitorja në këtë betejë anoi përfundimisht nga osmanët, por me humbje njerëzore të mëdha nga të dyja palët. Gjatë zhvillimit të betejës vritet sulltan Muratin I. Beteja e Fushë-Dardanisë la mbresa të fuqishme te shqiptarët e Kosovës, të cilët i përjetësuan ato në këngë popullore.

Disfata e koalicionit ballkanik në betejën e Fushë-Dardanisë të vitit 1389 pati rrjedhime të rënda për popujt e Gadishullit të Ballkanit. Pushtuesit osmanë e kthyen në vasal të tyre sundimtarin e Kosovës, Vukë Brankoviçin, të cilin, në fillim të vitit 1392, e detyruan t'u dorëzonte Shkupin, e më pas Zveçanin (kështjellë pranë Mitrovicës) etj.

Fillet e përhapjes së Islamit

Në kushtet e mungesës së një kishe kombëtare shqiptare, që do të ndikonte shumë në ruajtjen e unitetit fetar te shqiptarët, një pjesë e konsiderueshme e fisnikërisë dhe e shtresave të tjera, që jetonin në Shkup, Manastir dhe në qytete të tjera të Kosovës, filluan të përqafonin masivisht Islamin. Konvertimi në Islam i shqiptarëve i shkëputi shumë prej tyre nga ndikimi i kishave ortodokse sllave e greke (që liturgjinë e mbanin në gjuhën sllave dhe greke), duke ndërprerë kështu vrullin e procesit shekullor të sllavizimit e të greqizimit të shqiptarëve. Gjithashtu islamizimi u dha mundësi shqiptarëve që të integroheshin në jetën e Perandorisë Osmane dhe të ruanin, deri në një farë mase, pozitat e tyre ekonomike e politike.

Rezistenca ndaj pushtimit osman

Derisa pushtuesi osman shtrihej në tokat shqiptare, një pjesë e fisnikërisë, arriti të ruante zotërimet duke u shndërruar në vasalë të Sulltanit. Megjithatë, në vitin 1443, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu (i biri i Gjon Kastriotit), i ndihmuar nga vëllai i madh Stanisha, mori kështjellën e Krujës dhe me këtë e filloi kryengritjen e përgjithshme, e cila rezultoi më vonë në krijimin e shtetit shqiptar. Skënderbeu, morri nën kontroll edhe rajonin malor në jug të Shkupit dhe me këtë edhe rrugën Shkup - Kërçovë.

As fisnikët e tjerë nuk qëndruan duarkryq. Familja Spani mori kështjellën e Pazarit të Ri dhe atë të Zveçanit, ndërsa Dukagjinët e morën Pejën. Stefan

Gjurashi, u zgjerua dhe vendosi qendrën e tij në Zhabiak. Për një kohë të shkurtër fisnikët shqiptar morën nën sundim Rrafshin e Dukagjinit, Drenicën, krahinat e Plavës e të Gucisë, të Jeliçës (Sanxhakut), të Gentës (Zeta) e të tjerë. Kulmi i këtyre përpjekjeve ishte Besëlidhja Shqiptare e Lezhës me 2 mars 1444, që bashkoi fisnikët nën drejtimin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Aty morën pjesë, përveç Kastriotëve edhe familjet e mëdha si: Arianitët, Topiajt, Balshajt, Dukagjinët, Spanët, Zahariasit, Muzakajt, Gropajt, Dushmanët, Gjurashët (Cërnojeviqët) etj.

Në vitin 1479, dhjetë vite pas vdekjes së Skënderbeut, të gjitha trojet shqiptare, ranë nën sundimin osman.

Kosova nën Perandorinë Osmane shek.XV - shek.XVIII

Vendosja e sistemit të timarit dhe çifligjeve

Zgjerimi i Perandorisë Osmane, bëri të nevojshëm ndryshimin e organizimit të saj shtetëror. Në përfundim të këtij riorganizimi, territoret e gjithë perandorisë u ndanë në 32 ejalete, që ishin njësi më të vogla administrative. Krahinat e Gadishullit Ballkanik u përfshinë në tri ejalete: ejaleti i Bosnjës në veri të gadishullit, ejaleti i Rumelisë në qendër dhe ejaleti i Detit në ishujt e detit Egje dhe në një pjesë të bregdetit jugor. Çdo ejalet u nda në një numër sanxhakësh. Territoret e Shqipërisë bënin pjesë në ejaletin e Rumelisë. Ato u ndanë në disa sanxhakë. Numri, shtrirja dhe emërtimi i tyre ka ndryshuar herë pas here. Sanxhakut të Shkodrës, të cilit më 1499 i ishin shtuar krahina të Malit të Zi dhe në fillim të shek. XVI edhe krahina të Rrafshit të Dukagjinit, iu shkëput krahina e Gjakovës, që i kaloi sanxhakut të Dukagjinit; sanxhakut të Vlorës iu shkëputën krahinat e Delvinës dhe të Çamërisë, me të cilat u krijua sanxhaku i Delvinës. Sanxhakët e Elbasanit, të Ohrit, të Dukagjinit, të Prizrenit, të Vuçiternës, të Shkupit dhe të Janinës mbetën siç ishin më parë. Çdo sanxhak ishte një unitet administrativ e ushtarak që përfshinte timaret, ziametet dhe forcat e tyre ushtarake përkatëse.

Kosova, gjatë kësaj periudhe, njohu një zhvillim të madh ekonomik. Klasa kryesore sunduese, ishte klasa ushtarake, për të cilën punonte klasa punëtore që quhej raja. Nga gjysma e dytë e shek. XVIII, krahas bejlerëve si pronarë çifligjesh dalin tregtarë, veçanërisht në qytetin e Shkodrës. Në fund të shek.

XVIII u dalluan familje të mëdha çifligare, si: Begollajt në Pejë, Rrotullarët në Prizren, e të tjerë. Në shek. XVII-XVIII edhe pronat e institucioneve fetare myslimane e të krishtera morën formën e çifligjeve. Ato u zgjeruan në radhë të parë nga dhurimet e shtetit dhe të besimtarëve.

Rezistenca ndaj pushtimit osman - pushtimi i përkohshëm austriak

Kryengritjet e shumta të organizuara në trojet shqiptare, gjetën deri diku solidarizim edhe në trojet shqiptare të Kosovës. Gjatë viteve 1670-1680, banorët e sanxhaqeve të Prizrenit dhe Dukagjinit, u solidarizuan me sanxhaqet e tjera shqiptare, në mosmbledhjen e taksave të shtetit osman.

Një pjesë e banorëve, përkrahu edhe ushtrinë austriake e cila filloi pushtimin e trojeve shqiptare, duke e mposhtur ushtrinë osmane. Angazhimi i shqiptarëve në anën e austriakëve u bë më i dukshëm në pranverën e vitit 1689, kur konti Ludvig Badeni, komandant i frontit austriak vendosi të pushtonte Nishin dhe nëpërmjet Prokupjes të kalonte në Kosovë. Nëpërmjet Prizrenit dhe Kukësit, ai desh të dilte në Shkodër e në detin Adriatik për të ndarë Bosnjën e Hercegovinën nga Porta e Lartë. Me një thirrje të veçantë konti i Badenit ftoi popujt e Ballkanit për t'u bashkuar me ushtrinë e tij. Kur forcat ushtarake hynë në tokat ballkanike, në to u përfshinë serbë, bullgarë, grekë e shqiptarë. Në afërsi të Nishit u zhvillua një betejë e ashpër (24 shtator 1689), e cila përfundoi me fitoren e austriakëve.

Pas kësaj fitoreje një pjesë e ushtrisë austriake në krye me gjeneral Pikolominin u nis për në Kosovë, ku u prit nga shqiptarët. Kur Pikolomini hyri në Prishtinë, shqiptarët e Kosovës deklaruan se ishin me perandorin. Pikolomini të njëjtën situatë ndeshi edhe në Prizren. Banorët e qytetit i dolën përpara dhe e pritën me nderime. Rreth 5 000 shqiptarë me kryepeshkopin e tyre, Pjetër Bogdanin, e përshëndetën me breshëri të shtënash. Burimet austriake, angleze e papale pohojnë se pranë Pikolominit ishin mbi 20 000 shqiptarë. Sipas një përllogaritjeje 5 000 veta ishin nga Prishtina, 3 000 veta nga Peja, 6 000 nga Klina dhe Drenica, 6 000-8 000 veta nga Prizreni.

Shqiptarë të tjerë të palidhur me ushtrinë austriake vazhdonin kryengritjen. Kur forcat austriake hynë në Prizren, 3 000 kryengritës shqiptarë morën Pejën. Sapo gjenerali Pikolomini kaloi në Shkup (25 tetor 1689), shqiptarët shprehën gatishmërinë për të hyrë nën mbrojtjen e austriakëve. Një grup kryengritës u

nis drejt Tetovës për të pastruar krahinën nga forcat osmane, që ndeshën në rezistencë në Kaçanik. Ndërkohë forca tatare nga Krimea hynë në Prishtinë, por u thyen nga shqiptarët e Prishtinës.

Sipas burimeve osmane me austriakët ishin bashkuar: Peja, Prizreni, Tetova, Shtipi, Prishtina, Vuçiterna, Kosova (Belasica), Jenipazari (Pazari i Ri), Mitrovica, Shkupi, Çiçaku, Plevla, Jagodina, Kumanova etj. Pas vdekjes së gjeneral Pikolominit (nëntor 1689), shqiptarët nuk u trajtuan si duhet nga austriakët dhe u larguan nga ushtria austriake. Si pasojë osmanët rikthyen sundimin në tokat e Kosovës. Në fillim ra Prishtina, më vonë Prizreni, Peja.Me ushtrinë austriake u larguan nga Kosova shumë kryengritës, besnikë të Austrisë. Dokumentet e komandës së lartë ushtarake tregojnë se nga forcat që u vunë përkrah forcave austriake, dy grupe ishin më kryesorët: shqiptarët dhe "serbët", por faktor dominues ishin shqiptarët. Në këtë rast kryengritësit e Kosovës, që u bashkuan me austriakët dhe që u shpërngulën më pas, ishin thuajse të gjithë shqiptarë.

Përhapja e fesë Islame

Fisnikëria shqiptare, ishte e para që provoi dukurinë e kalimit në Islam. Pasi e pranonin vasalitetin osman, bijtë e tyre islamizoheshin, pasi që të njëjtit edukoheshin pranë oborrit të sulltanit në Stamboll. Sipas regjistrimit të viteve 1431-1432, Sanxhaku Shqiptar kishte 335 timare, nga të cilat 279 udhëhiqeshin nga myslimanë. Depërtimi në shkallë të gjerë i fesë islame në radhët e popullit shqiptar gjeti shprehje pikësëpari në qytete. Por, që nga vitet 80 të shek. XV, feja e re ka nisur të "zbresë" nga parësia e islamizuar në masën e popullsisë qytetare të krishterë, për të vazhduar më pas edhe në fshatra. Me 1468, tetova kishte 41 shtëpi myslimane (15%). Në vitin 1485, Peja kishte 23 shtëpi myslimane. Me 1487, Vuçiterna kishte 33 shtëpi myslimane (31%), Prishtina 51 shtëpi myslimane (17%).
Procesi i islamizimit gjatë shek. XVI ishte në ngjitje të pandërprerë. Feja e re kishte shënuar sukses të madh në qytete të rëndësishme: Peja (90%), Vuçiterna (80%), Tetova (71%), Kërçova (65,5%), Prishtina (me nga 60%), Prizreni (55,9%), Novobërda (37%), Trepça (me nga 21%), Janieva (14%). Nga shqyrtimi i ritmeve të procesit të islamizimit të popullsisë qytetare shqiptare gjatë shek. XV-XVI, del se dinamika e këtij procesi paraqitej veçanërisht e shpejtë në qytetet e Kosovës. Një gjë e tillë shpjegohet, midis të tjerash, me rrethanat

politike të veçanta që ekzistonin në Kosovë në momentet e vendosjes së sundimit osman. Popullsia shqiptare e Kosovës ndodhej kësaj kohe nën sundimin politik të shtetit serb, ndërsa pushtetin fetar këtu e ushtronte kryesisht Patrikana Serbe e Pejës. Për rrjedhojë, likuidimi i sundimit serb dhe dobësimi i pozitave të kishës serbe me vendosjen e sundimit osman, u dha rast banorëve të krahinës që t'i shpëtonin ndikimit të kishës së lartpërmendur, duke përqafuar fenë islame si një nga mjetet e shprehjes së dallimit të tyre etnik nga serbët.
Në trojet shqiptare në fundin e shek. XVI përqindja e islamizimit të qyteteve kapte shifrën 49%, ndërsa ajo e fshatrave arrinte vetëm në rreth 17%. Duke filluar nga shek. XVII, burimet historike flasin për braktisje masive të fesë së krishterë dhe përqafimit të Islamit edhe nga popullsia fshatare.

Kosova pas ndarjes nga Shqipëria

Me krijimin e mbretërisë Serbe teritori i Dardanisë nga kleri i ritit lindor quhej Serbia e Re dhe me rritjen e ndikimit të klerit sllav në Ballkan dhe krijimit të mitit të Kosovës, pjesa më e madhe e ish-vilajetit të Kosovës fillon të quhet Serbia e Vjetër e më vonë Kosovo i Metohia ndërsa territori i Dardanisë ndahet në tri njësi "Banovina" të Mbretërisë Jugosllave dhe një pjesë në Shqipëri. Gjatë luftërave Ballkanike dhe botërore bëhen luhatje të shumta të kufijve dhe emërtimeve dhe nga to pjesa më e madhe e ish vilajetit të Kosovës hynë në një federatë laike Serbe si njësi konstituive e Federatës Jugosllave. Pas kthimit të klerit në fuqi në federatën serbe dhe shkatërrimit të Federatës Jugosllave, Kosova okupohet nga kleri dhe qeveria e Milosheviqit të cilët në ish-Pashallëkun e Beogradit kishin instaluar një sistem shtetërorë dual (dyfishë: nacional dhe ortodoks mesjetar) nga ku koordinonin veprimet në territorin e ish- Federatës Jugosllave.
Pas ndërrimeve kushtetuese të dhunshme në Kuvendin e Kosovës me 28 mars 1989, të organizuar nga Lidhja Komuniste e Serbisë në krye me Milosheviqi dhe të përkrahura nga kleri ortodoks, Kosova mbetet nën juridiksionin e Republikës së Serbisë, si krahinë e saj, ndërsa me 2 korrik 1990, Kuvendi i Kosovës shpall Kosovën, republikë në kuadër të Federatës Jugosllave. Ky vendim nuk u njoh nga organet serbe e as ato federative.
Në vitet 1992-1993, Lëvizja Popullore e Kosovës në mërgim, vendos krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila mori aksione guerile kundër makinerisë pushtuese serbe derisa doli publikisht me 28 nëntor 1997. Më 28 shkurt 1998,

pas masakrave në Likoshan dhe Qirez filloi lufta çlirimtare. Ajo përfundoi në qershor të vitit 1999, kur edhe instalohet një mision i OKB-së në Kosovë.

Ky mision, keqëtrajtoi në mënyra perfide ish luftëtarët e UÇK-së, lejoi krijimin e strukturave paralele serbe në Kosovë dhe ngul fati Kosovën ekonomikisht. Kështu më 17 mars 2004, shpërtheu revolta popullore kundër UNMIK-ut, dhe protestuesit i sulmuan disa enklava serbe, duke i dhënë një mesazh të qartë faktorëve ndërkombëtar se: Nëse nuk zgjidhet statusi i shumicës, pakica në Kosovë është e pambrojtur.

Pasi që ky mesazh u kuptua shumë qartë, pasoi vizita e misionarit dhe diplomatit të njohur Kai Aide, i cili rekomandoi fillimin e përgatitjeve të menjëhershme për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Kjo rezultoi me një proces të lodhshëm negociator, mes Serbisë, Kosovës dhe OKB-së, që rezultoi me propozimin gjithëpërfshirës të Ahtisarit.

Më 17 shkurt 2008, bazuar në këtë propozim, Kosova shpallet shtet i pavarur dhe sovran. Kushtetuta e Kosovës që i jep asaj të gjitha kompetencat e shtetit, hyn në fuqi me 15 qershor 2008.

Pas shpalljes së pavarësisë qëndrimi i shteteve anëtare të OKB-së është i ndarë. Shumica e shteteve të ritit lindor me sisteme duale nacionalo-fetare si Serbia, disa shtete nacionale që kanë popullsi të kombeve etnike të ndryshme dhe probleme tjera të brendshme, hezitojnë të njohin pavarësinë e Kosovës.

Lufta politike e koordinuar për pengimin e njohjes së shtetit të ri prej së jashtmi zhvillohet nga Serbia dhe Rusia, ndërsa nga brenda këtë e bënë kleri sllav i përqendruar në veri të Kosovës.

Lufta e Kosovës

Lufta e Kosovës filloi me 28 shkurt të vitit 1998, pas sulmit jugosllav në fshatërat Likoshan dhe Qirez në Drenicë të Kosovës.

maqedonas Trajkovski në Maqedoni, për presidentin Borivoje Tadiç në Serbi dhe për presidentin Stipe Mesiç në Kroaci. Fitorja e republikanëve në zgjedhjet e fundit në SHBA, kontrolli nga kjo parti e Shtëpisë së Bardhë dhe e Kongresit, janë disa nga rezultatet e kësaj kompanie. "BG&R" është njëra ndër tri agjencitë kryesore, që merret me lobim në SHBA. Më parë është spekuluar se ish-kryeministri i Serbisë, Zoran Zhivkoviq, kishte angazhuar "BG&R" për mbrojtjen e interesave serbe, madje është thënë se dhe radikalët serbë, gjatë fushatës presidenciale të vitit 2004, e kishin angazhuar "BG&R", por zyrtarët e kësaj agjencie kanë përgënjeshtruar gjithmonë. 3. Ndërkohë, Kosova vazhdon të besojë në të drejtën e saj ndërkombëtare për vetëvendosje dhe se Kosovës nuk iu dashka lobimi as në Amerikë! Rolin e lobuesit e mori zv/kryeministri Lutfi Haziri, i cili u kthye entuziast nga SBA-të. Nga kjo vizitë Lutfi Haziri mori mesazhe se Kosova do të jetë e pavarur dhe nuk do të ketë ndarje territoriale. Si duket Kosovës i mjafton kjo vizitë dhe vizita të ngjashme, që politikanët e saj të flenë të qetë. Vlera e 60.000 dollarëve të Serbisë nuk është e vogël, por për ta arritur rezultatin e duhur për Serbinë është minimale. Duke i pasur parasysh rezultatet lobuese të "BG&R mbase do të duhej që edhe Kosova të kursente pak më shumë nga luksi politik dhe ta angazhonte ndonjë agjenci lobuese për ta ndryshuar qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare, i cili tashmë dihet, por për ta përshpejtuar procesin e tej zgjatur të përcaktimit të statusit të Kosovës, i cili duket se është futur në një rrugë pa krye dhe pa rezultat të kënaqshëm për Kosovën. Është indikative se lobime shumë të rëndësishme për pavarsinë e Kosovës më shumë janë duke bërë forumet virtuale në internet si fjala vjen : http://alb-net.com forumi Art Café http://floart-press.blogspot.com http://flori-press.blogspot.com http://shqip.dk http://floart.nlogspot.com http://www.frosina.org http://rugova.net http://kumanova.li http://www.savekosova .org http://www.tokashqiptare.com http://kosovapress.com Pra këto forume virtuale pa asnjë lek kanë bërë sensibilizimin (lobimin) e opinionit ndërkombëtarë më shumë se sa disa anëtarë të Qeverisë së Kosovës,që po sorollatëm me meditje marramendse të dhëna nga MEF-i I Kosovës në metropolet ndërkombëtare :Vienë,New York,Washington ,Londër ,Paris dhe Tiranë…
www.shqip.dk

Dy evangjelistë amerikanë i kanë bashkuar forcat me kishën serbe kundër pavarësisë

Dy evangjelistë amerikanë janë kyçur në fushatën e tyre në SHBA që Kosova të mbetet brenda kufijve të Serbisë. ...

Siç shkruan gazeta britanike "Fajnenshëll tajms" (Financial Times) Xheri Folvel dhe Pat Robertson, televangjelistë me ndikim, i kanë bashkuar forcat me Kishën Ortodokse serbe në fushatën kundër pavarësisë së Kosovës. Peshkopi serb i Kosovës Artemie i ka thënë gazetës në fjalë se dy meshtarët televizivë i kanë premtuar se për realizimin e këtij qëllimi, do të alarmojnë ithtarët e tyre dhe do të shfrytëzojnë ndikimin që kanë. Ata i kanë thënë Artemisë se kanë miq në nivelin më të lartë të pushtetit dhe do t'u bëjnë thirrje atyre që të ndihmojnë që Kosova të mbetet brenda kufijve të Serbisë. Sipas gazetës "Fajnenshëll tajms", diplomatët në Uashington kanë vërejtur se ndezja e zjarrit të krishterë në SHBA është reflektim dhe shprehje e diskutimeve jotolerante e helmuese në Kosovë të cilat herë pas herë shndërrohen në dhunë. Vetë Peshkopi Artemie i ka thënë gazetës se "pavarësia e Kosovës do të krijonte bazën për xhihadin esktrem islamik dhe do të rrezikonte Ballkanin, Evropën dhe SHBA-të". Në cilësimet e tij esktreme Artemie shkon edhe më larg, duke thënë se ithtarët e lëvizjes vehabiste dhe të Al Kaidës kanë mbërritur në Kosovë, e cila sipas tij, është "vrimë e zezë" e Evropës, në të cilën sundojnë "bandat kriminale të trafikantëve të drogës, të qenieve njerëzore dhe të armëve", ndërsa "vrasësit dhe përdhosësit e kishave dhe të varrezave përpiqen të çrrënjosin bashkësinë e krishterë në Kosovë". Pas këtij fjalori të padëgjuar kundër Kosovës të një prifti serb, tani mbetet të shihet nëse Artemie do të thërrasë në luftë kryqëzatash kundër shqiptarëve dhe Kosovës.
Burimi:http://www.shqip.dk/modules.php?name=Neës&file=article&sid=1445

(Ri)Kolonizimi i Kosovës nga Serbia

Në hartën e publikuar vitit e kaluar nga Lëvizja Vetevendosja , me rrathë të zinj që kanë nga një X në mes janë paraqitur zonat e banimit kolektiv në kuadër të kthimit të organizuar masiv të serbëve sipas planit të Qendrës Koordinuese të Serbisë për Kosovën...

Me ngjyrë të verdhë janë shenjuar vendbanimet ku përkrahet kthimi individual ndërsa me ngjyrë të kuqe ato për kthim të organizuar e masiv të serbëve në Kosovë. Vërehet se një zonë e banimit kolektiv është paraparë në afërsi të Graçanicës. Dihet që serbët nuk e kanë lëshuar Graçanicën as pas mbarimit të luftimeve. Atëherë, kush po kthehet aty?! Në emër të 'kthimit të qëndrueshëm' po bëhet rikolonizimi i Kosovës meqë serbëve po u pranohet e drejta që të kthehen ku të duan, pra jo vetëm te prona e tyre. Në rastin e ndërtimit të banesave kolektive për kolonët e rinj serbë në Graçanicë, qëllimin e Serbisë po e realizon Kuvendi Komunal i Prishtinës me në krye me presidentin komunal ,juristin Ismet Beqiri. Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datën 21 shkurt të vitit 2006, ka përcaktuar lokacionin prej përafërsisht 54 ari, për ndërtimin e katër objekteve të tërësisë së përbashkët në qytetzen buze Prishtines me emrin Graçanicë. Kjo është bërë duke u thirrur në në nenin 3.1b) të Rregullores 2000/45 që ka të bëjë me planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës. Pra, rregullorja për vetëqeverisjen e komunave përveç për decentralizim është treguar e përdorshme edhe për rikolonizimin(Tigrizimi n & Leopardizimin me enklava serbe) t e Kosovës. Në vijim është paraqitur vendimi kolaboracionist i Kuvendit Komunal të Prishtinës lidhur me këtë. Kliko këtu për të parë vendimin. Shqiptaret (Kosoavret)nuk jane kunder minoriteteve(sebeve,turqve,kroateve,romeve etj)po ata jane decidivisht kunder Leopradizimit-Tigrizimit te Kosoves ne enklava. Nje gje e tille do te lene shume pasoja ne Harten tigrizuese te Kosoves,kurse fajtoret jane te binjakizuar (lëxoni ndërkombëtarët dhe ELEFANTET Kosovarë) ! Deputeti I Parlamentit të Kosovës Nait Hasani,kohë më pare kundërshtojë nenin 7.18 te Ligjit per trashegimi kulturore,I cili pritët të miratohët këto ditë në Seancë e ardhshme të Parlamentit të Kosovës. Neni në fjalë (7.18) thotë: Nuk lejohet asnje intervenim ne toke brenda zones mbrojtese ne kuptimin e aktivitetit bujqesor duke perdore parmende (plugun) ose ndonje mjet tjeter qe mund te demtoj ate hapesire pa nje leje te shkruar nga Institucioni Kompetent. Sipas deputetit Nait Hasani Ky nen shkel te drejtat e njeriut mbi pronen private

etj. Një nen i tillë është skandalozë .Fjala vjen çfarë do të bejnë fshatarët e Komunës së Deçanit ,kur mbi 800 apo 900 hektare toke punuese ,male etj. Afer Manastirit të Deçanit nuk mund ti punojnë tokat e tyre pronarët legjitimë pa një leje te vecante .Në Kosovë thotë ai Elefantët kanë" miratuar" qe mbi 40 objekte te vecanta në Kosovë të kenë një mbrojte të vecantë të trashëgimisë kulturore. Rrezikshmeria per nje lufte te re mes shqiptareve dhe serbeve eshte e mundshme per shkak te ketij tigrizimi ,po i paraprin edhe ardhja e rreth 1000 policeve të MUP-it Serb në Kosovë … Një gjë e tillë është shumë e rrezikshme që situate të dal jashtë kontrollit ,prandaj per nje gje te tille do te ishte e udhes qe Grupi i Kontaktit, OKB-ja dhe konkretisht NATO te jene syqele dhe shume te matur ne keto sprova te reja te dala nga Kushtetuta e re e (neo)komunisteve,radikaleve(lexo çetnikeve) dhe demokrateve serb !
Burimi:http://www.shqip.dk/modules.php?name=Neës&file=article&sid=1426

Nuk e durojnë filmin për luftën e Kosovës

Mediat serbe e kanë cilësuar si pamflet filmin e regjisorit Sunaj Raça. Ndërsa regjisori thotë se e ka paraqitur një realitet dhe se serbët janë ata që shpesh kanë bërë pamflete kundër shqiptarëve ...

Filmi "Etjet e Kosovës" i regjisorit Sunaj Raça është kritikuar ashpër në mediat serbe, pas prezantimit në panairin e Festivalit Ndërkombëtar të Filmit në Kanë, "Cannes Market". Nga mediat serbë, rrëfimi për luftën dhe pasojat e saj në Kosovë është cilësuar si pamflet dhe, gjithashtu, ata e kanë minimizuar interesimin që të huajt kishin për filmin. Më "meritorja" për këtë ishte gazetarja Ana Otasheviq e agjencisë së lajmeve "Tanjug", nga e cila u "furnizuan" disa gazeta. Sipas Otasheviqit, qëllimi i "Etjeve të Kosovës" (filmi i parë i Kosovës, siç e quan ajo) ka qenë i qartë. "Që publikut perëndimor t'ia dëshmojë pse shqiptarët në Kosovë kanë të drejtë t'i dëbojnë edhe ata pak serbë që kanë mbetur atje të jetojnë", citon gazetaren serbe e përditshmja "Glas Javnosti". Regjisori Sunaj Raça, shkrimet e gazetave serbe i quan të qëllimshme. Sipas tij, shfaqja e filmit kosovar në tregun më të madh evropian të filmit në Kanë është pritur mirë dhe ka zgjuar interesim te shumë gazetarë dhe producentë

të huaj. "Duke dashur të minimizojë interesimin për filmin, gazetarja serbe flet gënjeshtra. Nuk është e vërtetë se filmi është parë vetëm nga pesë veta, pasi që vetëm stafi ynë, i kompanisë 'Lara' nga Gjermania, kishte 12 veta", tha Raça për "Lajm". Sipas tij, me shfaqjen në festivalin e Kanës, filmit i janë hapur dyert edhe për shumë festivale të tjera. "Etjet e Kosovës" është shfaqur në dy termine - në orën 10 ishin 50 shikues, kurse në orën 14 - 84 shikues. "Është e logjikshme që një gazetar serb të shkruajë kështu për një film kosovar, duke mos dashur të merret me anën profesionale të filmit. Megjithatë, janë serbët që për një kohë të gjatë në kinematografinë e tyre kanë bërë pamflete edhe kundër shqiptarëve". Pas shfaqjes në Kanë, "Etjet e Kosovës" pritet të marrë pjesë në disa festivale të tjera ndërkombëtare. Regjisori Raça shpreson që filmin ta shfaqë edhe në festivalin e Sarajevës. "Etjet e Kosovës" tregon fatin e një nëne kosovare, e cila kërkon dy fëmijët e saj të rrëmbyer nga forcat serbe, teksa si refugjatë po iknin nga Kosova. Teksa në mesin e viktimave të kthyera nga varrezat masive në Serbi ajo identifikon eshtrat e të birit, nuk i mbetet gjë tjetër veçse ta djegë veten. Ndërkohë vajza, për të cilën mendonte se i ka vdekur, kthehet shëndosh e mirë. "Ushtarët serbë e rrëmbejnë fëmijën pesëvjeçar nga duart e nënës së përlotur dhe më pas e vrasin priftin katolik që i mbron fëmijët shqiptarë", tregon ngjarjen e filmit gazetarja. Regjisori Raça thotë se ngjarja në film është vetëm një realitet, që ai është përpjekur ta prezantojë në ekranin e madh. Në film luajnë Sheqerie Buqaj, Blerim Destani, Rajmonda Bulku, Faruk Begolli etj. (lajm) Fadil Berisha sjell Eliza Dushkun në Shqipëri Fotografi Fadil Berisha ia ka dalë ta bindë aktoren Eliza Dushku që të shkojë në Shqipëri, gjegjësisht në Korçë, prej nga e ka origjinën babai i saj. "Ka kohë që me Elizën bënim plan që të udhëtojmë bashkë drejt Shqipërisë", thotë Berisha për "Lajm". Ditët e fundit, ai ka realizuar disa seri fotografish me Dushkun, disa prej të cilave edhe me simbole kombëtare. Serinë tjetër do ta bëjë në Shqipëri. Është paralajmëruar që gjatë qëndrimit në Shqipëri, Dushku të jetë mysafire në Festivalin evropian të videoklipeve, që mbahet më 3 qershor në Tiranë. Dushku shoqërohet në vizitë nga dy vëllezërit e saj dhe në Korçë ata do të takohen me të afërm të tyre. Është paraparë që në aeroportin "Nëna Terezë" të Rinasit, aktores t'i përgatitet një befasi - një stendë gjigande më fotografinë e saj. E lindur më 30 dhjetor 1980 në Boston, Eliza Dushku (Eliza Patricia Dushku) ka nisur të luajë filma qysh si fëmijë (rolin e motrës së vogël të personazhit të interpretuar nga Leonardo Di Caprio), për të vazhduar në projekte të mëdha, në krah të Robert De Niros, Arnold Schëarzeneggerit, Jamie Lee Curtisit etj. Këto ditë ka përfunduar xhirimet e filmave "The Final Season" dhe "Nobel Son". Familja e babait të saj emigroi në SHBA në periudhën mes të dy luftërave botërore, ashtu si mijëra shqiptarë të zonës së Korçës.

Në një intervistë dhënë kohëve të fundit, ajo thotë se ndjehet krenare që është shqiptare dhe mezi pret që ta vizitojë Shqipërinë. Babai i saj është i martuar me daneze. "E dua shumë nënën time, por asnjëherë nuk jam ndjerë daneze. Përkundrazi, në çdo film fus nga një fjalë shqipe, apo bëj diçka ta kujtoj Shqipërinë", i ka thënë Dushku Berishës. Ajo nuk pranon asnjëherë të luajë role, në të cilat do të shfaqej lakuriq. "Më kollaj është ta shohësh të zhveshur Zotin, se sa mua". Në një intervistë me yllin e ekranit të vogël amerikan, Regis Philbin, Dushku u habit kur mori vesh se edhe ai ishte me prejardhje shqiptare. "Deri tash e dija vetëm për Vëllezërit Belushi dhe Nënën Terezë". (Lajm Kultura) Regjisori Orhan Kerkezi - S'e ka "gjetur veten" në "Përrallë me tupan" Regjisori Orhan Kerkezi e ka bërë regjinë vetëm të katër episodeve të shou komedisë "Përrallë me tupan" dhe thotë se nuk e ka "gjetur veten" në të. E konceptuar nga humoristi Valon Maloku, "Përralla..." përfundon sezonin sonte, pas shtatë emisioneve të shfaqura në Radio Televizionin e Kosovës (RTK). Kerkezi thotë se misioni i tij ka qenë "vetëm me i dhanë hov" shout dhe se me Malokun ishin marrë vesh që t'i ndihmojë vetëm në katër emisionet e para. Më pas, Kerkezi e ka hequr emrin e tij nga shou. "Për shkak të obligimeve tjera, nuk kam mundur t'i ndihmoj më Valonit", tha ai për "Lajm". Kerkezi premton se në shtator mund të kthehet prapë me shoun humoristik në qoftë se, sipas tij, ndërrohet profili i emisionit. "Unë kam menduar të jetë pak më ndryshe…, mirëpo ai projekt është njëqind për qind i Valonit. Thjesht, unë nuk e kam gjetur veten". Për regjisorin e dokumentarit "Tre hapat e shpëtimit", ky nuk do të jetë fundi i bashkëpunimit me RTK-në. Prej korrikut, "Okey Division" dhe RTK do të fillojnë një seri të re emisionesh, që mbajnë vulën e Kerkezit. "Do të jenë emisione që përfshijnë reportazhe, turizëm, dokumentarë etj". (Lajm Kultura) Gaultier stilon për Madonën "Dikur ishte vajzërore, sot është perfekt" Përshtypja ime për Madonën kur e kam parë për herë të parë ka që në e një vajze shumë sensuale. Sot ajo është bërë profesioniste në mënyrën e të veshurit, është me e dobët, më fine dhe më muskuloze. Është e gjatë një metër e 73 dhe ka propocione perfekte. Ajo mban masë n 40. Një yll i vërtetë ", përfundon Gaultier. Jean-Paul Gaultier kthehet për t'u bërë një kopje e pandashme me Madonën, për të modeluar lukun e një gruaje që josh fansat e saj me anë të trupit të saj perfekt dhe me anë të zërit sigurisht. Për gjashtëmbëdhjetë vjet radhazi, stilisti ka stiluar për kë të këngëtare që shquhet për format e saj muskulore të trupit. I ka qëndruar besnik në shumë turne dhe në këtë të fundit që do të nisi në Los Angeles do të jetë po ai që do ta veshë në mënyrë të veçantë Madonën. Në stil fustani mbrëmjeje që të krijon përshtypjen e një amazone, me një kurorë të mbushur me gurë ose me

një luk të tipit Travolta, Madona do të vazhdojë të na çudisë përsëri. Gaultir është i bindur në çdo rast për kë të .. Ka publikuar disa skica të veshjeve të saj në revistën "Liberation" dhe i ka thënë Françoise-Marie Santuç i dhe Oliver Ëickerit se është i habitur nga arritja profesionale që ka arritur popstarja në mënyrën e të veshurit. Stilisti ka dizenjuar katërqind kostume për të, për balerinët dhe për muzikantët. Kostot janë top sekret por "Confessions Tour" në Romë e prezanton këtë si suksesin më të madh në histori, më të ardhura që mund të arrijnë rreth 200 milionë dollarë. Gaultier është një fans shumë i madh i Madonës. Admiron punën, fizikun dhe karakterin e saj. Është kënaqë si të punosh me të : "Sfilatat e mia i realizoj sipas mendjes time ndërsa me Madonën më ndodh ndryshe, duhet të hyj në mendjen e saj". Për sa i përket materialit të rrobave, ato duhet të jenë të butë , si psh., materiale të lehta, shifoni, etj. Sipas Gaultierit, Madona shikon gjithçka, ndien gjithçka dhe kontrollon gjithçka : "Syri i saj ndalet tek çdo detaj. Ajo është një super perfeksion". Top Ten i së ardhmes Të reja, të holla dhe shumë të gjata. Të gjitha kërkojnë suksesin në për pasarela dhe koopertina revistash. Greta, Johanna, Eve, Domenika, Ekaterina, Liz, Eve, Helene, Michelle, Susan, Charlby: një italiane, dy çeke, një sllovake, një ruse, një hollandeze, një daneze, një angleze, një amerikane dhe një afrikano-jugore. Janë 10 të panjohura që "Panorama" I ka përzgjedhur si Naomi dhe Kate e së ardhmes. Të gjitha vajzat janë të reja, rreth moshë s 15 dhe 16 vjeç, përjashtim kë tu bë n vetë m Ekaterina, sozia e Milla Jovovich, e cila është 20 vjeç por duket si më e vogla nga të gjitha vajzat. Kriteri kryesor i përzgjedhjes ka që në eleganca. Modelet duhet të kishin masën ndërmjet 38 dhe 42, gjatësia rreth 1.80, një gjoks të sheshtë që është tipik për modelet, këmbë kilometrike janë disa nga kushtet që duhen të përmbushin kë to vajza. Të gjitha pretendojnë revistë n "Vogue", pasarelat e Milanos, Parisit dhe Nju Jorkut. "Panorama" I ka zgjedhë si prototipë të tendencës së re. Kush tjetër përveç tyre, mund të ilustrojë bukurinë bashkë kohore? Gjithmonë e më tepër femrat po synojnë bukurinë perfekte, buzë më të plota, hundë më të vogël, gjoks më të plotë , peshë më të vogël dhe një garderobë të re me rroba më moderne. Pak a shumë ti afrohen fizikut të njëkukulle barbi. Së fundi një imazh ideal femëror, atë që shumë meshkujt do ta adhuronin. Porvajzat e përzgjedhura kanë një tjetër mission, ato kanë kthyer sërish modën e trupitimperfekt pra të gjitha ato femra që nuk kanë përmasa 90-60-90 nuk duhet të prokupohen për të gjetur mënyrën e për t'i realizuar. Ka ardhur koha që secila femër të kënaqet me trupin e saj, ta pëlqejë atë edhe pse mund të ketë defekte sepse kjo është moda që përcjellin modelet e së ardhmes. Janë pikërisht këto modele qëdotëdominojnë-

nëbotënemodës. Një problem që shfaqet nga të qënit e bukur perfekte është se të gjitha janë njësoj,nukkavariacionmestyre,ashtu siç është edhe moda. Boll të kujtojmë Kate Moss e cila nuk është shumë e gjatë , ka këmbë të shtembëra, dhëmbë jo perfektë dhe një fytyrë normale por sekreti I saj qëndron në të qënit shumë ekspresive. Nuk mjafton të jesh e bukur, duhet të transmetosh diç ka teksa parakalon në pasarelë. Pra thjesht fare, kënaquni me trupin tuaj, është ai që shpreh më shumë. Leonora Morina -Synon titullin "Miss Shqipëria" Pas titullit "Mis Peja 2005" dhe "Mis Fotogjenia" në "Mis Kosova 2005", Leonora Morina synon ta fitojë edhe titullin "Miss Shqipëria 2006". Spektakli këtë vit organizohet në Lezhë. Dita ende nuk është caktuar, kurse Morina është një ndër vajzat që do ta përfaqësojë Kosovën. "Mezi pres të nisem drejt Shqipërisë. Shpresoj që organizimi të jetë i mirë. Para së gjithash, dëshiroj që atje të kaloj mirë, të krijoj miqësi të reja dhe të marr përvoja të reja". Thotë se titulli do t'i ndihmonte shumë që t'i realizojë ambiciet e veta në fushën e menaxhimit dhe të marketingut". Ndërkaq, e ka ndërmend të studiojë në Fakultetin Juridik. "NRG Band" e promovoi albumin e ri - "Hallabatana" MANIK BEGOLLI (Lajm Ekskluzive) "Hallabatana" titullohet albumi i ri i grupit "NRG Band", që u promovua mbrëmë në Prishtinë. Kitaristi i grupit, Meti Çaka, thotë se në këtë projekt është punuar rreth një vit e gjysmë dhe i përmban 10 këngë, ndër të cilat e fundit është "Bonus track" e kënduar "live". "Kënga e dytë titullohet 'Hallabatana' dhe për ta bërë më interesant, vendosëm që edhe albumin ta quajmë ashtu. Në popull kjo fjalë njihet si diçka që bëhet pa dashje". Sipas Çakës, nëntë tekste këngësh i ka shkruar Mithat Sadiku, ndërkaq një Drita Sadiku-Nokshiqi. "Zhanri i muzikës është përafërsisht i ngjashëm me albumin e kaluar. Ka rege, pop e rok. Besoj se publiku do ta presë mirë". Deri më tash, këngës "Paja" i janë punuar dy videoklipe, në dy versione - bardh e zi dhe me ngjyra. Ndërkaq, së shpejti do të xhirohen edhe dy-tri videoklipe të tjera. Çaka thotë se grupi është duke punuar edhe në disa projekte të tjera, por tash për tash është i përqendruar në editimin e albumit. "Pas promovimit të albumit, do ta vazhdojmë punën nëpër mbrëmje të ndryshme, por sigurisht do të marrim pjesë në ndonjërin nga festivalet e mëdha". Në albumin e kaluar, hit ishte kënga "Ama", ndërsa nga albumi i ri Çaka nuk veçon ndonjërën, sepse, siç thotë, të gjitha janë të mira. Finlanda me një shesh të quajtur LORD Qyteti finlandez, Rovaniemi ka njoftuar se do ta quajë sheshin kryesor të tij 'Lordi', për nder të grupit të muzikës, 'heavy metal' që fitoi edhe edicionin e këtij viti të festivalit evropian. Sheshi i ri do të jetë pjesë e qendrës së rindërtuar të qytetit. Kryetari i Bashkisë së Rovaniemit, Mauri Gardin, tha se qyteti dëshironte të nderonte djemtë e tij për këtë sukses, siç u shpreh ai, senzacional.

Grupi Lordi është i pari fitues nga Finlanda në Eurovizion. Finlanda është vendi që ka patur edhe prezantimin më të dobët ndër vite në festivalin e këngës evropiane. Qyteti Rovaniemi ndodhet në Artikun e Veriut dhe e përshkruan veten si shtëpia e plakut të vitit të ri prej vërteti. Ai i ka përgëzuar djemtë e grupit Lordi, duke thënë se me shumë punë ëndërrat mund të bëhet realitet. Grupi me paraqitjen monstruoze është mbrojtur duke thënë se paraqitja e tyre skenike është thjesht për argëtim dhe ata nuk janë ndjekës të ndonjë sekti satanist, sikur u tha nga disa. Finlandezët mundën në garën për vendin e parë, favoritët, rusin Dima dhe boshnjakun Hari Mata Hari. Shpërblehet Ardita Statovci Pianistja nga Prishtina, e cila studion pianon në Universitetin e Muzikës dhe të Arteve Aplikative "Mozarteum" në Salzburg, është nderuar me të vetmin çmim që jepet në këto gara NAIME BEQIRAJ (Lajm Ekskluzive) Pianistja prishtinase Ardita Statovci është shpallur fituese e garave ndërkombëtare të muzikës, që u mbajtën të premten në Salzburg të Austrisë. Ajo u nderua me çmimin "Bösendorferpreis". Universiteteve austriake të muzikës ky çmim u jepet nga fabrika me renome e pianove "Bösendorfer". Statovci tha për "Lajmin" se gara ishte më shumë "sportive", e jo muzikore, sepse gjithë mjeshtëria është dashur të tregohet gjatë tre minutave interpretim. "Të gjithë pjesëmarrësit kishin zgjedhur që gjatë kësaj kohe të interpretojnë pjesë virtuoze, d.m.th. ndonjë pjesë që lë mbresë. Unë interpretova një pjesë nga kompozitori Rachmaninov, 'Moment musicaux' në e-mol'". Në garën e zhvilluar në Universitetin "Mozarteum", në të cilin u dha vetëm një çmim, morën pjesë pianistë nga vende të ndryshme të botës, si nga Koreja, Japonia, Kina, Kroacia, Austria, Rumania, Franca, etj. "Në këtë garë fitoi Kosova, edhe pse, fatkeqësisht, ende pa status", thotë Statovci. Ajo premton se pjesën muzikore, për të cilën është shpërblyer, së shpejti do ta luajë në një koncert në Prishtinë. Statovci (1982), studente e pianos në Universitetin e Muzikës dhe të Arteve Aplikative "Mozarteum", ka arritur edhe të tjera suksese në fushën e muzikës klasike (piano). Premiera botërore për "parinë" kosovare Premiera e filmit "The Da Vinci Code" u prit mirë nga publiku kosovar. Në premierë dominonin fytyrat publike, por mungonin regjisorët kosovarë. Prishtina në mbrëmjen e nëntëmbëdhjetë majit i ngjante një kryeqyteti të madh evropian. Edhe pse kjo ndjenjë ishte afatshkurtër, adhuruesit kosovarë të kinematografisë patën rastin ta shijojnë të njëjtën kënaqësi si adhuruesit e filmit anë e mbanë botës. Ndjenja e të qenit "metropol botëror", të paktën vetëm për një natë, erdhi së bashku me premierën e filmit "The Da Vinci Code". Merita për këtë i takoi Kinemasë ABC. Premiera botërore e këtij filmi të shumëpritur të premten mbrëma u dha në tërë botën. Kësaj radhe pjesë e një bote të moderuar ishte edhe

Kosova, respektivisht Prishtina. "Grabitësit" e biletave për premierën e parë në Kinemanë ABC ishin kryesisht fytyra publik e - artistë, ministra, biznesmenë. Ndër të pranishmit ishte edhe deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Enver Hoxhaj. Ai e kishte pritur premierën me padurim, ndonëse përkushtimi i tij i madh rreth negociatave të Vjenës, e la atë pa e shikuar filmin deri në fund. "Edhe pse e kam pritur me padurim, nuk kam mbërritur ta shoh filmin deri në fund, ngase është dashur t'i kryej ca punë. Kam qëndruar gati 50 minuta. Megjithatë edhe libri por edhe filmi, aq sa ia dola ta shoh, për mua kanë qenë fascinues. Ideja kryesore e këtij libri por edhe filmit sjellë disa dilema që e kanë përcjellë krishterimin që d y mijë vjet dhe tash shfaqen me një realizim modern. Mua më ka lënë shumë përshtypje", u shpreh Hoxhaj. Katër bileta për premierën e filmit "The Da Vinci Code" ishin rezervuar edhe nga ana Ministrit të Kulturës, Astrit Haraqisë. Megjithatë ai nuk erdhi. Mungesa me e madhe në sallë ishte ajo e regjisoreve kosovarë. Ndër gjithë regjisorët që ka Kosova, në sallën e kinemasë u vërejtën vetëm Agim Sopi dhe Bekim Lumi. "Së pari, mendoj se shfaqja e filmit 'Kodi i Da Vinçit' në Kinemanë ABC në të njëjtën kohë kur ky film po shfaqet edhe nëpër kinematë e shumë kryeqyteteve botërore, të paktën për një natë, e bënë Prishtinën kryeqytet evropian", tha Lumi. "Mendoj se ky film është një triler interesant, i cili padyshim e provokon debatin mbi një temë të ndjeshme dhe mbi një personazh të tillë siç është Jezu Krishti, me të cilin është i lidhur besimi i miliona njerëzve kudo në botë. Kjo, ndërkaq, në një ambient provincial siç është Kosova, ku njerëzit nuk disponojnë me informacione të mjaftueshme mbi jetën dhe bëmat e Krishtit e të pasuesve të tij, herë - herë filmin e bënë të turbullt, të pakapshëm, të pakuptueshëm dhe monoton", vazhdoi ai. Lumi gjithashtu mendon se filmi mund të kuptohet dhe deshifrohet vetëm nga ata që paraprakisht, disponojnë me kulturë të mjaftueshme biblike. Më së miri nga kjo premierë u nda Kinemaja ABC, pasi ishte pjesë e një ngjarjeje botërore dhe brenda natës mbajti dy premiera për një film të vetëm. "Salla ka qenë e mbushur në dy premierat. Filmi është pritur shumë mirë, këtë e dëshmuan edhe diskutimet e mëdha që filluan menjëherë pas mbarimit të filmit", tha zëdhënësi i Kinemasë ABC, Avni Dobraj. "The DaVinci Code" do të shfaqet në repertor të rregullt në Kinemanë ABC, ndonëse për dy ditët e ardhshme biletat tashmë janë rezervuar. Ka diçka magjike në gjithë këtë rrëfim. Në 25 vjetorin e vdekjes së Bob Marleyt Bob Marley ishte stari i parë me famë botërore nga një vend i botës së tretë. Sot muzika e tij vazhdon të dëgjohet me kënaqësi në Gjermani jo vetëm nga ata që e kanë përjetuar atë vetë dhe kohën e tij, por edhe nga më të rinjtë. (DË) Në Nine Mile, një fshat i vogël në Xhamajkë gjendet një mauzoleum. Aty

është varri i Bob Marleyt, profetit të muzikës reggae. Para 25 vjetësh Bob Marley vdiq prej kancerit. Në varr përveç trupit pa jetë të këngëtarit u vendosën edhe kitara e tij, bibla si dhe një degë e bimës canabis sativa. Në varrimin e tij morën pjesë asokohe 100.000 vetë, që kishin ardhur nga e gjithë bota. Në vitet 70-të nëpër koncertet e Bob Marleyt shkonin me miliona dashamirës të muzikës. Ai ishte stari i parë me famë botërore që vinte nga një vend i botës së tretë. Por edhe sot muzika e Bob Marleyt vazhdon të dëgjohet me kënaqësi në Gjermani jo vetëm nga ata që e kanë përjetuar vetë kohën e tij, por edhe nga të rinjtë. Mund të thuhet madje se muzika reggae me të tria stilet e saj jungle, dub dhe dancehall po përjetojnë një revival, një rindezje në diskotekat gjermane. Në Danziger Strasse në Berlin gjendet diskoteka "Freistil". Në fasadën e saj shkruhet me shkronja të mëdha reklama, "Reggae-Night". Shumë mirë themi me dy miq dhe tentojmë të hyjmë në diskotekë, ku portjetri na sheh dhe na thotë, urdhëroni po publiku nuk është për moshën tuaj. Për moshën tonë? pyesim me sy duke parë njëri-tjetrin të habitur. Asnjë prej nesh nuk ka mbushur 40 vjeç dhe muzika reggae, në fakt me ritmet e saj të qeta është tamam për "chill out", për t'u qetësuar dhe relaksuar. Pak qejfprishur me portjerin që na rreshtoi në brezin e të moshuarve, i themi se këtu jemi për një reportazh dhe hyjmë në diskotekë. Të rrethuar prej 17-23 vjeçarësh e marrim vesh menjëherë, se ku e kishte fjalën portjeri, po mikrofoni na bën të hyjmë menjëherë në bisedë me vizitorët e diskotekës, ndërkohë që nga altoparlantët dëgjohet një kënga e Bob Marleyt: "Get up, stand up" "Kjo muzikë më pëlqen shumë dhe më jep kënaqësi ta dëgjoj, sidomos kur shkëlqen dielli.", thotë një 19-vjeçare. "Këtë muzikë mund ta dëgjosh gjthmonë, sepse është muzikë reggae klasike.", thotë një 23-vjeçar. "Në fakt unë njoh vetëm dy këngë të Bob Marleyt dhe ato më pëlqejnë shumë, "No ëoman, no cray" dhe një tjetër, që është pak më reggae.", - shton një 22-vjeçare. Në një cep të diksotekës janë ulur disa të rinj që pinë duhan me nargjile. Një 17-vjeçare e thith një herë thellë dhe thotë: "Unë nuk mund ta dëgjoj përditë këtë muzikë, por kur thith nargjile, apo për t'u relaksuar më duket cool." Sot muzika e Bob Marleyt vazhdon të jetojë në të ashtuquajturit "sound systems", grupe prej dy apo tre DJ, të cilët ofrojnë rimikse të këngëve të tij dhe përfaqësuesve të tjerë të muzikës reggae nëpër diskoteka. Dhe publiku çirret duke shoqëruar tingujt e këtyre këngëve. Stadium Arcadium dy orë muzikë nga Chilis Irena Luto - Ritëm&Pop (BBC) Pas gati një çerek shekulli bashkë, Red Hot Chili Peppers janë në majat e e karierës së tyre. Kanë kaluar katër vjet që prej albumit të fundit, dhe Stadium Arcadium duket sikur dëshiron të ngopë të gjithë 'fansat' (adhuruesit) e uritur për krijmtari të re nga Chilis. Albumi me numër 9 i kalifornianëve ka 28 këngë dhe gjithësej dy orë të plota muzikë. Në Stadium Ar-

cadium ka dy lloj këngësh;të mira dhe shumë të mira, disa këngë të ngjashme me krijmtarinë e mëparshme si edhe plot këngë dashurie. Çfarë po ndodh me Chilis? Pas rregjistrimit të albumit 'By the Ëay' në 2002 dhe koncerteve të suksesshme në Hyde Park në Londër, Red Hot Chili Peppers u tërhoqën në shtëpinë e producentit të tyre të vjetër dhe rregjistruan materiale sa për tre albume. Në fillimet e tyre në 1985, u tha se asgjë e mirë nuk pritej të dilte nga ky grup që ishte i dominuar nga një anë e errët. Sot Chilis të mahnisin me kreativitetin e tyre. Stadium Arcadium, nuk është një album me një koncept të caktuar. Ai është një reflektim i spiritualizmit imagjinar të periudhës pas daljes nga varësia prej drogës. Anthony Kiedis, lideri dhe vokali i grupit, thotë se titulli i albumit ka të bëjë me euforinë gati religjioze që ka shoqëruar koncertet e tyre në stadiume. Në këtë album të dyfishtë, ka gjithandej këngë dashurie, këngë ku shprehet keqardhje për të kaluarën. Këto janë pjesërisht reflektime të eksperiencave që e identifikuan vokalistin Kiedis me drogën dhe gratë. Jo seks, por dashuri Stadium Arcadium lulëzon në krijmtari, dhe kjo sipas Kiedis ka të bëjë me ideologjinë dhe harmoninë që ekziston brenda grupit, por nga ana atjetër edhe me dashuritë që i ka prekur më të fund jetët e mesoburrave të grupit. Basisti Flea ka një vajzë katër muajshe, pas të cilës është i çmendur fare, beteristi Chad Smith ka një djalë 10 muajsh, truri muzikor i albumit John Frusciante (dhe më i riu i grupit) ka rënë kokë e këmbë në dashuri me këngëtaren Emily Kokal, me të cilën ka bashkëpunuar edhe nga ana muzikore. Për vetë 'zotin Kiedis' flitet se pret të bëhet baba nga lidhja me një modele 19- vjeçare e quajtur Jessica Stam. Disa nga këngët e albumit: 'Charlie' është një këngë për një shpirt imagjinar që sillet në mendje. Ky shpirt mund të jetë kokaina ose një femër. 'C'mon girl' është një këngë që vlerëson dëmin që kanë shkaktuar mbi Kiedis marrëdhëniet (jo normale) me gratë. 'Ët sand' është për një djalë që beson në zot dhe një vajzë që beson në evolucion. Debati mes tyre nuk mund të dalë me një kokluzion. 'Hey' është kënga himn e albumit. Ajo të con në vendin përpara se të lindësh dhe në atë që shkon pasi vdes, thotë Kiedis. Kënga jep mesazhin lëre 'atë gjë që po të bën të vdesësh'. 'Dani California' është një vazhdim i jetës së personazhit në qendër të këngëve nga albumet 'Californication' dhe 'By the ëay'. Ajo është vajza e një polici e dhënë jashtë mase pas anarkisë, por në këtë këngë ajo takohet me Perëndinë. 'Tell me Baby' është në stilin e vjetër të Kiedis. Casanova duke kërkuar prenë e rradhës. Në Stadium Arcadium, Chilis janë më të pjekur si burra dhe të dhënë pas një tjetër dependence, kësaj rradhe shpirtërore. "Më mirë pak dritë, sesa fare", ka thënë Kiedis i pyetur përse ishte ndjekës i fesë Kabalah, sekt që rrjedh nga besimi hebraik, promovues i të cilit është bërë

Madonna. Në 25 vjetorin e vdekjes së Bob Marleyt Bob Marley ishte stari i parë me famë botërore nga një vend i botës së tretë. Sot muzika e tij vazhdon të dëgjohet me kënaqësi në Gjermani jo vetëm nga ata që e kanë përjetuar atë vetë dhe kohën e tij, por edhe nga më të rinjtë. Në Nine Mile, një fshat i vogël në Xhamajkë gjendet një mauzoleum. Aty është varri i Bob Marleyt, profetit të muzikës reggae. Para 25 vjetësh Bob Marley vdiq prej kancerit. Në varr përveç trupit pa jetë të këngëtarit u vendosën edhe kitara e tij, bibla si dhe një degë e bimës canabis sativa. Në varrimin e tij morën pjesë asokohe 100.000 vetë, që kishin ardhur nga e gjithë bota. Në vitet 70-të nëpër koncertet e Bob Marleyt shkonin me miliona dashamirës të muzikës. Ai ishte stari i parë me famë botërore që vinte nga një vend i botës së tretë. Por edhe sot muzika e Bob Marleyt vazhdon të dëgjohet me kënaqësi në Gjermani jo vetëm nga ata që e kanë përjetuar vetë kohën e tij, por edhe nga të rinjtë. Mund të thuhet madje se muzika reggae me të tria stilet e saj jungle, dub dhe dancehall po përjetojnë një revival, një rindezje në diskotekat gjermane. Në Danziger Strasse në Berlin gjendet diskoteka "Freistil". Në fasadën e saj shkruhet me shkronja të mëdha reklama, "Reggae-Night". Shumë mirë themi me dy miq dhe tentojmë të hyjmë në diskotekë, ku portjetri na sheh dhe na thotë, urdhëroni po publiku nuk është për moshën tuaj. Për moshën tonë? pyesim me sy duke parë njëri-tjetrin të habitur. Asnjë prej nesh nuk ka mbushur 40 vjeç dhe muzika reggae, në fakt me ritmet e saj të qeta është tamam për "chill out", për t'u qetësuar dhe relaksuar. Pak qejfprishur me portjerin që na rreshtoi në brezin e të moshuarve, i themi se këtu jemi për një reportazh dhe hyjmë në diskotekë. Të rrethuar prej 17-23 vjeçarësh e marrim vesh menjëherë, se ku e kishte fjalën portjeri, po mikrofoni na bën të hyjmë menjëherë në bisedë me vizitorët e diskotekës, ndërkohë që nga altoparlantët dëgjohet një kënga e Bob Marleyt: "Get up, stand up" "Kjo muzikë më pëlqen shumë dhe më jep kënaqësi ta dëgjoj, sidomos kur shkëlqen dielli.", thotë një 19-vjeçare. "Këtë muzikë mund ta dëgjosh gjthmonë, sepse është muzikë reggae klasike." , thotë një 23-vjeçar. "Në fakt unë njoh vetëm dy këngë të Bob Marleyt dhe ato më pëlqejnë shumë, "No ëoman, no cray" dhe një tjetër, që është pak më reggae.", - shton një 22-vjeçare. Në një cep të diksotekës janë ulur disa të rinj që pinë duhan me nargjile. Një 17-vjeçare e thith një herë thellë dhe thotë: "Unë nuk mund ta dëgjoj përditë këtë muzikë, por kur thith nargjile, apo për t'u relaksuar më duket cool." Sot muzika e Bob Marleyt vazhdon të jetojë në të ashtuquajturit "sound systems", grupe prej dy apo tre DJ, të cilët ofrojnë rimikse të këngëve të tij dhe përfaqësuesve të tjerë të muzikës reggae nëpër diskoteka. Dhe publiku çirret duke shoqëruar tingujt e këtyre

këngëve. "Kodi i Da Vinçit" pritet keq në Kanë Në Francë, festivali i filmit në Kanë ka filluar këtë vit, sipas shumë kritikëve, pa ndonjë shkëlqim me premierën e filmit Kodi i Da Vinçit. Adaptimi i romanit shumë të shitur të shkrimtarit Dan Broën ka ngjallur shumë debate edhe para shfaqjes së filmit. Filmi ka marrë shumë kritika gjatë prezantimit të tij në Kanë. Filmi shkaktoi mjaft reagime dhe të qeshura në shumë momente thelbësore ndërsa shfaqej. Në përfundim të shfaqjes nuk kishte duartrokitjke, por pati fërshëllima. Filmi Kodi i Da Vinçit, me regji të Ron Hoëard dhe në rol kryesor Tom Hanks, ashtu si edhe libri është kundërshtuar nga shumë grupe të krishtera që i kanë kundërshtuar sugjerimet se Jezu Krishti është martuar me Maria Magdalenën duke filluar një degë trashëgimtarësh që vazhdon edhe sot. Konkurimi në Kanë Filmi Kodi i Da Vinçit nuk konkuron në Kanë - ai shërbeu si filmi i hapjes të festivalit thjesht për ta bërë atë më tërheqës për mediat. Por, megjithëse nuk mund të thuhet se ishte një dështim, ai nuk shërbeu si një nisje e fortë. Pas një jave fillimi disi jo i mirë i festivalit ndoshta do të jetë harruar. Sigurisht që kameramanët kishin dalë në numra marramendës për të filmuar yjet kinematografike që mbërritën në Croisette, skena e hyrjes nga ana e detit, por ndjenja e përgjithshme në Kanë ishte se festivali ka parë hapje më të mira që kur filloi edicionet e tij në vitin 1939. Në festivalin e Kanës mbeten ende edhe 11 ditë të tjera të mbushura me shfaqje filmash. Ndër to është filmi i ri i Pedro Almodovar "Volver", me aktore kryesore Penelope Cruz. Regjizori britanik Ken Loach ka sjellë një film interesant për nacionalizmin irlandez, "The Ëind That Shakes The Barley". Filma të tjerë që parashikohet të shfaqen gjatë festivalit përfshijnë edhe X Men Instalment, por dhe filma të tjerë jo shumë të njohur nga vende që nuk njihen për nga prodhimtaria kinematografike. Juria e festivalit të sivjetëm drejtohet nga regjizori Ëong Karuai. Ai vjen nga Hong Kongu. (BBC).

Burimi:http://www.shqip.dk/modules.php?name=Neës&file=article&sid=1008

OPERACIONI SEKRET SERB "ZINGJIRI" DO TË DËSHTOJË

Më 17 gusht të vitit 2006,në një ndërtesë të ushtrisë serbe kanë vendosur për planin e operationit secret,më qëllim të rianeksimit të Kosovës,Serbisë dhe ndërprerjen e kahes së zhvillimit të proceseve për pranimin e Kosovës shtet sovra...

Prishtinë,9 nëntor 2006.

- Për këtë krijuan Shtabin e veçantë operativ për Kosovën"Komiteti i Mbrojtjes Nacionale të Kosmetit-KMNK", cili do të jetë nën urdhërat e plota të kryeministrit të Sërbisë,prof.dr.Vojisllav Koshtunica të përbërë nga: SLLOBODAN SAMARXHIQ,këshilltari I Kryeministrit prof.dr.Vojisllav Koshtunica,i cili në të njajtën kohë do të jetë edhe përcjellës kryesor I zhvillimeve të operacionit për kryeministrin serb. SVETKO KOVAQ,kreu i VBA-s(ish Kontra Obavestajna Sluzba-KOS-I famëkeq)structure e cila ka mbetur ende më e pacenuara në serbi,që dyshihet se edhe e mabnë të fshehur gjeneralin serb të Bosnës Serb,Ratko Mlaldiç. ZORAN ANXHELLKOVIQ,nga Partia Socialiste Serbe(SPS),njohës I mire I rrethanave të Kosovës dhe njeri më influencë I ish sistemit të sigurisë së Sllobodan Millosheviqit në serbi dhe gjatë luftës në Kosovë ishte kreyprefekt I Kosovës. ALEKSANDER VUQIQ,nga Partia Radikale Serbe(SRP) NENAD POPOVIQ,nga "Qendra Kordinuese Serbe" PATRIARKU ARTEMIJE,nga Kisha Orthodokse Serbe(SPC),si pjesë e influences dhe e besimit me të madh të serbëve të Kosovës të mbetur ende ndaj faktorëve relevantë politikë,institucionalë apo fetarë nga Serbia. MOMIR JEFTIQ,I cili konsiderohet një nga njerëzit më më influence nga BIA(ish UDB-a),që njëherësh është edhe krah I prof.dr.Vojisllav Koshtunicës dhe presidenti kryesor për të udhëhqur BIA-në në Serbi pas zgjedhjeve të dhjetorit 2006. ACA TOMIQ,ish shefi I Shërbimit informative Ushtraka(KOS) njëherësh njeri ende nga më të besuarit e prof.dr.Vojisllav koshtunicës,të cilit,në fakt,do t'I jipet përgjegjësia e krijimit të grupit operativ për Kosovën,edhe përgjegjësia e realizimit të operacioneve të drejtëpërdrejta në Kosovë. Operacion secret "ZINGJIRI"(LANAC) do të vinte sipas planit serb,si reagim ndaj provokimeve

të shqiptarëve nëpërmes Korpusit 52 të Prishtinës si dhe Armatës së Tretë Serbe të Postës Ushtarake 1912 nga Nishi. E tëra kjo mendohët të realizohët në një të ardhme të operacionit "Lanac". Plani operacional "LANAC"për rianeksimin më force i Republikës së Kosovës ,është pamundshëm falë syqeltësisë së forcave të ushtrisë,policies,rezervistëve të UÇK-së,popullatës 2 milionshe kosovare,Ushtrisë Shqiptare dhe forcave Ndërkombëtare të NATO-s /KFOR-it , Policisë së UNMIK-ut, etj., është një dështim politik dhe ushtarak i verbër i serbisë pas millosheviqjane.vet serbisë.

Flori Bruqi

B*urimi:http://www.shqip.dk/modules.php?name=Neës&file=article&sid=1770*

Shtypi serb kërkon burgosjen e liderëve politikë të FBKSH-së që përkrahin pavarësinë

Kryeartikulli, i botuar kohë më parë në gazetën "Kurir", i titulluar thjesht "Burgu", thekson se, sipas Kushtetutës Serbe, secili person që bën thirrje për shpërbërjen e Serbisë, mund të dënohet me 15 vjet burg. Kjo gazetë i ka bërë thirrje Zyrës së Prokurorisë që të nisë një procedurë të hapur kundër organizatës serbe "Rrjeti i grave në të zeza", që është një nga dy partnerët e këtij koalicioni...

Prishtinë,10 mars.

Në një deklaratë të lëshuar këto ditë, Koalicioni e ka akuzuar këtë gazetë për frikësim, duke shtuar se gazetari i "Kuririt", duket sikur të ketë vepruar "sipas instruksioneve nga ato qendra të fuqive, që e dëshirojnë destabilizimin e mëtutjeshëm të Ballkanit dhe tjetërsimin e mëtutjeshëm të Serbisë (nga Evropa)". Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK) dhe Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia, e kanë themeluar Koalicionin e Grave për Paqe, në mars të vitit 2006, për të monitoruar negociatat shqiptaro-serbe për statusin e ardhshëm të Kosovës - nga perspektiva e grave - dhe për të refu-

zuar "ndarjet etnike dhe religjioze sikur edhe kufijtë shtetëror dhe barrierat". Ky koalicion është aktiv në të dy anët e konfrontuara, që kur përfaqësuesi i posaçëm i OKB-së, Martti Ahtisaari, ka propozuar një pavarësi të kufizuar për Kosovës, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme ndërkombëtare. Në një deklaratë të këtyre ditëve, Rrjeti i grave në të zeza ka insistuar se e ardhmja politike e Serbisë dhe Kosovës duhet të bazohet në të drejtat njerëzore dhe jo në nacionalizëm, madje edhe nëse kjo shpie drejt pavarësisë së Kosovës. Këtë deklaratë ky koalicion e ka fuqizuar me një letër të hapur gjatë javës së kaluar, nëpërmjet se cilës, ka kërkuar që gratë kosovare të përfshihen në bisedimet rreth statusit të ardhshëm të Kosovës dhe në hartimin e kushtetutës së re të Kosovës. Që të dy partnerët e koalicionit e kanë të qartë se pozicioni i tyre nuk mirëpritet nga segmentet politike e të dy anëve të frontit. Opinioni publik në Kosovë, mbështet fuqishëm pavarësinë e plotë të Kosovës, ndërsa më 10 shkurt, dy shqiptarë janë vrarë nga plumbat e gomës të shkrepur nga policia e UNMIK-ut, gjatë një proteste kundër planit të Ahtisaarit. Nga ana tjetër, në Serbi, artikulli i gazetës "Kurir", jep indikacione se nacionalistët serbë do ta shfrytëzojnë shtypin e djathtë për ta persekutuar secilin që flet në favor të modernizimit politik dhe të drejtat në vend të ekstremizmit. Gazetari ushtarako-politë i Beogradit i cili ishte pjesëmarrës në të gjitha luftat e Armatës Jugosllave Milovan Drecun (4.10.1957 në gazette "Veçernji novosti",të Beogradit ,sulmoj këto ditë lideret politiKo-ushtarak të FBKSH-së (Mr.Gafurr Adilin,Astrit Gashin,Dalip Dalipin,Ilir Berishën,Agim Sylejmanin ,Florentin Dibrën,Petrit Nimanin,Mehmet Ismajlin,Mark Antonin ,Behar Zajmin ,Tom Markun ,Fehmi Llukën,Abaz Sylejmanin, e disa të tjerë ..."së gjëja këta janë ushtarakë të Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH) dhe se ata janë ushtrakët kryesorë që luftojnë më të madhe për Ribashkimin e Tokave Shqiptare (sipas çetnikut serb Drecun "Shqipërisë së Madhe"). Drecuni është një ish gazetar i Radio Televizionit Serb të Beogradit(tash është komentator politiko-ushtarak i BIA-së Serbe) i cili prej viteve të 90-ta e deri më tash ishte dorë e djathtë e rexhimit të Kishës Serbe,Politikës së Akademikëve Serb për "Serbinë e Madhe" më në krye Dobrica Qosiqin, Luba Tadiçin,Antonije Isakoviçin,Sllobodan Millosheviçin. dhe hap pas hapi tash e 8-të vjetë "Drecuni i Zi" ishte krah i djathtë i Shërbimëve informative të disa shteteve të Unmik-ut. Fatkeqësisht Drecuni,Dragan Damjanoviqi,Marko Llopushina e disa "analistë"(lexoni spijuj) serb më disa shqipfolës të UNMIK-ut ,po i gjurmojnë shkrimet tona në internet (shkrime këto publike të botuara në forumet virtuale Art-Café,Floart-Press,www.dervina.com,www. Al-Today .com,www.hasanprishtina.com ,www.frosina.org,Alb-Shkenca.org etj) po ju servojnë shkrimet e publikuara

të gazetarëve tanë dhe po ju dorëzojnë për analiza politiko-ushtrake shërbimeve serbe të BIA-së në Graçanicë,Mitrovicë Veriore,Beograd e UNMIK (shërbimeve sekrete të UNMIK-ut)... Drecuni më shokë "ushtarak"po kërkon kokat e liderëve të FBKSH-së (bile edhe disa i kanë vrarë dhe burgosur këto ditë)!... Djemtë tanë (të Shqipërisë Etnike)nuk janë duke kërkuar Tapitë e Serbisë por Tapitë e Arbërisë të marra më dhunë nga Evropa Plakë ! Ju preferojmë SOROS-istëve ,shqipfolësve që punojnë në OJQ-të,BIRN-istëve dhe spijujve tjerë (që finansohën nga Soros-i, Serbija...dreqi dhe i biri) të vetëdisohën dhe të punojnë për të mirën e vetëvehtës dhe bijve të tyre ,sa nuk është vonë!!!
Flori BRUQI

Burimi:http://www.ip.dk/modules.php?name=News&file=article&sid=2956

'MOS HARRONI KRIMET SERBE NË KOSOVË..!'

Gjatë luftë së UÇK-së (1998-1999) shteti vrastar serb angazhoi mbi mijëra forca të sofistikuara forcash ushtarake -policore dhe paramilitare ,kundër popullsisë shqiptare dhe ushtrisë së lëvizshme çlirimtare të Kosovës martire.
Forca serbe ishin një strukturë e kombinuar e armatës serbosllave ,njësive elite të MPB të Serbisë dhe paramilitarëve të "tigrave" të Arkanit ,Vojisllav Sheshelit,Vuk Drashkoviqit , policisë lokale, dhe një morie forcash vullnetare tjera, që vinin në Kosovë si në " bahqe të babës",nga Rusia,Ukraina,Rumania,Bullgaria,Greqia ,Republika Srpska,Srpska Krajina etj. Dhe e gjithë kjo makineri vrastare kishte një hallkë komanduese "vicioze" qe që merrte komandat nga krimineli çetnik tashmë i vdekur në Hagë Sllobodan Millosheviq.

Armata Jugosllave kishte komandën e përgjithshme gjatë përiudhës së bombardimeve të NATO-s. Sipas ligjit ushtarak , Vojska Jugosllavije (VJ) kishte nën varësinë e saj policinë dhe forcat paramilitare, megjithëse gjeneralët në Ministrinë e Punëve të Brendshme serbe (MUPS) ushtruan dukshëm një ndikim shumë të fortë gjatë luftës në Kosovë. Armata Jugosllave(VJ) kontrollonte rrugët kryesore dhe kufijtë duke koordinuar dhe lehtësuar keshtu "spastrimin etnik" dhe "tokën e djegur" (në Kosovë). Policia dhe forcat paraushtarake u përfshinë në mënyrë direkte në largimin më dhunë të mbi

1.000.000 vetëve si dhe shkatërrimin e fshatrave,qyteteve për të cilën kishin mbeshtetjën e artilerisë së Armatës Jugosllave ,policisë dhe paramilitarëve . Gjatë këtyre operacioneve spastruese burrat veçoheshin nga gratë dhe fëmijët per t'u marrë ne pyetje për UÇK-në dhe më pastaj shumë prej tyre egzekutoheshin në vend.
Dihët mirëfilli se Armata jugosllave(serbosllave) ishte nën kontrollin e Këshillit të Lartë te Mbrojtjës, i përbërë nga presidentët e Serbisë, Malit të Zi dhe "Jugosllavise" dhe kryesohej nga kryetari jugosllav Sllobodan Millosheviq.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Armatës Jugosllave gjatë luftës në Kosovë ishte gjeneneral kolonel Dragolub Ojdaniq,(pas luftës ishte ministër i mbrojtjës në VJ deri në tetor 2000).

Armata serbe, ndonëse kishte 3 armata,prej tyre armata e tretë (apo armata e Nishit -Posta ushtarake 1912) ishte përgjegjëse për luftën në Kosovë.

-Armata e 3, gjatë luftës komandohej nga gjeneral kolonel . Nebojsha Pavkoviq (1952).

Më Korpusin 52 të Prishtinës të armatës së 3 të Nishit që ishte në Kosovë komandohej nga gjeneral majori Vladimir Lazareviq .
Nën komandën e gjeneral Lazareviqit ishin :5 brigada, 1 njësi policore ushtarake dhe 1 regjiment aviacioni.

Struktura udhëheqëse-komanduese në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë (Ministarstvo Unutrasnjih Poslova, apo MUP), gjatë luftës në Kosovë komandohej nga ministri i MUP-it Serb gjenerali Vlajko Stojilkoviq.

Brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë bënin pjesë policia e rregullt e Kosovës, e komanduar nga gjeneral majori Streten Lukiq.
-Forcat policore speciale (Posebne Jedinice Policije, apo PJP) komandoheshin nga Gjeneral kolonel Obrad Stevanoviq.

Forcat Antiterroriste (Specijalna Antiteroristicka Jedinica, apo SAJ), komandoheshin nga Kolonel Zhivko Trajkoviq.

Gjenerali Vlastimir Gjorgjeviq ishte kreu i sektorit te sigurimit publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme(tash ka ikur në Rusi), si dhe ishte kordinator i ministrit të punëve te brendshme të Serbisë gjeneralit Vlajko Stojilkoviq.

Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë kishte gjithashtu edhe shërbimin e sekret të sigurimit, e cila komandohej nga gjenerali Gajiq David,psikolog ,i cili luajti një rol të madh mbi 10 vjetë sa ishte prezent në Kosovë(banonte në Hotelin "Grand" Prishtinë dhe kishte kordinatorë policët më në zë të shërbimit sekret të Prishtinë,kryeshefin Mishko Llakoviq).

Përveç aktiviteteve të fshehta për zbulimin e aktiviteteve te UÇK-së...,sigurimi i shtetit serb, në Kosovë dislokoi gjithashtu njësi operative speciale, JSO-në (Jedinica za Specijalne Operacije), dhe ndihmoi në forma te ndryshme njësitë kriminale paramilitare ,te njohur si "Beretat e Kuqe" apo "Djemtë e Frenkit" (Ky emertim u more sipas Frenki Simatoviq(kroat) një personalitet kyç ne Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe njihej si themeluesi i ketij grupi).

Gjate luftës JSO-ja komandohej nga Milorad Lukoviq, një njeri i njohur si "Legija"(tash në burg i akuzuar për organizimin e vrasjës së kryeministrit serb Gjingjiq).

Deri në janar të vitit 2001, ne krye të sigurimit të shtetit serb

ishte gjeneral koloneli Radomir Markoviq,ndërsa kreu i sigurimit të shtetit serb në Kosovë para dhe gjatë luftës ishte gjenerali Gajiq David,psikolog.

Gjatë luftës në Kosovë ishin të angazhuar gjithashtu edhe forca të ndryshme paramilitare si dhe forca të huja,të cilat ishin nën kontrollin e qeverisë dhe të kryetarit jugosllavë Sllobodan Millosheviqi.

Për manifestimin e trimërisë dhe të guximit në "vrasjen dhe masakrimin e mijëra shqiptarëve në Kosovë",krimineli Sllobodan Millosheviqi u dha "urdhërin e trimërisë" këtyre pjestarëve të armatës së tretë: Gjeneral brigadier Milan D.Gjakoviç,kolonel Zoran M.Jabllanoviç, kolonel Milivoje P.Braniç, kolonel Miloje Miletiç, kolonel Dragan Petroviç, kolonel Radojko Stevanoviç, kolonel Veroljub Zhivkoviç, lejtënant kolonel Simo Ivoseviç ,lejtënant kolonel Stojan Konjikavac,lejtnënant kolonel Pera Petroviç ,Major Zoran Bojkoviç, major Urosh Nikoliç,major Radivoje Paravinja,major Ljubisav Stojanoviç,kapiten i urd-

hërit të parë Ljubisha Vuqetiç,kapiten i urdhërit të parë Zoran Raseta,kapiten i urdhërit të parë Boban Rajkoviç,kapiten Dragan Lukiç,kapiten Jovica Milak,kapiten Perica Nastasijeviç,kapiten Milosh Raleviç,kapiten Cedo Tërpkovski ,lejtënant Boban Kuzmanoviç,nënlejtënant Nenad Popoviç,rreshteri veteran Radisha Iliç,
Rreshteri veteran Zheljko Alar,rreshteri veteran Branko Vukoviç,rreshteri Aleksandër Rakoviç,rreshteri i ri Ivan Niqiforoviç,kaporal Branisllav M.Fungerhut,ushtar Dragan Beloseviç,ushtar Milan Bogdanoviç,ushtar Veroljub Mijatoviç,ushtar Sasha Pejiç,ushtar Milinko Pendiç,ushtar Nikolla Popoviç etj.

-Gjithashtu u dekoruan edhe këta oficerë të UDB-së në Kosovë: Kolonel Dragutin ADAMOVIQ-Gjakovë,kolonel Dushan B.GAVRANIQ-Gjilan,kolonel Gradimir R.ZEKAVICA-Prizren ,nënkolonel Millan S.GJURIQIQ-(Prizren,kreu i departamentit të policisë),major Milenko M.BOZOVIQ-komandant i policisë në Skënderaj.

-Kryekrimineli Sllobodan Millosheviq,me "Urdhërin e lirisë ,Urdhërin e heroit Komnbëtar, Urdhërin e Flamurit Jugosllav dhe Urdhërin e Flamurit të Luftës të Shkallës së parë" dekoroi këta komandantë të lartë që luftuan në Kosovë:

Urdhëri i Lirisë iu dha: Gjeneralit Dragolub Ojadaniq ; Gjeneralit Nebojsha Pavkoviq(Komandant i Armatës së Tretë)

Urdhëri i Heroit Kombëtar iu dha: Kolonel Dragan Zhivanoviq-komandant i Brigadës 125 të motorizuar,kolonel Bozhidar Deliq-komandant i Brigadës 549 të motorizuar; Kolonel Ljubisha Dikoviq- komandant i Brigadës 37 të motorizuar;

Nënkolonel Ilija Todorov-komandant i Brigadës 63 të parashutistëve;
Kolonel Zharko Brankoviq-komandant i Brigadës 124 të ndërhyrjes policore;

Urdhëri i Flamurit Jugosllavë iu dha:

Zoran Angjelkoviqit-"Komandant i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm për Kosovë e Metohi", Nikolla Shainoviqit-Zëvendës kryeministër i qeverisë jugosllave, Vllastimir Gjorgjeviqit-gjeneral kolonel i policisë se MUP-it Serb, Obrad Stevanoviqit-gjeneral kolonel i policisë se MUP-it serb, Sreten Lukiqit-

gjeneral major i policisë se MUP-it serb,Gajiq David- gjeneral kolonel i Shërbimit Sekret Serb.

***

Pas një fillimi të ngadaltë në vitin 1998, Gjykata Ndërkombetare Penale për ish- Jugosllavinë filloi një hetim të plotë të krimeve të luftës në Kosovë. Meë 27 maj 1999 gjykata bëri te ditur padine me te rendesishme kunder: Slobodan Miloseviqit, dhe 4 zyrtarë të tjerë të lartë që akuzoheshin për "vrasje, persekutime dhe dëbime në Kosovë" nga 1 janari 1999 deri ne fund te majit te 1999.

Te paditurit e tjerë janë:

Milan Milutinoviq, president i Serbisë dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes,
Dragoljub Ojdanië, Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave,
Nikola Sainovië, zëvendëskryeministër i Republikës Federale të Jugosllavisë (FRY), dhe Vlajko Stojiljkoviç, ministri i Punëve të Brendshme në Serbi.

Me 1 prill 2001 krimineli Sllobodan Milloshevic u arrestua, ndërsa më 28 qershor ai u transferua në Gjykatën e Krimeve të Luftës në Hagë.

Në shkurt të vitit 2006 Sllobodan Millosheviqi vdes, pa e marrë dënimin e merituar nga gjykata ndërkombëtare në Hagë, ndërsa bashkëpunëtoret e tij janë duke u gjykuar!!!

Derisa krerët e lartë përmendur janë ne proces te gjykimit ne Hagë, shpesh herë shtrohet pyetja: Kur do të arrestohen edhe qindra zyrtare tjerë te lartë të ushtrisë dhe policisë serbe (qe janë graduar dhe kanë marrë mirënjohje nga Sllobadan Millloshevigi), për krimet me monstruoze të kryera ne Drenicë(Prekaz ,Obri) etj, Lubeniq (Pejë),Deçan ,Gjakovë,Istog, etj.etj.?!!!
Shumë kriminelë janë të lirë edhe në Graqanicë,Gorozhdec,Mitrovicë,ku janë prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut, apo ata kombëtarë, që nuk i shoshitin dosjet e nxehta të krimeve dhe kriminelëve serbë?!!!

Klikoni:

Për këto krime (dhe qindra e mijëra si këto) që mund t´i shihni më poshtë:
http://www.ess.uwe.ac.uk/Kosovo/Kosovo-Photographs22.htm
http:// www.ess.uëe.ac.uk/Kosovo/Kosovo-Photographs18.htm
http:// www.alb-net.com/ëarcrimes-img/abri.htm
http:// www.ess.uëe.ac.uk/Kosovo/Kosovo-Photographs5.htm
http:// www.ess.uëe.ac.uk/Kosovo/Kosovo-Photographs27.htm

UÇK-ja dhe forca etike e saj

Gjendja psikologjike e popullit të Kosovës para fillimit të luftës. Lufta bëhet nga njerëzit me moral të lartë, me mendje të kthjelltë e me zemër të fortë. Sido që diskutohet, lidhur me raportet ndërmjet njeriut dhe armës, si faktorët kryesorë, që vendosin fatin e luftës, përvoja historike e të gjitha luftërave ka provuar rolin parësor të shpirtit njerëzor, që buron nga aspirata e lirisë...

Njerëzit, që luftojnë për tu çliruar nga pushtuesi i huaj, luftojnë për një çështje të drejtë, për të drejtën natyrore të jetës së lirë në tokën e vet. Tek këta njerëz, që nuk duan të jenë skllevër, që duan të jetojnë me dinjitet, duke trashëguar traditat e veta kombëtare, motivi i luftës bëhet një burim i fuqishëm moral, përballë të të cilave edhe armët më të sofistikuara thyhen. "Arma jonë kryesore në Luftën Çlirimtare të Kosovës,-thotë një nga komandantët e UÇK-së, Fatmir Lima,-ka qënë morali i lartë".1 Realiteti është se shqiptarët e Kosovës, historikisht kanë pasur monopolin e të drejtës, por asnjëherë nuk kanë pasur fuqinë. Numerikisht kanë qenë inferiorë dhe ushtarakisht kanë qenë gjithmonë në nivelin zero, krahasuar me Serbinë me ushtri të fortë e të armatosur deri në dhëmbë, me armët më moderne të kohëve. Aq më e fortë dhe e pajisur është komentuar ushtria jugosllave (serbe) gjatë 20 vjetëve të fundit. Përballë këtij realiteti shumica e popullit stepej. Mbisundonte ideja se nuk mund të luftohej me Serbinë, se ajo "ka ushtri të fuqishme dhe të shuan". Demonstrimi i forcës ushtarake, i shoqëruar me propagandë, krijonte një stres psikologjik te shumica e njerëzve. Ishte krijuar miti i pathyeshmërisë së Serbisë si dhe ideja e nënshtrimit ndaj fatit. Kishte edhe faktorë të tjerë, që e fuqizonin idenë e pamundësisë për të hyrë në luftë me Serbinë. Rreth një shekull nën pushtim është një periudhë kohore mjaft e gjatë për t'i larguar njerëzit nga ideja e mundësisë së çlirimit. Përvoja e hidhur historike i kishte forcuar rrënjët e kësaj ideje trishtuese, kur çdo përpjekje e shqiptarëve për liri ishte shtypur me gjak. Nga brezi i sotëm ruhen si të gjalla masakra e Drenicës, e Gjilanit dhe ajo e Tivarit, apo shtypja me tanke e demonstratave të vitit 1981 e ato të viteve 1989-1990, burgosjet e qindramijë djemëve e vajzave, si dhe përzënia e tyre me dhunë nga Kosova. Edhe hapësira gjeografike e Kosovës është mjaft e ngushtë. Kosova paraqet një terren kryesisht fushor e kodrinor

të butë dhe fare pak malor. Në pamje të përgjithshme, është një terren i papërshtatshëm për luftë çlirimtare, karakteri i së cilës nuk mund të ishte veçse luftë partizane, e cila kërkon terren malor dhe hapësira të gjera. Përkundrazi, ky territor i mundësonte Serbisë përqëndrim shumë të madh të forcave ushtarake dhe të teknikës luftarake, si dhe lëvizshmërinë dhe manovrimin e tyre. Veç faktorëve të tillë objektivë, kishte edhe faktorë subjektivë, me ndikim të fuqishëm paralizues: ishte rryma e pacifizmit, e cila e kishte hipnotizuar ndjenjën e heroizmit e të sakrificës, duke ushqyer idenë e frikës së zhdukjes në rast ngritjeje në luftë kundër Serbisë. Kjo ide artikulohej në kafenetë e qyteteve, në odat kosovare dhe në mjediset e tjera shoqërore, jo vetëm nga njerëz ordinierë, por edhe nga intelektualë. "Ja si po i shfarosë Serbia boshnjakët",-argumentonin pacifistët gjatë masakrave në Serbrenicë e gjetkë. I frynte me të madhe kësaj ideje propaganda dhe shërbimi sekret serb. Si mund të gjykonte njeriu i thjeshtë, në këtë amulli të madhe, të mpleksur me realitete ushtarake e ideologji pacifiste?! Vështirë e kishte të orientohej. I pëlqente të merrte për të vërtetë idenë e gënjeshtërt se: "liria do të vijë me rrugë paqësore!" Mungesa e kohezionit politik, ose më saktë, përçarja partiake, ishte shkaktuar nga diversiteti i thellë ndërmjet pacifistëve, nga njëra anë, dhe përkrahësve të luftës, nga ana tjetër. Fatkeqësisht, duke e parë në global, shumica ishte në krahun e pacifistëve. Ky është realiteti tepër i padëshirueshëm, një njollë e errët në historinë e lavdishme të popullit të Kosovës, një dukuri që nuk është shfaqur në këto përmasa në të kaluarën. Qëndrimi moral karshi luftës ndërmjet përkrahësve e jopërkrahësve ka ndryshuar ekstremisht. Si mund të shpjegohej që njerëz të një kombi, të një gjaku, të një atdheu: dikush dilte nga spitali e me plagë në trup turrej drejt luftës në Kosovë, kurse tjetri, i të njëjtës moshë, turrej me vrap drejt plazheve të bregdetit shqiptar?! Çfarë mund t'i kenë thënë njeri-tjetrit, kur janë takuar pas luftës, një djalë që kishte lënë prindërit, nusen e fëmijët në Amerikë e shkoi në luftë, duke dhënë gjymtyrët e trupit, atij tjetrit që i kishte kthyer shpinën Kosovës në ato ditë të vështira?! Si mund të shikohen sy më sy një djalë i gjymtuar në luftë, që dikush, për bamirësi, e shtynë me karrocë rrugëve të Prishtinës, me një tjetër hipur në "Bens", i cili ka ikur nga lufta e sot është biznesmen, që të "thyen brinjët" me para?! Janë kontraste të tejskajshme. Kosova është e të gjithëve. Detyrimi ndaj saj është i njëllojtë për të gjithë. Mirëpo në ato ditë kushtrimi dikush shkonte drejt luftës e vritej për Kosovën, tjetri i bënte karshillëk nëpër diskoteka. Fatkeqësisht kështu ka ndodhur. Ringjallja e shpirtit të qëndresës. Përkrahësisit e luftës ishin njerëzit më idealistë e të vendosur deri në vdekje për çështjen e Kosovës. Mbi Kosovën ata nuk vinin asgjë, as jetën, as familjen. Ata që nisën luftën çlirimtare në Kosovë e njihnin në thellë-

si gjendjen morale të popullit dhe psikologjinë e nënshtrimit, që kishte filluar të bëhej sunduese në shpirtin e tij. Dhe për ta nxjerrë atë nga kjo gjendje, për ta bindur që të futej në luftë, për t'i krijuar besimin se shqiptarët e bashkuar të Kosovës mund të ndeshen me forcën ushtarake të Serbisë e ta thyejnë atë, nuk mjaftonte vetëm referimi tek heroizmi i brezave të kaluar. Tek brezat e sotëm duhej ringjallur krenaria kombëtare dhe heroizmi shqiptar në përmasa edhe më të mëdha, gjë që do të ishte e mundur vetëm nëpërmjet shembullit vetiak. Ata që nisën luftën e morën parasysh që në fillim domosdoshmërinë e shembullit sublim për të ngritur popullin në luftë. Duke u nisur nga amaneti i Josuf Gërvallës, ata formuluan motivin, në një mënyrë tepër origjinale, të pa dëgjuar ndonjëherë: "E dimë që do të vdesim, por kështu kemi vendosur"! Pas Josufit, Bardhoshit e Kadri Zekës, i pari kishte rënë Afrim Zhitia. Viti 1998 shënoi kalimin në luftë të hapët me Serbinë. Në shkurt u flijua Zahir Pajaziti. Në mars një burrë nga Drenica, kreu një akt të pashembullt në botë, me përmasa legjendare. Adem Jashari u vetëflijua me gjithë familje e me një pjesë të farefisit prej 56 anëtarësh. Adem Jashari e kreu këtë akt me vetëdije të plotë, duke u bërë kurban për lirinë e Kosovës. "Ky akt,-thotë Ramush Haradinaj,-ka qenë kulmi që ka përcaktuar se nga do të rrokullisej populli i Kosovës: të vazhdonte të ishte ashtu i hutuar, apo të kthjellohej, që të kuptonte se Serbia ishte armku ynë dhe se do të rrezikoheshim të zhdukemi, nëse nuk i kundërviheshim asaj".2 Dhe me të vertetë gjaku i Ademit dhe i tërë familjes së tij, nuk shkoi kot. Shumë shpejt situatat e krijuar mori përmasa të jashtzakonshme, duke u shndërruar atë në një simbol tepër të fuqishëm frymëzimi. Shumë shpejt figura e tij, në ndergjegjen e Kosovës u shndërrua në një komandant legjendar. Sepse asnjë komandant në botë, pas rënies, nuk do të mund të mblidhte aq shumë luftëtarë të vendosur për të vdekur, se sa Adem Jashari. Ra Adem Jashari-Kosova u ngrit në këmbë. Kosova ishte në shpirtin e Adem Jasharit dhe heroizmi i saj u ringjall. Drenica u bë edhe një herë qendra e heroizmit shqiptar. Vëllezërit Haradinaj, Ardian Krasniqi etj., u vetëflijuan për Kosovën dhe ndezën flakën e luftës në Dukagjin. Fehmi Ladrovci e Xhevë Ladrovci (Krasniqi), bashëshortë, treguan rrugën e vetme të lirisë. Fehmi Lladrovci kërkonte që populli masivisht të ngrihej në luftë dhe tërë pasurinë ta shkrinte për luftën. Ata që ishin jashtë Kosove, që të gjithë të ktheheshin atje dhe jo 3 apo 30 përqind, por të gjitha të ardhurat t'i jepnin për Kosovën. "Kush nuk derdh një pikë gjak për tokën e vet, kush nuk jep asnjë qindarkë, ai s'ka të drejtë të varroset në të",-thoshte rilindasi ynë i madh, Sami Frashëri. Të frymëzuar nga këta atdhetarë të përmasave kaq të mëdha, djemtë e vajzat më të mira të Kosovës, ranë që të ngrihen mijëra të tjerë. Dhe ashtu ndodhi.

Populli i Kosovës u zgjua me fuqi të shumëfshishuara dhe iu bashkëngjit UÇK-së. Vetëm brenda tre muajve, që nga marsi deri në qershor të viti 1998, UÇK-ja ishte shtrirë në të gjitha zonat e Kosovës, duke shporrur me luftë policinë dhe ushtrinë serbe nga pjesa më e madhe e zonave rurale e duke e detyruar atë të mblidhej nëpër qytetet kryesore. Suksesi më i madh që u arrit brenda kësaj periudhe kaq të shkurtër ishte thyerja e mitit mbi forcën ushtarake të Serbisë, ringjallja e shpirtit luftarak të popullit shqiptar të Kosovës dhe e besimit në forcat e veta për fitore. Aritjen e kësaj shkalle të lartë të vetëdijes e ka nxitur poshtrimi e dhuna e ushtruar gjatë dhjetra vjetësh mbi popullin shqiptar të Kosovës, nga pushtuesi serb deri te përpjekja e fundit për ta shfarosur, ose për ta shpërngulur nga trojet e veta. E gjithë kjo ka shkaktuar reagimin e kundërt, reagimin e natyrshëm mbrojtës, që ka çdo qënie e gjallë. Tiparet morale të UÇK-së. Tiparet morale të UÇK-së, në këndvështrimin ushtarak (morali si faktor i luftimit), mund të përmblidhen në këto cilësi: betimi e gatishmëria për të dhënë jetën për lirinë e Kosovës; besimi në fitoren mbi pushtuesin serb; disiplina e ndergjegjëshme në zbatimin e përpiktë të rregullave të vendosura dhe, sidomos, zbatimi pa hezitim i urdhrit të komandantit (eprorit); sjelljet korrekte dhe marrëdhëniet e ngushta me popullin (shkrirja me popullin); dashuria për shokun, ndihma e ndërsjelltë, deri te sakrifica sublime për të mos e lënë njëri-tjetrin në fushën e luftës, të plagosur apo të vdekur; padurimi për tu ndeshur me armikun; humanizmi; pjesëmarrja e femrës në radhët e saj. -Betimi e gatishmëria. UÇK-ja, që në fillim, ishte një ushtri vullnetare. Djemtë dhe vajzat e Kosovës e kishin për krenari, që ishin luftëtarë të kësaj ushtrie, sepse bënin një luftë të drejtë e të ndershme. Ata kishin guximin të luftonin ushtri me ushtri e jo me gra e me fëmijë, me pleq e me plaka, siç bënte ushtria dhe forcat e tjera policore e speciale serbe. Luftëtarët e UÇK-së e kishin për krenari të vriteshin në fushën e luftës për çlirimin e Kosovës. E kishin për krenari edhe familjet e tyre, prindërit, motrat e vëllëzërit. Komandant Vandami i famshëm i Malishevës tregon: "M'u vranë 5 shokë, midis tyre edhe zëvendëskomandanti i njësisë speciale, Mentor Morina. Kur i shkova të jatit në shtëpi me lajmin e kobshëm, ai më tha këto fjalë: "Hej, more Vandam, më vjen shumë keq që djali im iu ka lënë në mes të rrugës, se që do të vritej e kam ditur që atë ditë kur mori pushkën për liri". U ngritëm të largohemi dhe duke zbritur shkallët, doli nëna e Mentorit dhe e pyeti burrin e vet: "Çfarë ka ndodhur Nazmi?" "Është vrarë Mentori,"-iu përgjigj ai. "Hajli kjoftë, hajli kjoftë, shyqyr që kemi pasur kësi djali!" Këto ishin fjalë zemre, që na jepnin kurrajo e frymëzim të jashtzakonshëm".3 Edhe një shembull tjetër: Një vajzë, Idajete Buçaj, e fejuar ne Kosovë, vinte nga Malisheva kur i shpernguli serbi dhe u sistemuan me familje ne Durrës. Ajo e kishte të vëllanë ne UÇK, i cili ishte

plagosur dhe e kishin sjellë ne spitalin e Kukësit. Vajti me gjithë nënën për ta parë. Ndërsa nëna filloi të qante, Idajetja i thotë të vëllait:"Lum si t'i që je plagosë për Kosovën". Pastaj Idajetja u drejtohet prindërve: "Do të shkoj në vend të vëllait". Prindërit i thanë: "Je e fejuar, nuk mund të shkosh pa lejen e të fejuarit". Idajetja zbatoi porosinë e prindërve dhe i tha të fejuarit: "Eja të shkojmë së bashku në UÇK". Ai kundërshtoi. Ajo i tha: "Po nuk erdhe t'i do të shkoj vetem". Ai ia ktheu: "Po shkove, nuk ke më punë me mua".4 Idajete Buçaj zgjodhi dasmën e luftës për lavdinë e Kosovës. Edhe një shembull tjetër, siç e tregon Besim Mala, vëllai i dëshmorit Hazir Mala: "Kam takuar në spitalin e Bajram Currit një djalë të plagosur në Koshare, shqiptar i Kosovës, lindur e rritur në Suedi. Kishte ardhur me vëlla e me dhëndërr të vet, i cili edhe ky lindur e rritur në Suedi. Pasi ishin stërvitur në Shqipëri ishin futur në frontin e luftës dhe ishin plagosur që të dy vëllezërit, ai tjetri kishte humbur këmbën. Ky që po më tregonte interesohej për ta nisur vëllanë me këmbë të këputur për Tiranë e prej andej, në Suedi. Vet, pasi të shërohej, do të rikthehej në front". Të tillë djem ka Kosova, kudo që ndodhen në botë. Ata, megjithëse plagoseshin dhe e provonin shijen e vdekjes, megjithëse humbnin njerëzit e tyre, jo vetëm nuk tërhiqeshin nga fronti i luftës, por çuditërisht riktheheshin edhe më të vendosur për të vdekur, edhe më të motivuar. Me këto motive u nisën edhe nga Amerika: "Do të shkojmë të vdesim për Kosovën!" Komandanti i batalionit "Atlantik", Skënder Doçi, në fjalimin e tij para luftëtarëve në Nju Jork, duke e korrigjuar këtë parrullë, u tha: "Ne do të shkojmë në Kosovë, jo të vdesim, por të fitojmë!" -Besimi. Besimi në fitore ka ardhur në rritje, me lëkundjet e veta në procesin e zhvillimit të luftës. Dhe për këtë kanë ndikuar shumë faktorë me veprim të përhershëm e spontan, të diktuar nga rrethanat, që krijoheshin në fushën e luftës. Por, në bazë të një analize të të gjithë përvojës së kësaj lufte, veç faktorëve subjektivë e atyre rastësorë, një faktor tjetër objektiv shumë i rëndësishëm ka qenë edhe mungesa e armëve dhe municioneve. Lidhur me këtë, Remi thotë: "Mendoj se lufta e Kosovës ka qenë lufta më e varfër sa u përket armëve ... njerëzit kanë pritur për armë dhe kur nuk kemi mundur t'ua sigurojmë, ata kanë biseduar nëpër kafene, mendime të ndryshme".5 Besimi në fitore është krijuar në procesin e zhvillimit të luftimeve, kur forcat serbe nuk guxonin të dilnin në fushë të hapur e të luftonin ballë për ballë. Atyre u kishte hyrë frika në palcë, sepse pavarësisht nga propaganda që u bëhej, për ta Kosova ishte një tokë e huaj, një tokë ku do të linin kockat. Ushtarët nga Serbia nuk dëshironin të vinin e të luftonin në Kosovë, ndersa mercenarët rus, bjellorus a ukrainas nuk ishin në atë masë e në atë shkallë vetëdije që të mund ta mbanin Kosovën me luftë për një kohë të

gjatë. Në fillim, në periudhën mars-korrik 1998, kur radhët e UÇK-së u shtuan me shpejtësi dhe territoret e çliruara, u zgjeruan shumë, besimi në fitore u rrit deri në shkallën e euforisë. Por kur filloi mësymja serbe dhe UÇK-ja u detyrua të tërhiqet, natyrisht edhe me humbje, morali, besimi në fitore pati një lëkundje të ndjeshme. Frikacakët, pacifistët filluan të thonë "Ja kush është Serbia, na morët më qafë. Ju kemi thënë se nuk luftohet me Serbinë me një pushkë të vjetër, nuk luftohet tanku me automatik ..." etj. Komandantët dhe Shtabi i Përgjithshëm qëndruan si burrat. Qëndruan përkrah tyre edhe luftëtarët e vendosur e trima të vërtetë. Morali u ngrit përseri. Besimi në fitore, sidomos pas Konferencës së Rambujesë, u konsolidua edhe më tepër. Në një intervistë, që autori i këtij libri i ka marrë komandant Rremit, pyetjes "A mund ta fitonte luftën UÇK-ja, nëse nuk ndërhynte NATO-ja?" ai i është përgjigjur: "Ne do ta fitonim luftën, por, natyrisht, për një kohë më të gjatë e me humbje më të mëdha".6 -Disiplina. Disiplina e ndërgjegjshme në zbatimin e përpiktë të rregullave të vendosura, sidomos zbatimi i urdhrit të komandantit i çfarëdo shkalle qoftë, ka qenë një tregues tjetër i një morali të shëndoshë në gjirin e UÇK-së. Si një ushtri e organizuar në luftë e sipër dhe e rritur me shpejtësi të madhe nuk mundësonte hartimin e rregulloreve të mirëfillta ushtarake të një ushtrie të rregullt kazerme. Djemtë e vajzat e UÇK-së, në pjesën dërrmuese nuk kishin kryer sherbimin ushtarak. Edhe ata që e kishin kryer këtë sherbim nuk mund të ishin të unifikuar. Ata që ishin stërvitur në Shqipëri e që në fillim, disa prej tye, bënin pjesë në bërthamën drejtuese të UÇK-së, kishin përvetësuar një shkollë tjetër, ndryshe nga ata që kishin kryer shërbimin ushtarak jugosllav. Madje ata preferonin zbatimin e rregullave të ushtrisë shqiptare dhe urrenin rregulloret jugosllve. Këtu lindën edhe keqkuptime, si p.sh., në rregullin e nderimit ushtarak. Disa, duke zbatuar rregulloren shqiptare të para vitit 1990, nderonin me grusht, si simbol bashkimi, që e kishte zanafillën në Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Por pacifistët i akuzuan me epitete të ndryshme. Ndërkohë, ashtu sikurse në Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë, edhe në UÇK, mungonte hierarkia e gradave. Ja si shprehej lidhur me këtë, njëri ndër komandantët e UÇK-së, Agim Ramadani (dëshmorë): "Ne nuk kemi krijuar ushtri të gradave. Këto do t'i vendosim pas luftës, pas çlirimit të Kosovës. Ne, njësitë tona, i kemi të përgatitura në kushtet e luftës e jo në kushtet e paqes ... Ne nuk bëjmë thirrje që të shkoni në luftë, por ju themi: "Ejani me ne në luftë"!7 Shembulli personal i komandantëve ishte komandimi dhe udhëheqja më e mirë e një ushtrie vullnetare, siç ishte UÇK-ja. Fjala dhe urdhri i komandantëve të tillë ishte ligj suprem për çdo luftëtar, i pa shkruar në ndonjë rregullore

konkrete të kësaj ushtrie. Me urdhrin e komandantëve të gjithë luftëtarët pa hezitim shkonin drejt vdekjes. Madje në situata tepër të vështira, kur detyra kishte të bënte me kokën, komandantët zbatonin parimin e vullnetarizmit, duke shtruar problemin dhe pyetjen: "Duhet kryer kjo detyrë me rrezik për jetën: Kush del vullnetar të bëjë një hap përpara nga rreshti"! Të gjithë dilnin vullnetarë dhe komandantit i mbetej të zgjidhte ata që nuk duhej të shkonin në aksion. Shprehja më karakteristike e luftëtarëve të UÇK-së ishte: "U tha, u bë". -Sjellja korrekte. Sjelljet korrekte dhe marrëdhëniet e ngushta me popullin, për UÇK-në janë unikale në histori. Vështirë të gjendet ndonjë popull në botë, që ta ketë dëshiruar aq tepër ushtrinë e vet, sa populli i Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi nga gjiri i popullit të vet, për lirinë e popullit të vet. Ajo përbëhej nga djemtë e vajzat më të mira të popullit, të vendosura për të dhënë jetën në emër të idealeve të lirisë. UÇK-ja ishte nderi dhe lavdia e Kosovës, të ngritura në piedestalin më të lartë të historisë. UÇK-ja ia zbardhi faqen Kosovës, ia vuri në vend dinjitetin dhe nderin e nëpërkëmbur. Prandaj populli i vet e deshi shumë UÇK-në dhe ndau me të kafshatën e gojës në ditët më të vështira të luftës. "Ne bëjmë si bëjmë,-u thoshin fshatarët komandantëve,-por UÇK të mos e lini pa ushqim". Shpreheshin kështu në ato çaste kur nënat me fëmijë për gjiri nuk kishin qumësht të ushqenin foshnjat e tyre. Një pjesë e madhe e popullit të Drenicës, të Llapit, të Nerodimes, të Dukagjinit etj., që nuk u largua nga Kosova, por iu bashkua UÇK-së gjatë bombardimeve të NATO-s, kishte vendosur të vdiste bashkë me të. Brengosjen e ushtarëve në një moment e përshkruan kështu një epror i UÇK-së, Ram Bibaj, në ditarin e tij të datës 3 prill 1999: "Ushtarët ishin të lodhur nga luftimet e pandërprera dhe nga shiu që nuk pushonte. Popullata e fshatrave Bellanicë, më shumë se gjysma ishte në duart e armikut. Fshati Lladroc digjej. Ushtarët e mi ishin tepër të tronditur dhe kritikonin vetën: "Çka duhej të kishim bërë më shumë që popullata të mos binte në dorë të armikut"? Më shikonin në sy, si komandant i tyre dhe kërkonin t'u jepja një shpresë morale. Por unë isha i rënduar, sa as bjeshka s'mund ta mbante atë peshë të madhe që ndjeja në ato momente. "Mbahuni djema,-u thash,-se serbi s'mund të ngjitet atje lart ku kemi popullatën, atje ku kemi shtetin e Kosovës"! Të gjithë m'u përgjigjen një zëri: "Jo kurrë, o mixhë, ne do të luftojmë deri në vdekje"! Në këtë bisedë e sipër, vjen një ushtar nxitmthi e na thotë: "Komandant, forcat armike po tërhiqen nga Seniku"! Ishte një lehtësim i jashtzakonshëm"8 Forca e një ushtrie popullore, siç ishte UÇK-ja, qëndron tek populli që e ka lindur. Kjo ushtri është e pamposhtur. -Dashuria për shokun. Dashuria për shokun, ndihma e ndërsjelltë deri te sakrifica sublime për të mos e lënë njeri-tjetrin në fushën e luftës të

plagosur apo të vrarë, ka qenë një tipar moral i fuqishëm kohezioni në radhët e UÇK-së. Që në fillim UÇK-ja u krijua nga njerëz idealistë, nga njerëz që i bashkonte një qellim i shenjtë. Këta ishin shokë të vërtetë, që nuk lidheshin me njeri-tjetrin me interesa të ngushta materiale, por me idealet e lirisë. Ata ishin të betuar ndaj njëri-tjetrit, për të rriskuar së bashku. Dhe rastet janë të shumta. Tregon Vandami (Refki Mazreku): "Ishim në bazën e Lluzhnicës. Kjo pikë sulmohej egërsisht. Ne shkuam për t'u dhënë ndihmë shokëve. Forcat armike na kishin dalë në shpinë. Gani Kastrati mbeti i vrarë, unë u plagosa me tre plumba. Arriti edhe Nuhi Mazreku, por menjëherë u vra, pastaj edhe Afrim Buçaj. Mbetën tre shokë të vrarë. Komandant Kumanova, kishte lënë në Zvicërr 5 vajza dhe kishte ardhur të luftonte për çlirimin e Kosovës. Vrasja e shokëve e kishte pikëlluar thellë. Të nesërmen, më 25 gusht 1998, së bashku me Habib Zogaj (Arbëri), vendosën të sulmojnë për të nxjerrë shokët e vrarë. Por ishte një "çmenduri" e vërtetë. Armiku e kishte rrethuar vendin me forca të shumta. U hodhën në sulm, të vetëdjshëm se do të vriteshin. Dhe ranë që të dy për të nxjerrë 3 shokët tanë të vrarë një ditë më parë".9 Raste të tilla janë të shumta. Shoqëria ndërmjet luftëtarëve të UÇK-së ishte shoqëri luftarake, shoqëri e sinqertë, shoqëri e kohës së vështirë. -Padurimi për t'u ndeshur me armikun. Ishte një element tjetër moral, që buronte nga urrejtja e madhe e serbëve ndaj shqiptarëve të Kosovës për shfarosjen e tyre. Kjo urrejtje e kultivuar dhe e akumuluar për një kohë shumë të gjatë te serbët kishte krijuar të njëjtën gjendje edhe te shqiptarët. Në qoftë se serbi e mbante një thikë në brez, shqiptari mbante një sopatë nën jestek, siç shprehet diku Ukshin Hoti. Pra pabesia dhe urrejtja kishin krijuar vetëm urrejtje dhe burimi i saj ka qenë politika e serbomëdhenjëve. Në kohën e luftës, kur Serbia kishte kaluar në masakra të përbindshme, kur policët, ushtarët e paramilitarët serbë përdhunonin gra e vajza, vrisnin e digjnin në zjarr fëmijë e pleq, kur i shpërngulnin me dhunë nga shtëpitë e tyre, të cilave u vinin zjarrin, urrejtja që krijohej nuk kishte kufi. Luftëtarët e UÇK-së, mbi familjet e të cilëve kryheshin të tilla masakra, bëheshin të papërmbajtur. Ata donin të hakmerreshin dhe nuk pyesnin për asgjë. Ata mezi prisnin të përlesheshin me ushtarët serbë për jetë a vdekje. Edhe djemtë dhe vajzat që erdhën nga Perendimi dhe u stërvitën disa ditë në Shqipëri, shpreheshin: "Na jepni nga një automatik, do të shkojmë të vrasim shkijet, që na kanë përdhunuar motrat tona"! Një oficer që stërviti batalionin "Atlantik" tregon: "Ata, vdekjen nuk e benin hesap, vetëm donin të shkonin sa më parë në front. "Shikoni ç'bëhet! Serbi po na i djeg gratë e fëmijët për së gjalli e ne po vonohemi këtu. Duhet të ikim sa më parë". Sipas planit, që kishte komanda e tyre ajo i tërhiqte pjesë-pjesë. Ata që ngelnin për radhën tjetër

nuk përmbaheshin dhe vinin e më thoshnin: "Ti komandant nuk na ke stërvitur mirë prandaj nuk na morën për front". Dy herë i kam parë me sy të përlotur".10 Papërmbajtja kishte shkak urrejtjen. Pa e urryer armikun nuk mund ta luftosh atë. -Humanizmi. Ka qenë tipar i veçantë i UÇK-së, një tipar karakteristik që buron nga natyra e brendshme e kombit shqiptar. Luftëtarët e UÇK-së, në qoftë se kishin mllef e urrejtje të papërmbajtur në front, ushtar me ushtar, një sjellje krejt tjetër e manifestonin me civilët e paarmatosur, apo me robërit e luftës. Madje ata e kishin për turp të tregonin trimëri ndaj tyre, apo t'u bënin kërcënime. Mirësjelljen e UÇK-së me robërit e kanë treguar para kamerave vetë ushtarët serbë të zënë robër. Shqiptari e ka për traditë që njeriun e dorëzuar e trajton si njeri që i ka rënë në besë dhe e mbron me jetën e tij. Kështu vepruan shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore me ushtarët italianë, të cilët pasi kapitulloi Italia dhe ata u dorëzuan, i morën nëpër shtëpira, i mbajtën si fëmijët e tyre dhe i mbrojtën nga gjermanët, të cilët i kërkonin për t'i asgjësuar si tradhtarë të çështjes së tyre të përbashkët. Në vazhdën e kësaj tradite, luftëtarët e UÇK-së janë treguar të kujdesshëm, sidomos, me fëmijët. Komandant Sami Lushtaku tregon: "Në kohën kur filluan bombardimet e NATO-s jemi mpleksur, forcat tona me ato serbe. Gjatë bombardimeve, serbëve iu kufizua mundësia e përdorimit të tankeve dhe mjeteve të blinduara. Kemi zhvilluar luftime të afërta dhëmb për dhëmb, për jetë a vdekje. Por në luftim të afërt ushtar me ushtar, ne dilnim gjithnjë fitimtar. Gjatë kësaj mpleksjeje popullsia serbe është larguar në panik, duke lënë edhe fëmijët. Ne i morëm në kujdestari, i ushqyem e i mbajtëm si fëmijët tanë. Ata, duke parë dhe përjetuar kujdesin dhe trajtimin tonë thanë:"Do të bëhëmi luftëtarë të UÇK-së".11 -Pjesëmarrja e vajzave dhe grave në radhët e UÇK-së. Pjesëmarrja e vajzave dhe grave në radhët e UÇK-së ka qenë një mrekulli e vërtetë. Ato i dhanë UÇK-së një nur të rrallë dhe vlera të pakrahasueshme morale e frymëzuese. Xhevë Krasniqi, edhe pasi ju vra burri i saj, Fehmi Lladrovci, urdhëroi të tërhiqen luftëtarët e tjerë dhe vet nuk luajti nga pozicioni deri sa ra heroikisht. Hyrë Emini, një vajzë intelektuale e cila kur nisi lufta më 1998, e la universitetin përgjysmë dhe shkoi në luftë deri sa u çlirua Kosova. Pastaj u kthye dhe mbaroi studimet me rezultate të shkëlqyera. Por shkoi përseri, tashmë, në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare e dha jetën përkrah komandantit Tahir Sinani. Në UÇK erdhën shumë vajza, madje dhe gra, nga Zvicëra, Gjermania, Franca, vendet Skandinave e deri nga Amerika. Kishte prej tyre të fejuara e të martuara, që kishin krijuar një jetesë prrallore, por që ruanin në shpirt dashurinë për atdheun dhe ndjenin detyrim për çlirimin e tij nga pushtuesit barbarë serbë. Ato erdhën vetëm për të çliruar Kosovën e,

nëse shpëtonin gjallë, për t'u kthyer në gjirin e familjeve të tyre. Pjesëmarrja e femrës në UÇK ishte shembulli më i lartë i karakterit të gruas shqiptare, i guximit e trimërisë dhe, mbi të gjitha, i pastërtisë morale të saj, që i frymëzonte dhe i ngrinte peshë djemtë, luftëtarë të lirisë. Femra shqiptare, edhe në këtë luftë, sikurse në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke përtrirë lavdinë e Tringë Smailes e Shote Galicës, të Bule Naipit e Persefoni Kokëdhimës, të Ganimet Tërbeshit e Margarita Tutulanit, të Shejnaze Jukës e Hibe Palikuqit, gjithësej të 6000 vajzave e grave, që morën pjesë në atë luftë, edhe këtë radhë e tregoi vetën të denjë, të emancipuar dhe krenare.Vajzat e gratë e Kosovës, me pjesëmarrjen e tyrë në këtë luftë, ia ngritën edhe më lart lavdinë kombit shqiptar. UÇK-ja, mbijetoi në rrethana tepër të vështira."UÇK-ja është një Feniks, që lind nga hiri i vet, edhe më e bukur se më parë",-vlerësoi zëdhënësi i NATO-s, Xhejmi Shea, në selinë e aleancës në Bruksel, para gazetarëve të mediave botërore. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, si nga misioni i saj, ashtu dhe nga veprimet praktike në terrenin e luftimeve është treguar humane. Ajo luftoi kundër barbarisë, kundër gjenocidit, për të drejtën natyrore të njeriut, që të jetojë i lirë, në trojet e veta stërgjyshore. UÇK-ja është krijesa më e lavdishme e Kosovës ndër shekuj. Literatura: Halil Katana, "Tre dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës", botim Argenta, Tiranë, 2002. Bardh Hamzaj: Ramush Haradinaj "Rrefim per luftën dhe lirinë", Prishtinë, '99. Revista "Mbrojtja", Nr. 6, 200, f.57 Muhamet Çeta: "Me UÇK-në në Koshare", Prishtinë, 2000. Nga biseda me oficerë shqiptarë që stërvitën batalionin "Atlantik". Nga biseda me komandantin e Zonës së Drenicës, Sami Lushtaku, botuar në revistën "Mbrojtja", Nr.7/2000. 1 Halil Katana, "Tri dimensionet e Luftës Çlirimtare të Kosovës", botim Argenta, Tiranë, 2002, f. 120. 2 Bardh Hamzaj: Ramush Haradinaj "Rrefim për luftën dhe lirinë", Prishtinë, '99, f. 20. 3 Bisedë me "Vandamin"-ish komandant i njësisë speciale "Arbëri", botuar në "Tri dimensionet...", f. 97. 4 Revista "Mbrojtja", Nr. 6, 2000, f. 57. 5 Cituar sips S. Zejnullahut, në librin "Tri dimensionet...", f. 93. 6 Tri dimensionet ..." f. 94. 7 Muhamet Çeta: "Me UÇK-në në Koshare", Prishtinë, 2000, f. 25. 8 "Tri dimensionet ...", f. 96. 9 Po aty, f. 97. 10 Nga biseda me oficerë shqiptarë që stërvitën batalionin "Atlantik". 11 Nga biseda me komandantin e Zonës së Drenicës, Sami Lushtaku, botuar në revistën "Mbrojtja", BuNr.7/2000, f. 63.
http://www.shqip.dk/modules.php?name=Neës&file=article&sid=229Burimi:

Flori Bruqi

Flori (Maxhun) Bruqi u lind më 29 .06. 1952 në Isniq të Deçanit(Kosovë).
Studimet e Defektologjisë i kreu në Beograd ,ndërsa ato posdiplomike (Magjistraturë) në Universitetin e Prishtinës - në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit (2004). Bashkëpunoi më shtypin e përditshëm e periodik të vendit dhe të jashtëm që nga viti 1974 e deri me tash (" Bota e re"-Prishtinë,"Rilindja"-Prishtinë, "Danas"-Zagreb, "Dello"- Lubjanë,"Dnevnik"- Lubjanë, "Veqer"- Maribor,"Le Mond","Corriera della Sera" etj).
Është anëtar i Lidhjës së Shkrimtarëve të Kosovës (2000) si dhe moderator i sitit në internet http://www.bruqi.com .
Është menagjer i kompanisë "Flomed" nga Prishtina dhe menagjer gjeneral për Kosovë në distribuim të preparateve farmaceutike të "Schulke-Mayr"it të Gjermanisë dhe " Borer chemie AG " të Zvicres.

Deri më tash ka botuar këta libra:
1.Zjarri i diellit,poezi,Prishtinë,1995.
2.Ndërgjegjja,roman,Prishtinë,1995.
3,Vrasësit e liridonëve,roman,Prishtinë,Tiranë,1996.
4.Ringjallja,roman,Tiranë,Prishtinë,1996.
5.Gjarpërinjtë e pallatit,roman,Tiranë,Prishtinë,1996.
6.Dorëzeza,roman,Tiranë ,Prishtinë,1997. 7.Tokë e djegur,roman,

Shkodër,Tiranë,Prishtinë,1998.
8.Burri dhe gruaja, libër shkencor, Tiranë, Prishtinë, 2000.
9. Pallati i akereonit, roman, Tiranë, Prishtinë, New York, 2000.
10. Vademecum DDD, libër shkencor, Prishtinë, 2002.
11.Struktura faktoriale e dimensioneve antropometrike dhe fiziologjike , Prishtinë,2004. 12.Ndikimi i sportit në personalitetin e njeriut,libër shkencor, Prishtinë, 2004.
13.Delinkuenca e të miturve dhe ushtrimet fizike,Prishtinë,2004.
14.Vademecum për preparate higjenike të "Schulke – Mayr"– it , libër shkencor , Prishtinë,2004.
15.Dallimet në disa ndryshore fiziologjike ndërmjet studentëve sportistë dhe jo sportistë para dhe pas vrapimit 400 metra(Punim magjistrature,Prishtinë 2005).
16.Antropometri-Jakov Milaj"Raca shqiptare,recension i zgjëruar i botuar në Floart,2005.
17.Si ta njofim internetin,Flomed ,tetor-2005.
18.Sëmundjet infektive seksuale",Floart,tetor-2005.
19.Udhëzues i shkurtër i preparative dezinfektuese, Flomed, 2006.
20.Merruni me sport dhe ushtrime fizike për t'u relaksuar,Floart,janar 2006.
21.Kosova nuk është i berzë e zezë , Floart,dhjetor 2005.
22.Fshehtësitë dhe të vërtetat për virusin avian',Flomed,2005.
23.THE ECONOMIC ASPECTS OF SPORTS RECREATION AND HEALTH",Sport ritmi-zemrës,janar 2006,etj.
24.DETERMINANTAT SOCIO-PSIKOLOGJIKE TË USHTRIMIT FIZIK(Hulumtim socio-psiko –kineziologjikë më studentët e Universitetit të Prishtinës),Flomed,2006.
25.Guxim shqiptar,Prishtinë, 2008.
26.Olimpi shqiptar,Prishtinë,2009.
27.Delikuenca e të miturve në Kosovë në periudhën 2003-2004,Prishtinë,2009
Botoi 21 fejtone publicistiko-shkëncore në gazetën "Rilindja" të Prishtinës,në përiudhën 1974-1982., si dhe mija punime në shumë web faqe interneti(2003-2009.

PËRMBAJTJA

FJALA E RECENSENTIT 5
NUK HARROHET REÇAKU 7
NUK ËSHTË HARRUAR NJË KOMENT PËR "REÇAKUN" 9
REAGIMI I MR.SCI. FLORI BRUQI, SHKENCËTAR
NGA PRISHTINA.....11
TRUPAT TOKËSORE 14
TRUPAT ISHIN ZHVENDOSUR 16
MINISTRI JANKOVIÇ: RAPORTI I HELENA RANTA
ËSHTË KONTRADIKTOR 18
EKSPERTI STANKOVIÇ PËR RASTIN REÇAK 20
KOSOVA - NGA MEDIAT E HUAJA.....21
HAPUR PËR KOSOVËN 27
SHQIPTARËT NUK KANË QENË JUGOSLLAVË,
AS MË PARË DHE AS JANË TASH 43
10 KOMENTE PËR "SHQIPTARËT NUK JANË
AS ISH-JUGOSLLAVË DHE AS SOT".....46
KOSOVA - ËSHTË UASHINGTON I SHQIPTARËVE 51
SHTYPI SERB KËRKON BURGOSJEN E LIDERËVE
POLITIKË TË FBKSH-SË QË PËRKRAHIN PAVARËSINË
E KOSOVËS.....56
TË GJITHË MIQTË E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS 59
KUSH ËSHTË NË TË VËRTETË MEDLIN OLBRIGHT? 61
HISTORIA ANTIKE 63
INKORPORIMI NË SERBINË 64
MBRETËRIA E SERBËVE 65
PERANDORIA SERBE DHE DESPOTIZMI.....66
SUNDIMI OTTOMAN 67
KOHA MODERNE.....67

MBRETËRIA E JUGOSLLAVISË
DHE LUFTA E DYTË BOTËRORE 70
KOSOVA NË JUGOSLLAVINË E DYTË 71
KOSOVA DHE SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË 73
LUFTA E KOSOVËS 74
KOSOVA PAS LUFTËS 75
VAZHDON PËRGJIGJA E FLORI BRUQI-t 77
PROCESI I STATUSIT TË KOSOVËS 78
EKONOMIA E KOSOVËS 79
HISTORIA DEMOGRAFIKE E KOSOVËS 81
REFERENCAT 83
BURIMET 84
BORDERING ALBANIA AND MONTENEGRO.....88
KOSOVO WAR KINGDOM OF YUGOSLAVIA AND
WORLD WAR II 99
KOSOVO IN THE SECOND YUGOSLAVIA 100
KOSOVO AND THE BREAKUP OF YUGOSLAVIA 102
KOSOVO WAR 103
KOSOVO OFTER THE WAR 104
POLITICS AND GOVERNANCE 105
ECONOMY OF KOSOVO.....108
DEMOGRAPHIC HISTORY OF KOSOVO.....109
ALBANIAN/KOSOVAN MUSICIANS, MUSIC OF KOSOVO,
MUSIC OF SERBIA, LIST OF SERBIAN MUSICIANS 111
ALBANIAN INITIATIVE FOR RECONCILIATION WITH
SERBIAN PEOPLE 119
KOSOVA NGA PALEOLITI DERI MË SOT.....121
F. BRUQI: "PO ZGJIDHET LËMSHI
PËR TË VËRTETËN E REÇAKUT" 149
RIKOLONIZIMI MODERN I KOSOVËS NGA SERBIA 183
LOBIMI DHE HESHTJA 189
DY EVANGJELISTË AMERIKANË I KANË BASHKUAR
FORCAT ME KISHËN SERBE KUNDËR PAVARËSISË 191

(RI)KOLONIZIMI I KOSOVËS NGA SERBIA 192
NUK E DUROJNË FILMIN PËR LUFTËN E KOSOVËS 193
OPERACIONI SEKRET SERB
"ZINGJIRI" DO TË DËSHTOJË 204
SHTYPI SERB KËRKON BURGOSJEN E LIDERËVE
POLITIKË TË FBKSH-SË QË PËRKRAHIN PAVARËSINË 205
'MOS HARRONI KRIMET SERBE NË KOSOVË..!' 207
UÇK-JA DHE FORCA ETIKE E SAJ 213
BIOGRAFIA.....223

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-92
32(496.51)

Bruqi, Flori
Polemika shqip / Flori Bruqi. - Prishtinë : Rugova Art, 2009. - 228 f. : ilustr. ; 21 cm. - (Biblioteka Feniksi)

[Shënime për autorin] : f. 223-224

ISBN 978-9951-536-04-2